



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS,
TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT



Udhëzues Praktik

për Zbatimin e Kurrikulës për Edukimin
në Fëmijërinë e Hershme në Kosovë për fëmijët
nga 0-6 vjeç



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS,
TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT

Udhëzues Praktik

për Zbatimin e Kurrikulës për Edukimin
në Fëmijërinë e Hershme në Kosovë
për fëmijët nga 0-6 vjeç





Dokumenti është zhvilluar me mbështetjen e **UNICEF në Kosovë**
www.unicef.org/kosovoprogramme

Përmbajtja

1. Hyrje	5
1.1 Organizimi i mjedisit të të nxënit	6
1.2 Organizimi i kohës (rutinat ditore)	6
1.3 Aktivitete praktike që ndërlidhen me kurrikulën	6
1.4 Pjesëmarrja e prindërve	7
1.5 Vlerësimi	7
1.6 Zbatimi holistik dhe burimet plotësuese	7
2. Edukimi gjithëpërfshirës në fëmijërinë e hershme	9
2.1 Aftësi të kufizuara të mundshme në fëmijërinë e hershme	9
2.2 Aspektet etike	10
3. Mjedisi edukativ	11
3.1 Roli i mjedisit edukativ	11
4. Organizimi i kohës në mjediset e edukimit në fëmijërinë e hershme	13
4.1 Zhvillimi i konceptit të kohës	13
4.2 Rëndësia e rutinave të strukturuar	14
4.3 Mbërritja e fëmijëve në mëngjes	15
4.4 Mbledhja e mëngjesit	16
4.5 Organizimi i ditës dhe aktivitetëve	17
4.6 Momente joformale	17
4.7 Roli i edukatorit	18
4.8 Loja e lirë në edukimin e hershëm	18
5. Aktivitetet kurrikulare në edukimin në fëmijërinë e hershme	21
5.1 Krijimi i konteksteve edukative për fëmijët	22
5.2 Aktivitetet kurrikulare	23
5.3 Higjiena	23
5.4 Koha e drekës në Edukimin në Fëmijërinë e Hershme	24
5.5 Koha e gjumit (ose koha e relaksimit)	25
5.6 Aktivitetet e pasdites	26
5.7 Koha e largimit për në shtëpi	27
6. Kurrikula në praktikë	29
6.1 Biseda në grupe të vogla dhe pyetje të hapura	29
6.2 Rrëfimi i tregimeve dhe zhvillimi i tyre	31
6.3 Aktivitete të përditshme nga fushat e matematikës dhe logjikës	34
6.4 Loja e lirë me materiale të riciklueshme	37
6.5 Reflektim mbi situatat për të cilat nevojitet të menduarit kritik	40
6.6 Kontekstualizimi i koncepteve shkencore	42
6.7 Kopsht me perime	46
6.8 Bisedat në grupe të vogla dhe pyetjet e hapura	49

7. Prindërit, kujdestarët dhe pjesëmarrja	53
7.1 Mundësitë për pjesëmarrje për prindërit dhe kujdestarët ligjor	53
8. Tranzicionet në Edukimin në Fëmijërinë e Hershme	55
8.1 Tranzicionet në kontekstin e Edukimit në Fëmijërinë e Hershme dhe institucioneve të EFH-së	55
8.2 Llojet e tranzicioneve	56
9. Zhvillimi motorik	65
9.1 Pse është i rëndësishëm zhvillimi motorik?	65
9.2 Ndërlidhja e zhvillimit motorik me fushat e tjera të zhvillimit	67
9.3 Një qasje zhvillimore e baraspeshuar	67
9.4 Komponentët e zhvillimit motorik	68
9.5 Përgatitja për shkathtësitë para-akademike	69
9.6 Roli i edukatorëve në zhvillimin e shkathtësive motorike të fëmijëve	70
9.7 Rutinat në klasë	72
10. Dokumentimi dhe vëzhgimi si mjete për zbatim të EFH-së cilësore	75
10.1 Mjetet për implementimin e një institucioni të EFH me fëmijën në qendër	75
10.2 Vëzhgimi dhe dokumentimi: Mjete pedagogjike me fëmijën në qendër për një edukim sa më të mirë	75
10.3 Vëzhgimi: Kuptojmë botën e fëmijëve	77
10.4 Dokumentimi – E vëmë në pah të nxënit	81
10.5 Vlerësimi në edukimin në fëmijërinë e hershme	84

1. Hyrje

Kurrikula e re për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme në Kosovë ofron një qasje transformuese dhe të integruar ndaj edukimit, që synon nxitjen e zhvillimit holistik të fëmijëve duke i integruar kompetencat, shkathtësitë, vlerat dhe njohuritë thelbësore. Prandaj, ky udhëzues praktik është hartuar për t'i mbështetur edukatorët, administratorët dhe stafin edukativ në zbatimin efektiv të kurrikulës në Institucionet e Edukimit në Fëmijërinë e Hershme (IEFH) në mbarë Kosovën. Ky udhëzues ofron strategji dhe udhëzime konkrete për organizimin e mjedisit të të nxënit, strukturimin e rutinave të përditshme, angazhimin në aktivitete praktike, përfshirjen e prindërve dhe kryerjen e vlerësimeve në përputhje me kurrikulën.

Një tipar kyç i kurrikulës së re është theksi i saj në zhvillimin holistik, ku kompetencat janë të ndërthurura në vend që të mësohen si të izoluar. Kjo do të thotë që në vend që të jepen aktivitete diskrete për të zhvilluar kompetenca individuale, ky udhëzues ofron strategji të përshtatura që njëkohësisht promovojnë kompetenca të shumëfishta. Natyra e ndërlidhur e këtyre kompetencave pasqyron shkathtësi dhe njohuri të jetës reale, duke u mundësuar fëmijëve që ta përjetojnë procesin e të nxënit në mënyrë më të thelluar dhe kuptimplotë.

Kjo hyrje ofron një përmbledhje të shkurtër të komponentëve kryesorë thelbësorë për zbatimin me sukses të kurrikulës:

- **Organizimi i mjedisit të të nxënit:** Krijimi i një hapësire stimuluese dhe gjithëpërfshirëse ku zhvillohen kompetencat e ndërlidhura.
- **Organizimi i kohës (rutinat ditore):** Strukturimi i ditës për të optimizuar përvojat holistike të të nxënit.
- **Aktivitete praktike që ndërlidhen me kurrikulën:** Angazhimi i fëmijëve në aktivitete praktike që pasqyrojnë natyrën e ndërthurur të kompetencave.
- **Pjesëmarrja e prindërve:** Inkurajimi i përfshirjes aktive të prindërve në procesin e të nxënit për të forcuar lidhjen shtëpi-shkollë.
- **Tranzicionet në Edukimin në Fëmijërinë e Hershme:** Rëndësia e mbështetjes dhe menaxhimit të përshtatshëm të tranzicioneve si momente dhe procese që përfshijnë lëvizjen e fëmijës nga një mjedis në tjetrin, nga një aktivitet në tjetrin ose nga një person tek tjetri.
- **Zhvillimi motorik:** Rëndësia e zhvillimit motorik për rritjen dhe zhvillimin e përgjithshëm të fëmijëve, ku luan një rol themelor në mënyrën se si ata bashkëveprojnë me botën përreth tyre dhe në zhvillimin e shkathtësive të tjera thelbësore.
- **Dokumentimi, vëzhgimi dhe vlerësimi:** Mbledhja e provave për praktikën reflektuese dhe përdorimi i strategjive të vlerësimit që pasqyrojnë qasjen holistike të kurrikulës, duke u përqendruar në rritje dhe zhvillim.

Qëllimi i këtij udhëzuesi është i dyanshëm. Së pari, ai ofron një përpunim praktik të kurrikulës së re të EFH-së në Kosovë, së bashku me mënyrat e zbatimit të saj në mjediset e EFH. Së dyti, udhëzuesi ofron një sërë veprimesh të detajuara, si dhe shembuj specifikë për praktikën pedagogjike për të arritur qëllimet e reja të kurrikulës, duke e bërë kështu këtë udhëzues të dobishëm për stafin edukativ, administratorët ose anëtarët e stafit që duan të mbështesin rritjen e plotë të fëmijëve përmes kurrikulës së rishikuar.

Struktura e udhëzuesit përbëhet nga shtatë kapituj kryesor, duke përfshirë edhe nënkapituj që trajtojnë fusha specifike me interes për praktikën pedagogjike të edukatorëve, të cilat u zbuluan gjatë pilotimit të kurrikulës, siç janë zhvillimi motorik, tranzicionet në EFH, vëzhgimi, dokumentimi dhe vlerësimi në EFH, ndjekur nga detaje dhe udhëzime praktike për zbatim. Përveç kësaj, janë zhvilluar një sërë dokumentesh shtojcë për ta shoqëruar këtë udhëzues praktik, duke përfshirë

Mjedisin e të Nxënit për EFH dhe Zhvillimin Social dhe Emocional. Qëllimi i dokumentit shtojcë është t'u japë edukatorëve këshilla të dobishme të cilat ata mund t'i përdorin me lehtësi çdo ditë. Ekipi që e hartoi kurrikulën ka hartuar dhe do të vazhdojë të zhvillojë dokumente shtesë shtojcë – të cilat përfaqësojnë natyrën 'e gjallë' të kurrikulës dhe promovojnë një model të qëndrueshëm edukativ.

1.1 Organizimi i mjedisit të të nxënit

Mjedisi i të nxënit shërben si bazë për zbatimin e kurrikulës së EFH, duke ofruar një hapësirë dinamike ku fëmijët mund të eksplorojnë, të bashkëveprojnë dhe të rriten. Ky udhëzues vë në pah organizimin e klasave dhe hapësirave në EFH për të mundësuar përvoja të ndryshme të të nxënit që nxisin njëkohësisht zhvillimin kognitiv, social dhe emocional. Për shembull, organizimi fleksibil i ulëseve nxit bashkëpunimin dhe eksplorimin e pavarur, ndërsa stacionet tematike të të nxënit integrojnë lëndë si shkenca, arti dhe gjuha. Qëllimi është të krijohet një hapësirë ku fëmijët ndihen të sigurt, të vlerësuar dhe të motivuar për t'u angazhuar në përvoja të të nxënit si individualisht ashtu edhe në grup.

Një mjedis gjithëpërfshirës është gjithashtu çelësi për të mbështetur stile, kontekste dhe nevoja të ndryshme të të nxënit. Edukatorët rekomandohet të përdorin mjete vizuale, materiale praktike dhe pajisje interaktive që mundësojnë mënyra të ndryshme të të nxënit. Kjo qasje jo vetëm që zhvillon kompetenca të shumëfishta si të menduarit kritik, komunikimin dhe kreativitetin, por pasqyron edhe angazhimin e kurrikulës ndaj gjithëpërfshirjes dhe mundësive të barabarta për të gjithë fëmijët.

1.2 Organizimi i kohës (rutinat ditore)

Menaxhimi efektiv i kohës është proces thelbësor në zbatimin e një kurrikule holistike ku rutinat e përditshme ofrojnë një strukturë të ekuilibruar që është e përshtatur për aspekte të ndryshme të zhvillimit. Kurrikula e EFH-së nxit një përzierje të intervaleve kohore të strukturuar dhe fleksibile, duke ua bërë të mundur fëmijëve që të angazhohen në një sërë aktiviteteve gjatë gjithë ditës. Orari i organizuar mirë duhet të përfshijë kohë të dedikuara për detyra individuale, punë në grup, lojëra në natyrë dhe momente reflektimi.

Përfshirja e rutinave të tilla si takimet e mëngjesit ose 'koha në rreth' ndihmon në vendosjen e një toni pozitiv për ditën dhe përforcon kompetencat sociale si komunikimi dhe empatia. Ngjashëm, periudhat e tranzicionit ndërmjet aktiviteteve mund të përdoren për të nxitur vetëdijen ose lëvizjen fizike, duke promovuar mirëqenien së bashku me aftësitë kognitive. Ky ekuilibër siguron që fëmijët të kenë një gamë të larmishme mundësish të të nxënit pa e fragmentuar rritjen e tyre në detyra të izoluar.

1.3 Aktivitete praktike që ndërliidhen me kurrikulën

Aktivitetet praktike përbëjnë gurrthemelin e qasjes praktike të kësaj kurrikule, dhe kanë për qëllim të krijojnë përvoja kuptimplota të të nxënit përmes përfshirjes së kompetencave të ndryshme. Këto aktivitete janë hartuar ashtu që të jenë të adaptueshme, duke u lejuar kështu edukatorëve t'ia përshtasin ato konteksteve unike të grupeve të tyre, duke trajtuar njëkohësisht aftësi dhe disiplina të shumta.

Për shembull, një projekt shkencor praktik, siç është mbjellja e një kopshti pranë institucionit të edukimit në fëmijëri dhe hershme /IEFH, mund të përfshijë kompetenca në shkencë (të kuptuarit e rritjes së bimëve), matematikë (matja e rritjes), gjuhë (shkrimi i vërejtjeve) dhe shkathtësi sociale (puna së bashku). Përmes aktiviteteve që ndërthurin kompetenca të ndryshme, fëmijët e përjetojnë të nxënit si një proces të ndërliidhur, duke reflektuar filozofinë holistike të kurrikulës.

Aktivitetet praktike gjithashtu inkurajojnë të nxënit aktiv dhe zgjidhjen e problemeve, duke

promovuar një kuptim më të thellë të koncepteve përmes zbatimeve në jetën reale. Ky udhëzues ofron një gamë shembujsh të adaptueshëm, duke siguruar që edukatorët të mund të zbatojnë aktivitete që janë relevante për interesat dhe nevojat e fëmijëve në grupet e tyre dhe burimet në dispozicion në IEFH-në e tyre.

1.4 Pjesëmarrja e prindërve

Pjesëmarrja aktive e prindërve/kujdestarëve në rrugëtimin e të nxënit të fëmijëve të tyre është një komponent thelbësor i kurrikulës së re. Ky udhëzues vë në pah rëndësinë e krijimit të partneriteteve të forta shtëpi-institucion për të mbështetur zhvillimin holistik të fëmijëve. Prindërit/kujdestarët mund të kontribuojnë duke ndarë përvojat, aftësitë dhe traditat e tyre kulturore, duke pasuruar mjedisin e të nxënit dhe duke e bërë atë më relevant për jetën e fëmijëve.

Komunikimi i rregullt ndërmjet edukatorëve dhe prindërve, si p.sh. përmes buletineve, punëtorive ose ngjarjeve edukative, ndihmon në përfundimin e të nxënit në shtëpi dhe i mban prindërit të informuar rreth zhvillimit dhe progresit të të nxënit të fëmijës së tyre. Duke i përfshirë prindërit në aktivitete si rrëfimi i tregimeve, projektet në klasë ose festat kulturore, edukatorët mund të krijojnë një përvojë edukative më gjithëpërfshirëse dhe mbështetëse. Kjo qasje bashkëpunuese jo vetëm që i përmirëson rezultatet e të nxënit, por edhe e forcon ndjenjën e komunitetit dhe përgjegjësisë së përbashkët për edukimin e fëmijëve.

1.5 Vlerësimi

Vlerësimi në kurrikulën e re të EFH-së nuk ka të bëjë me testimin e aftësive të izoluar, por më shumë me vlerësimin e zhvillimit holistik të secilit fëmijë. Ky udhëzues prezanton strategji vlerësimi që përputhen me theksin e kurrikulës në kompetencat e ndërlidhura. Edukatorët rekomandohet të përdorin një sërë metodash vlerësimi, duke përfshirë vëzhgimet, portofoliot, vetëvlerësimet dhe reagimet nga bashkëmoshatarët, për të arritur një kuptim gjithëpërfshirës të zhvillimit të secilit fëmijë.

Vlerësimet reflektuese, ku fëmijët inkurajohen të mendojnë për të nxënit e tyre, ndihmojnë në nxitjen e vetëdijes dhe një mentaliteti me fokus drejt zhvillimit. Edukatorët mund të përdorin tabela që vlerësojnë njëkohësisht disa kompetenca, të tilla si kreativiteti, bashkëpunimi dhe zgjidhja e problemeve, në vend që të përqendrohen vetëm në njohuritë e përmbajtjes. Kjo qasje mundëson që vlerësimet ta pasqyrojnë natyrën holistike të kurrikulës, duke ofruar njohuri kuptimplota që mbështesin zhvillimin e vazhdueshëm të fëmijëve.

1.6 Zbatimi holistik dhe burimet plotësuese

Qasja holistike e kurrikulës së re të EFH-së përfaqëson një shmangie të theksuar të praktikave tradicionale edukative, duke u përqendruar në ndërlidhjen e kompetencave në vend që t'i trajtojë ato si fusha të ndara. Ky udhëzues ofron strategji praktike për të zbatuar kurrikulën në një mënyrë që njeh dhe nxit këto ndërlidhje, duke i udhëzuar edukatorët të krijojnë përvoja edukative që janë po aq gjithëpërfshirëse sa edhe kuptimplota.

Së bashku, ky udhëzues si dhe materialet shoqëruese synojnë t'i mbështesin edukatorët për ta zbatuar në mënyrë efektive kurrikulën e re të EFH-së, duke siguruar që të gjithë fëmijët të përfitojnë nga një përvojë edukative që i përgatit për sfidat dhe mundësitë e larmishme të jetës.

2. Edukimi gjithëpërfshirës në fëmijërinë e hershme

Edukimi gjithëpërfshirës është një parim themelor brenda kurrikulës së edukimit në fëmijërinë e hershme në Kosovë, i cili thekson rëndësinë e ofrimit të një mjedisi mikpritës dhe mbështetës për të gjithë fëmijët, pavarësisht nga shkathtësitë apo aftësitë e tyre të kufizuara. Legjislacioni i Kosovës për edukimin në fëmijërinë e hershme përqendrohet në parimin se çdo fëmijë është i aftë të ndërtojë të nxënit e tij dhe se edukimi duhet të përshtatet për t'i përmbushur nevojat unike të secilit fëmijë. Kjo qasje nxit një respekt të thellë për diversitetin dhe promovon pjesëmarrjen e plotë të të gjithë fëmijëve në procesin edukativ.

Në institucionet e EFH-së në Kosovë, gjithëpërfshirja nuk është vetëm politikë, por një praktikë e rrënjësor thellë në ndërveprimet e përditshme dhe mjedisin fizik. Edukatorët, të cilët duhet të kalojnë në rolin e 'bashkë-hulumtuesve' me fëmijët, punojnë së bashku me ta për të eksploruar dhe ndërtuar njohuri. Kjo qasje bashkëpunuese mundëson një kuptim të thellë të aftësive, interesave dhe nevojave të secilit fëmijë.

Kur një fëmijë me aftësi të kufizuara është pjesë e një klase\grupi, **mjedisi përshtatet për të siguruar që ai/ajo të mund të marrë pjesë në mënyrë kuptimplotë në të gjitha aktivitetet**. Kjo mund të përfshijë modifikimin e mobiljeve, përdorimin e teknologjisë ndihmëse ose organizimin e hapësirës në një mënyrë që të jetë e qasshme për të gjithë. Ngjashëm, nëse një fëmijë ka një aftësi të kufizuar në të nxënë, edukatorët mund të përdorin strategji të ndryshme pedagogjike për të siguruar që fëmija të jetë i angazhuar dhe i aftë të kontribuojë në aktivitetet në grup.

2.1 Aftësi të kufizuara të mundshme në fëmijërinë e hershme

Zbulimi dhe identifikimi i aftësive të kufizuara në fëmijërinë e hershme është element thelbësor për krijimin e një mjedisi edukativ gjithëpërfshirës. Disa aftësi të kufizuara të zakonshme që mund të vërehen në fëmijërinë e hershme përfshijnë:

- Vonesa në të folur dhe gjuhë: Vështirësi në komunikim, të tilla si vonesë në të folur, vështirësi në të kuptuarit e gjuhës ose vështirësi gjatë artikulimit.
- Çrregullimi i spektrit të autizmit: Një çrregullim zhvillimor i karakterizuar nga sfida në ndërveprimin social, komunikimin dhe sjellje të kufizuara përsëritëse.
- Aftësi të kufizuara intelektuale: Funkcionim kognitiv dukshëm nën mesatare, gjë që ndikon në të nxënë dhe aftësitë e jetës së përditshme.
- Aftësi të kufizuara fizike: Gjendje që ndikojnë në lëvizshmërinë, koordinimin ose zhvillimin fizik të një fëmije, siç është paraliza cerebrale.
- Çrregullime të Përpunimit Shqisor: Vështirësi në përpunimin dhe reagimin ndaj informacionit shqisor, të cilat mund të rezultojnë në mbindjeshmëri ose nën-ndjeshmëri ndaj stimujve.

Kur ekziston ndonjë tregues i perceptuar i vonesës ose aftësisë së kufizuar tek një fëmijë, edukatori duhet t'i qaset situatës duke shmangur gjykimet e parakohshme dhe duke u përpjekur t'i kuptojë përvojat dhe perspektivat e fëmijës, duke shmangur emërtimin e gjendjes dhe diagnostikimin në çdo situatë. Veprimi kryesor që duhet të ndërmerret në këto raste është **vëzhgimi** i fëmijës në kontekste të ndryshme: gjatë lojës, aktiviteteve në grup dhe ndërveprimeve individuale. Kjo ndihmon në kuptimin e sjelljes së fëmijës në situata të ndryshme dhe në identifikimin e modeleve që mund të sugjerojnë një aftësi të kufizuar.

Pastaj, është e rëndësishme të kryhet një dokumentim i detajuar i vëzhgimit duke përdorur mjete të tilla si shënime anekdotike, video incizime, fotografi dhe punë të fëmijëve. Zbatimi i kurrikulës bazohet në forma të shumëfishta dokumentimi për të zbuluar larminë e përvojave të fëmijës. Edukatorët duhet të marrin parasysh mënyrën se si fëmija bashkëvepron me bashkëmoshatarët, të rriturit dhe mjedisin, dhe të zbulojnë çdo vështirësi ose pikë të fortë në komunikim, bashkëveprim shoqëror, aftësi motorike ose reagim shqisor të fëmijës. Edukatorët duhet të mbajnë ditarë me reflektime ku mund t'i shënojnë mendimet, pyetjet dhe hipotezat e tyre rreth sjelljes së fëmijës. Ky reflektim është jetik kur vjen puna që të shqyrtohen përvojat e fëmijës në kontekstin e zhvillimit dhe mjedisit të tij/saj.

Në të njëjtën kohë, është jashtëzakonisht e rëndësishme të ndahen vëzhgimet me edukatorë të tjerë dhe profesionistë mbështetës brenda IEFH-së. Kurrikula vë në pah rëndësinë e dialogut bashkëpunues. Perspektivat e ndryshme mund të ndihmojnë në kuptim më të plotë të nevojave të fëmijës.

Duke u bazuar në këtë qasje, edukatorët dhe profesionistët mbështetës duhet t'i përmbahen kërkesave rregullative dhe ligjore që lidhen me referimin e fëmijëve për vlerësim pedagogjik dhe shërbime ndërhyrjeje në fëmijërinë e hershme, kur janë në dispozicion. Në këtë drejtim, angazhimi i vazhdueshëm me prindërit/kujdestarët dhe pëlqimi i tyre gjatë çdo faze të vlerësimit dhe referimit është i detyrueshëm.

Familjet konsiderohen partnerë në edukimin e fëmijës. Profesionistët e edukimit duhet t'i ndajnë vëzhgimet me familjen e fëmijës dhe t'i ftojnë ata të kontribuojnë me njohuritë e tyre. Kjo mund të ofrojë një pasqyrë të plotë të aftësive të fëmijës në mjediset e tij/saj të ndryshme natyrore.

Pasi të jenë mbledhur vëzhgimet dhe dokumentimi, edukatorët i analizojnë të dhënat për të ndërtuar kuptim nga to. Kjo përfshin kërkimin e modeleve në sjellje dhe në ndërveprimet e fëmijës që mund të tregojnë një vonesë ose një aftësi të kufizuar. Në vend që të përqendrohen në diagnostifikimin e një aftësie të kufizuar, qëllimi është të kuptohet rruga unike e të nxënit të fëmijës dhe të identifikohen mënyra për të mbështetur zhvillimin e tij/saj.

2.2 Aspektet etike

Profesionistët e edukimit duhet të vëzhgojnë dhe dokumentojnë gjithmonë me respektin më të madhe për dinjitetin dhe privatësinë e fëmijës, duke qenë njëkohësisht të ndjeshëm ndaj rrjedhëve të gjetjeve dhe mënyrës se si ato komunikohen. Çdo vendim në lidhje me ndërhyrjet ose vlerësimin e mëtejshëm duhet të përfshijë familjen e fëmijës dhe të bazohet në një kuptim të thellë të nevojave të fëmijës.

Vëzhgimi dhe dokumentimi i një fëmije për të identifikuar një vonesë ose aftësi të kufizuar të mundshme është një proces i menduar mirë dhe bashkëpunues që merr parasysh individualitetin e fëmijës. Ky proces përfshinë reflektim të vazhdueshëm, bashkëpunim me familjet dhe kolegët, si dhe angazhim për të mbështetur zhvillimin e fëmijës në mënyrë holistike dhe me respekt. Qëllimi përfundimtar nuk është vetëm identifikimi i një aftësie të kufizuar, por edhe kuptimi i mënyrës më të mirë të mbështetjes së rrugëtimit të të nxënit të fëmijës, duke ia vlerësuar kështu edhe pikat e forta dhe potencialet e tij/saj.

3. Mjedisi edukativ

Hapësirat në IEFH janë në fakt një sistem i jetës; ato mbështesin kompleksitetin e ndërveprimeve midis individëve që qëndrojnë aty. Në IEFH, dizajni arkitektonik duhet të jetë i ndërthurur fort me punën pedagogjike në mënyrë që të nxisë marrëdhënie reciproke dhe një gjuhë të përbashkët.

Mjediset në institucionet e edukimit duhet të projektohen në përputhje me zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijëve, me qëllim mbështetjen e ndërtimit të proceseve edukative dhe kulturore.

Roli i të rriturve është thelbësor në procesin e edukimit të fëmijës, si drejtpërdrejt në marrëdhënie, shkëmbime, dialog dhe diskutime, ashtu edhe tërthorazi, në kontekstet që krijohen për të nxënit dhe të eksploruarit, siç është përgatitja e hapësirave dhe mjediseve. Mjedisi i IEFH duhet të bazohet edhe mbi përvojat, storjet, historitë ndërpersonale që ndodhin në të. Ky mjedis duhet të:

- Ruajë kujtimet individuale dhe kolektive
- Vë në pah veprimet dhe momentet kuptimplota të këtyre proceseve
- Inkurajojë dhe ripërtërijë vazhdimisht idetë e fëmijëve
- Mundësojë marrëdhënie dhe, në të njëjtën kohë, privatësi
- Stimulojë kuriozitetin

3.1 Roli i mjedisit edukativ

Mjedisi edukativ shpesh konsiderohet si “edukatori i tretë” (pas prindërve dhe edukatorëve). Hapësirat fizike dhe emocionale ku fëmijët bashkëveprojnë dhe formojnë përvojat e tyre të të nxënit ose e mundësojnë ose e pengojnë aftësinë e tyre për t’u angazhuar në mënyrë kuptimplotë me botën përreth tyre. Aspektet kryesore të mjedisit edukativ përfshijnë:

- **Mjedisine fizik:** Hapësira fizike duhet të jetë e sigurt, e qasshme dhe e pasur me materiale që nxisin eksplorimin dhe kreativitetin. Këto hapësira shpesh janë të strukturuar për të lejuar aktivitete individuale dhe në grup. Elementet kryesore përfshijnë:
 - › **Materiale të hapura:** Gjësende si blloqe, materiale arti dhe materiale ndijore që u mundësojnë fëmijëve të eksplorojnë përdorimet e tyre të shumfishta dhe të inkurajojnë kreativitetin.
 - › **Fushat e përcaktuara të të nxënit:** Hapësirat për lloje të ndryshme lojërash (p.sh., kënde leximi, zona për aktrim dhe hapësirat në natyrë) u ofrojnë fëmijëve mundësi për t’u angazhuar në aktivitete të larmishme.
 - › **Përshtatshmëria:** Hapësirat që mund të riorganizohen për t’iu përshtatur nevojave dhe interesave të fëmijëve ofrojnë fleksibilitet dhe autonomi, duke nxitur një ndjenjë pronësie në të nxënit e tyre.
- **Mjedisi social:** Ndërveprimet brenda hapësirës së të nxënit ndikojnë në mënyrën se si fëmijët ndërveprojnë me bashkëmoshatarët, edukatorët dhe materialet edukative. Një mjedis shoqëror pozitiv:
 - › Inkurajon bashkëpunimin, komunikimin dhe aftësitë sociale.
 - › Promovon sigurinë emocionale, duke i lejuar fëmijët të ndërmarrin rreziqe dhe të provojnë gjëra të reja pa frikë prej dështimit.
 - › Mbështetë marrëdhëniet me kujdestarët dhe bashkëmoshatarët, të cilat janë thelbësore për zhvillimin emocional dhe social.

➤ **Mjedisi emocional:** Një mjedis edukativ për nga ana emocionale:

- Nxiti ndjenjën e përkatësisë dhe mirëqenies, e cila është thelbësore për të nxënë.
- Inkurajon fëmijët të shprehin lirshëm mendimet, ndjenjat dhe idetë e tyre.
- Ndihmon fëmijët të ndërtojnë vetëbesim dhe autonomi, gjë që është thelbësore për zhvillimin e pavarësisë dhe shkathtësive të zgjidhjes së problemeve.

Duke ditur rëndësinë e mjedisit dhe mundësive zhvillimore që i ofron, edukatorët duhet të përpiqen vazhdimisht të sigurojnë që hapësirat fizike (si të brendshme ashtu edhe të jashtme) të jenë në përputhje me interesat e fëmijëve për të eksploruar dhe zhvilluar të nxënë e tyre.

Si i tillë, mjedisi i të nxënë duhet të nxisë:

- **Autonomi dhe pavarësi:** Fëmijëve u jepet liria për t'i zgjedhur aktivitetet dhe materialet që u interesojnë, duke nxitur pavarësinë dhe aftësitë e vendimmarrjes.
- **Motivim dhe angazhim të rritur:** Kur fëmijët kanë kontroll mbi përvojat e tyre të të nxënë, ata janë më të motivuar dhe të angazhuar. Mjedisi edukativ e mbështet këtë duke ofruar burime të ndryshme angazhimi që pasqyrojnë interesat e fëmijëve.
- **Zhvillim holistik:** Një mjedis i gjithanshëm mbështet zhvillimin holistik të një fëmije, duke adresuar nevojat e tij intelektuale, sociale, emocionale dhe fizike.
- **Kreativitet dhe të menduarit kritik:** Një mjedis me fëmijën në qendër i nxit fëmijët të eksplorojnë, të bëjnë pyetje dhe të shprehin idetë e tyre lirisht. Kjo qasje stimulon kreativitetin dhe të menduarit kritik gjersa mësojnë të mendojnë në mënyrë të pavarur dhe të jenë të hapur ndaj zgjidhjeve të reja.
- **Zhvillim të shkathtësive të përditshme:** Përmes lojës dhe përvojave praktike, fëmijët përgatiten për situata të jetës reale, duke zhvilluar aftësi si zgjidhja e problemeve, marrja e përgjegjësisë dhe ndërveprimi shoqëror. Këto janë aftësi që i ndihmojnë të përgatiten për sfidat e jetës dhe përvojat akademike në të ardhmen.
- **Mjedisi më të qetë dhe pozitiv:** Një mjedis me fëmijën në qendër krijon një atmosferë ku fëmijët ndihen të respektuar dhe të kuptuar. Janë më të qetë dhe më të lumtur pasi ndihen të lirë të jenë vetvetja.

Hapësira duhet t'u mundësojë fëmijëve të përvetësojnë sjellje kompetente dhe t'i inkurajojë ata të vënë në lojë mundësitë, potencialin dhe aftësitë me të cilat janë të pajisur.

Fëmija, i udhëhequr nga kurioziteti dhe aftësia e lindur për t'i dhënë kuptim botës, vendos vazhdimisht në fokus fusha të reja kërkimi dhe eksplorimi. Megjithatë, mundësia e eksplorimit të tyre është një veprim që fitohet dhe zhvillohet vetëm përmes ndërveprimit dhe shkëmbimit ndërmjet të rriturit dhe fëmijës. Kjo duhet të merret parasysh kur dizajnohen hapësirat, mjediset dhe situatat, të cilat janë mjete që mundësojnë proceset e eksplorimit.

Si ta bëjmë një mjedis edukativ gjithëpërfshirës?

Një hapësirë mikpritëse dhe gjithëpërfshirëse e IEFH është ajo që përfshinë çdo fëmijë përmes zbatimit të planit të përgjithshëm të parimeve të të nxënë. Mjedisi fizik ka nevojë për tavolina, karrige, lodra së bashku me hapësira aktivitetesh që i përshtaten fëmijëve me çdo aftësi, kuriozitet, kulturë. Objektet nga kultura të ndryshme, gjuhët e folura së bashku me prejardhjet familjare krijojnë lidhje më të thella me secilin fëmijë. Edukatorët flasin, por edhe demonstrojnë përmes fotografive, lëvizjeve të duarve ose pajisjeve speciale që i ndihmojnë fëmijët të mësojnë. Fëmijët mësojnë mirësinë, sjelljet e mira së bashku me punën në grup nga interpretimi i tregimeve së bashku. Çdo fëmijë lëviz, prek gjërat ose flet për të kuptuar ide të reja. Prindërit/kujdestarët u tregojnë edukatorëve se çfarë e bën fëmijën e tyre të veçantë duke i shtuar traditat e tyre në projektet dhe aktivitetet e përditshme. Fëmijët ndihmojnë njëri-tjetrin gjatë kohës në grup, veçanërisht ata që flasin gjuhë të ndryshme ose kanë nevojë për ndihmë shtesë.

4. Organizimi i kohës në mjediset e edukimit në fëmijërinë e hershme

Ky dokument shqyrton rëndësinë e organizimit të kohës për zhvillimin e fëmijëve në nivelin e edukimit në fëmijërinë e hershme. Gjithashtu, ofron udhëzime praktike për edukatorët dhe prindërit në krijimin e rutinave të strukturuar që mbështesin zhvillimin kognitiv, social dhe emocional të fëmijëve. Në një mjedis edukativ, rutinat e strukturuar ndihmojnë fëmijët të ndihen të sigurt dhe ta kuptojnë rrjedhën e ditës së tyre, gjë që mbështet rregullimin e tyre emocional dhe ndërton një ndjenjë parashikueshmërie.

4.1 Zhvillimi i konceptit të kohës

Zhvillimi i ndjenjës së kohës në nivelin e edukimit në fëmijërinë e hershme rrit kuptimin për rutinat e përditshme dhe promovon pavarësinë, përgjegjësinë dhe gatishmërinë për mjedise edukative më të strukturuar në të ardhmen. Në përgjithësi, organizimi dhe perceptimi i kohës, janë elemente thelbësore në krijimin e një përvojë të të nxënës të ekuilibruar dhe mbështetës që mbështetë rritjen individuale dhe kohezionin social.

Fëmijët duhet ta udhëheqin ritmin e ngjarjeve të përditshme. Ngjarjet e përditshme janë ato që përsëriten rregullisht në nivelin e edukimit në fëmijërinë e hershme për të krijuar një strukturë të përditshme. Organizimi i tyre mbështet dhe pohon filozofinë edukative dhe të planifikimit.

Secila ditë në mjediset e edukimit të hershëm (institucione parashkollore) ndjek një sekuençë të planifikuar nga mbërritja deri në largim. Orari ofron strukturë, por përmban elemente më kuptimplota sesa vetëm këto ngjarje thelbësore. Një vështrim më i thellë zbulon se si secila pjesë e jetës së përditshme ka vlerë për fëmijët.

Këto orare shërbejnë si shenjues që i udhëheqin fëmijët gjatë ditës së tyre. Rutina ndërton lidhje midis edukatoreve dhe fëmijëve, së bashku me përcaktimin e kohës natyrore për rritje. Çdo segment i kohës kontribuon në mënyrën se si fëmijët e përjetojnë edukimin e tyre ose e formësojnë progresin e tyre hap pas hapi. Mënyra se si edukatori i planifikojnë këto momente krijon shtigje që fëmijët të fitojnë aftësi, si dhe të krijojnë marrëdhënie. Çdo pikë tranzicioni ose aktivitet shërben për një qëllim të caktuar në procesin edukativ përveç kalimit të kohës dita-ditës.

Kjo strukturë kohore është thelbësore për fëmijët sepse u mundëson atyre të krijojnë një strukturë kohore brenda së cilës do ta vendosin jetën dhe përvojat e tyre. T'i kushtosh vëmendje jetës së përditshme do të thotë t'i japësh fëmijës një instrument të fortë autonomie dhe mirëqeniejeje (falë qetësisë që mund të gjenerojë parashikueshmëria). Fëmija ka mundësinë të izolojë, të vendosë, të kuptojë dhe të ndajë momentet e ditës, pasi ato karakterizohen nga ritme dhe rituale që mbështesin pritjet dhe parashikimin.

Edhe brenda një organizimi të qartë dhe të nevojshëm, jeta e përditshme nuk është kurrë e njëjtë. Çdo ditë, çdo moment i kësaj strukture merr kuptime të ndryshme në lidhje me përvojat individuale; prandaj, është e rëndësishme që struktura të jetë fleksibile, me kapacitet për përfshirje të risive, duke i lejuar fëmijës të fitojë njohuri, dhe duke mbështetur njëkohësisht veçantinë e tij/saj subjektive.

Çfarë nënkuptojmë me “rutinë”?

Për qëllime të këtij udhëzuesi kurrikular, rutina NUK përkufizohet si diçka që përsëritet çdo ditë në të njëjtën mënyrë. Ajo përkufizohet më tepër si një melodi natyrale në vend të hapave mekanikë të bërë çdo ditë. Ky ritëm lëviz në sinkronizim me aktivitetet e fëmijëve, ngjashëm me notat e muzikës së preferuar që i udhëheqin përpara. Modeli i ngjarjeve të pritura ndërton besimin e fëmijëve, shumë ngjashëm me hyrjen në shtëpinë e një shoku të ngushtë. Përmes çdo pjese të planifikuar të ditës, përmes takimeve të mëngjesit, lojërave dhe kohës së ngrënies, fëmijët shohin shtigje të qarta për eksplorim. Këto momente të ndërlidhura e ndërthurin të nxëniti me argëtimin dhe periudhat e pushimit duke krijuar kështu një përvojë të plotë. Fëmijët kanë nevojë për këtë strukturë të caktuar në jetën e tyre, ashtu si bimët që kanë nevojë për orare të ujitjes. Ky model u mundëson atyre të lëvizin midis zbulimit aktiv dhe përqendrimit të qetë. Në këtë mjedis të parashikueshëm, fëmijët qëndrojnë pa shtruar pyetje në lidhje me aktivitetet e ardhshme. Por këto orare duhet të lakohen si degët e pemës, duke ruajtur format bazë, por duke u përshtatur me ndryshimet. Rendi i kthen ndryshimet e vështira në hapa më të lehtë, si ura mbi ujë. Ritmet e rregullta bëjnë më shumë sesa që vetëm e tregojnë kohën, ato krijojnë lidhje besimi dhe u mundësojnë fëmijëve të veprojnë vetëm, si dhe i lumturojnë ditët e tyre.

4.2 Rëndësia e rutinave të strukturuar

Siguria emocionale: Rutinat e parashikueshme krijojnë një ndjenjë sigurie tek fëmijët. Kjo i ndihmon të ndihen të qetë dhe rehat në mjedisin e tyre.

Zhvillimi i vetërregullimit: Një strukturë e qëndrueshme mbështet aftësitë vetërregulluese të fëmijëve. Ata mësojnë të menaxhojnë emocionet dhe sjelljen e tyre brenda rutinave të njohura.

Parashikueshmëria: Njohja e rrjedhës së ditës u jep fëmijëve një ndjenjë kontrolli. Kjo zvogëlon ankthin dhe rrit përqendrimin e tyre në aktivitetet e tyre.

Organizimi i kohës, zhvillimi dhe perceptimi janë procese themelore për nxitjen e zhvillimit kognitiv, social dhe emocional të fëmijëve.

Mbështetja e shkathtësive sociale

- **Të vepruarit me radhë:** Rutinat u mësojnë fëmijëve rëndësinë e të vepruarit me radhë. Kjo ndihmon në zhvillimin e durimit dhe vetëkontrollit.
- **Bashkëpunimi:** Aktivitetet në grup i mësojnë fëmijët të punojnë së bashku. Ata zhvillojnë aftësi thelbësore komunikimi dhe zgjidhjeje të konflikteve.
- **Empatia:** Ndërveprimi i rregullt me bashkëmoshatarët gjatë rutinës nxit zhvillimin e empatisë. Fëmijët mësojnë të kuptojnë dhe t'u përgjigjen ndjenjave të të tjerëve.

Aktivitetet kryesore në orarin ditor

Koha e ushqimit ndërmjet vakteve: Pauzat e rregullta për ushqim mbështesin zhvillimin fizik dhe social. Fëmijët mësojnë zakone të shëndetshme të të ngrënies dhe aftësi komunikimi.

Koha e lojës: Si loja e lirë ashtu edhe ajo e strukturuar janë thelbësore për zhvillimin. Loja nxit kreativitetin, zgjidhjen e problemeve dhe shkathtësitë sociale.

Koha e të mësuarit: Aktivitetet e strukturuar edukative zhvillojnë shkathtësi akademike. Fokusi është në gjuhë, matematikë dhe shkencë përmes lojës së udhëhequr.

Koha e pushimit: Periudhat e pushimit janë të rëndësishme për rigjenerimin mendor dhe fizik. Gjumi i mjaftueshëm mbështet zhvillimin e trurit dhe forcimin e kujtesës.

Oraret e rregullta për aktivitete të tilla si koha e ngrënies, loja, të mësuarit dhe pushimi u mësojnë fëmijëve menaxhimin e kohës dhe konceptin e renditjes, duke i ndihmuar të zhvillojnë një kuptim bazë të kohës si një entitet i matshëm.

Çdo fëmijë ka nevoja unike që duhen marrë parasysh kur bëhet fjalë për organizimin e kohës. Disa mund të kenë nevojë për më shumë pushime, ndërsa të tjerët mund të përfitojnë nga aktivitete shtesë.

Fleksibiliteti në rutina lejon përshtatjen ndaj stileve të ndryshme të të nxënit. Vëzhgimi i kujdesshëm ndihmon në identifikimin e nevojave individuale dhe përshtatjen e orareve në përputhje me rrethanat.

Tema e jetës së përditshme është e lidhur ngushtë me menaxhimin e kohës. Hulumtimet e fundit tregojnë se koncepti i kohës është një nga më komplekset për t'u mësuar nga fëmijët dhe sillet rreth të mësuarit të koncepteve themelore të së shkuarës, së tashmes dhe së ardhmes. Pikërisht nga leximi dhe kuptimi i këtyre koncepteve fëmija mëson të dialogojë (sidomos nga brenda) me konceptin e kohës.

4.3 Mbërritja e fëmijëve në mëngjes

Mirëpritja e fëmijëve në mëngjes si pjesë e një rutine të përditshme është thelbësore për të krijuar një fillim pozitiv dhe mbështetës të ditës së tyre në institucionin e edukimit në fëmijëri dhe hershme. Një përshëndetje e ngrohtë dhe e personalizuar nga edukatorët i ndihmon fëmijët të ndihen të vlerësuar dhe të sigurt emocionalisht, duke krijuar atmosferën për pjesën tjetër të ditës së tyre. Kjo rutinë nxit një ndjenjë përkatësie dhe lidhjeje, duke i ndihmuar kështu fëmijët të kalojnë pa probleme nga shtëpia në institucion. Një mirëseardhje e vazhdueshme në mëngjes mbështet gjithashtu rregullimin emocional, pasi fëmijët do të ndihen të qetë dhe të përgatitur për aktivitetet e ditës kur përshëndeten ngrohtësisht dhe plot afërsi.

Ky moment u mundëson edukatorëve ta vlerësojnë gjendjen emocionale të secilit fëmijë, duke ofruar mundësi për ta adresuar çdo shqetësim ose ankth qysh në fillim. Gjithashtu, kjo ndërton besim ndërmjet fëmijëve dhe edukatorëve, duke nxitur një marrëdhënie mbështetëse që është jetike për të nxënë dhe zhvillimin.

Ritualet e mirëseardhjes, të tilla si këngët e mëngjesit, gjestet përshëndetëse ose thjesht thirrja e emrit të secilit fëmijë, forcojnë bashkësinë e klasës/grupit, duke inkurajuar ndërveprimin dhe bashkëpunimin shoqëror. Për më tepër, kjo rutinë i ndihmon fëmijët të zhvillojnë vetëdijen për kohën, duke sinjalizuar fillimin e strukturuar të ditës në institucionin e EFH-së. Në përgjithësi, përshëndetjet e mëngjesit janë një element kyç në krijimin e një mjedisi edukativ, gjithëpërfshirës dhe emocionalisht të sigurt. Me mbërritjen në institucion, është koha për përshëndetje. Edukatorët duhet të synojnë të kapin dhe përforcojnë ritualet dhe zakonet që mundësojnë një kalim të qetë nga shtëpia në institucionin e EFH-së. Fëmijët dhe prindërit takohen me njëri-tjetrin, me edukatorët, qasen në institucionin e EFH-se dhe zhvillojnë situatat e tyre.

Vlera e përshëndetjes dhe pranimit është në thelb, e shprehur përmes një prirjeje në rritje për:

- t'u përshëndetur me të tjerët (fëmijët dhe prindërit) me ngrohtësi, qetësi dhe gatishmëri për të dëgjuar dhe komunikuar. Kjo thekson rëndësinë e shkëmbimeve të vazhdueshme të komunikimit, madje edhe në rastin e përshëndetjeve "të shpejta", për të mbështetur rëndësinë e ndarjes së përvojave të shtëpisë me ato në institucionin e EFH-së.
- të përgatitur hapësira dhe materiale për të lehtësuar përshëndetjet autonome (për shembull, duke përdorur hapësira dhe materiale midis fëmijëve dhe prindërve) dhe për të mbështetur fillimin e rrëfimeve të reja me lojë. Gjatë kësaj kohe, është gjithashtu thelbësore të mbështet zhvillimi i marrëdhënieve për të lejuar që koha pas përshëndetjes të përjetohet në një mënyrë të pasur dhe kuptimplotë, e njohur si momenti kur fillon dita.

4.4 Mbledhja e mëngjesit

Mbledhja e mëngjesit është thelbësore në edukimin në fëmijërinë e hershme. Ajo krijon një ndjenjë përkatësie në komunitet dhe nxit zhvillimin holistik të fëmijëve. Kjo rutinë e përditshme u jep fëmijëve mundësi për shprehje dhe i përfshin ata në procesin e të nxënës.

Në fokus të mbledhjes së mëngjesit është të shprehurit e mendimeve nga ana e fëmijëve. Në vend që edukatori t'i udhëheqë të gjitha aktivitetet, fëmijët inkurajohen të kontribuojnë me mendimet, idetë dhe reflektimet e tyre, duke i lejuar të ndihen se po i dëgjojmë dhe kuptojmë. Fëmijëve u jepet hapësirë për t'u shprehur lirisht përmes ndarjes së historive, përvojave ose reflektimeve personale. Ky proces ndërton vetëbesimin, rrit aftësitë e komunikimit dhe i ndihmon fëmijët të zhvillojnë një vetëvlerësim të fortë.

Mbledhja e mëngjesit është një platformë e rëndësishme për zhvillimin social-emocional. Fëmijët mësojnë t'i ndajnë ndjenjat dhe shqetësimet e tyre. Ata zhvillojnë aftësi të dëgjimit aktiv dhe empatisë ndaj të tjerëve.

Kjo praktikë ushqen inteligjencën emocionale gjersa fëmijët fillojnë të kuptojnë dhe respektojnë perspektiva të ndryshme. Natyra bashkëpunuese e mbledhjes së mëngjesit forcon gjithashtu marrëdhëniet me bashkëmoshatarët dhe nxit ndjenjën e përkatësisë, duke krijuar një mjedis në klasë ku çdo fëmijë ndihet i përfshirë dhe i vlerësuar.

Mbledhja bën të mundur që fëmijët të shprehen në disa mënyra përveç të folurit. Kjo qasje mbështet fëmijët që mësojnë ndryshe dhe krijon një hapësirë mikpritëse ku secili fëmijë merr pjesë në aktivitete që i ndihmojnë të zhvillohet.

Mbledhja e mëngjesit përfshin gjithashtu kreativitetin dhe forma të ndryshme komunikimi. Për shembull, aktivitetet si vizatimi, këndimi ose përdorimi i gjuhës së trupit për të shprehur ide u mundësojnë fëmijëve të cilët ndihen të pasigurt në shprehjen verbale të marrin pjesë aktive. Në këtë mënyrë, mbledhja respekton dhe përshtatet për stile të ndryshme të të nxënës dhe siguron që çdo fëmijë të mund të angazhohet në mënyrë kuptimplote.

Edukatori kalon nga të qenit udhëheqës në një vëzhgues dhelehtësues, duke dokumentuar mendimet dhe krijimet e fëmijëve, shpesh duke përdorur fotografi dhe shënime. Ky dokumentim ofron njohuri të paçmueshme mbi proceset e të menduarit dhe fazat e zhvillimit të fëmijëve, duke i ndihmuar edukatorët të përshtasin përvojat e ardhshme të të nxënës për t'i përmbushur më mirë nevojat e secilit fëmijë.

Për më tepër, mbledhja e mëngjesit inkurajon zgjidhjen e problemeve dhe të menduarit kritik. Fëmijët shpesh përballen me vendime, të tilla si zgjedhja e temave për diskutim ose se si të organizojnë një aktivitet. Kjo autonomi i mëson se si të mendojnë në mënyrë kritike, të bashkëpunojnë me bashkëmoshatarët dhe të zhvillojnë aftësi vendimmarrëse në një mjedis mbështetës. Kështu, mbledhja bëhet një hapësirë dinamike edukative ku fëmijët e formësojnë në mënyrë aktive rrugëtimin e tyre të të nxënës, duke e ndërlidhur atë fort me interesat dhe përvojat e tyre.

Meqenëse fëmijët vihen në fokus të mbledhjes, edukatorët krijojnë një hapësirë gjithëpërfshirëse dhe fuqizuese ku të nxënës është një proces i përbashkët dhe kuptimplotë, duke krijuar kështu një atmosferë pozitive dhe të përcaktuar për pjesën tjetër të ditës.

Gjatë mbledhjes së mëngjesit, fëmijët duhet ta shprehin potencialin dhe mundësitë e tyre në të gjitha fushat, t'i dëgjojnë të tjerët, të negociojnë dhe të ndërtojnë strategji vendimmarrjeje me bashkëmoshatarët përmes konsensusit, duke mbështetur kompetencat e tyre sociale dhe ndërtimin e demokracisë. Është e rëndësishme që edhe në aktivitetet për fëmijë shumë të vegjël, të paktën një moment i vogël i takimit të jetë i dukshëm (i dallueshëm nga “mëngjesi”).

Ide për ritualet e vogla organizative

- **Thirrja e emrave:** Fëmijët mësojnë t'i identifikojnë bashkëmoshatarët e tyre. Kjo nxit ndërgjegjësimin për grupin.
- **Ndarja e përvojave personale:** Edukatorët mbledhin informata gjatë kohës së pritjes në mëngjes. Këto përvoja ndahen me grupin për t'i forcuar lidhjet dhe për të zhvilluar shkathtësitë e komunikimit.

Procesi i ndarjes së historive ose përvojave personale është një nga mënyrat për t'i bërë fëmijët të ndjehen të dëgjuar dhe të vlerësuar. Edukatorët luajnë një rol kyç në mbledhjen dhe ndarjen e këtyre njohurive, gjë që ndihmon në nxitjen e një lidhjeje më të fortë ndërmjet fëmijëve.

4.5 Organizimi i ditës dhe aktiviteteve

Gjatë mbledhjes së mëngjesit, kryhet planifikimi i bazuar në interesa për t'i dhënë strukturë aktiviteteve të ditës, ku fëmijët e udhëheqin procesin përmes:

- **Vendimeve të përbashkëta:** fëmijët marrin pjesë në vendimmarrje në lidhje me aktivitetet e ditës. Kjo nxit autonominë.
- **Grupimit:** formohen grupe të vogla për projekte specifike, duke lehtësuar bashkëpunimin dhe të nxënit.
- **Ideve për projekte (aktivitete):** Fëmijët inkurajohen të propozojnë ide për projekte. Kjo stimulon kreativitetin dhe iniciativën.

Në këtë mënyrë, mbledhja e mëngjesit shfrytëzohet si kohë për planifikim dhe vendimmarrje të përbashkët. Struktura e mbledhjes, duke përfshirë organizimin në grup dhe sugjerimet për projekte, nxit një ndjenjë përgjegjësie të përbashkët dhe pronësie të ditës. Gjersa fëmijët rriten, është thelbësore që ata të bëhen më autonomë dhe të vetëdijshëm për rolin e tyre në këto vendime.

4.6 Momente joformale

Leximi i librave dhe këndimi: Këto janë aktivitete në grup që nuk duhet të organizohen tepër shpesh, por duhen përdorur në mënyrë të përshtatshme. Këto momente ndihmojnë në krijimin e një atmosfere të këndshme dhe shfrytëzohen për tranzicion në aktivitetet e ditës.

Momentet joformale, si leximi ose këndimi, duhet të integrohen natyrshëm në mbledhjen e mëngjesit. Ato shtojnë ngrohtësi dhe familjarizim, duke i ndihmuar fëmijët të ndihen rehat dhe të relaksuar teksa e nisin ditën.

Ndarja e përgjegjësi

- **Caktimi i roleve:** Fëmijëve u jepen përgjegjësi të tilla si ndihma në rregullimin e klasës. Kjo nxit një ndjenjë të përgjegjësisë personale.
- **Leximi i kalendarit:** Fëmijët njihen me konceptet e kohës, duke i ndihmuar kështu të orientohen gjatë gjithë ditës.

Këto rituale të vogla organizative, të tilla si leximi i kalendarit ose caktimi i detyrave, i ndihmojnë fëmijët të ndihen të përfshirë dhe përgjegjës për mbarrëvajtjen e grupit. Detyra të tilla si shtrimi i tryezës ose mbajtja e klasës së organizuar janë mënyra të thjeshta, por megjithatë të rëndësishme për të mësuar përgjegjësinë dhe punën në grup.

Këto metoda organizative duhet të jenë fleksibile dhe të përshtaten me interesat dhe nevojat e grupit. Ato mund të ndryshojnë gjatë gjithë vitit bazuar në zhvillimin e fëmijëve, mjedisin e klasës dhe projektet përkatëse. Si e tillë, mbledhja e mëngjesit mbetet një pjesë dinamike dhe në zhvillim e sipër e rutinës së përditshme.

4.7 Roli i edukatorit

- **Ndërmjetës:** Edukatori lehtëson diskutimet dhe shkëmbimin e ideve ndërmjet fëmijëve.
- **Dëgjues Aktiv:** Edukatori dëgjon me vëmendje dhe e përshtat takimin në bazë të atmosferës dhe nevojave të grupit.
- **Udhëzues:** Edukatori bën pyetje të hapura për ta inkurajuar të menduarit kritik dhe kreativitetin.

Edukatori merr rolin e një lehtësuesi dhe jo të një udhëheqësi. Duke u ulur së bashku me fëmijët, edukatori krijon një ndjenjë barazie. Mjedisi duhet të jetë i rehatshëm dhe mikpritës për të gjithë.

Akti i mbledhjes është i rëndësishëm sepse u mundëson fëmijëve të ndihen pjesëmarrës aktivë në planifikimin e përgjithshëm. Është thelbësore që idetë, gjestet dhe fjalët e tyre të bëhen të dukshme dhe të vlerësohen gjatë takimit. Rregullimi i ulëseve është thelbësor: edukatorët duhet të ulen në të njëjtin nivel me fëmijët dhe në mes të grupit, jo larg njëri-tjetrit ose në ballë. Ky pozicion nxit një ndjenjë hapësire të përbashkët dhe bashkëpunimi.

Roli i edukatorit është gjithashtu qendror në ruajtjen e kësaj dinamike. Edukatori duhet të bëjë pyetje të hapura dhe të mos japë përgjigje, por përkundrazi të inkurajojë dialogun dhe krahasimin në mesin e fëmijëve. Duke i kushtuar vëmendje atmosferës – qoftë ajo e gjallë apo e qetë – edukatori mund ta menaxhojë rrjedhën e takimit me fleksibilitet dhe kujdes.

Si përfundim, mbledhja e mëngjesit nuk është vetëm kohë për logjistikë, por pjesë thelbësore e edukimit në fëmijërinë e hershme që ndërton komunitetin, nxit autonominë, promovon të nxënit social dhe emocional dhe i ndihmon fëmijëve të marrin një rol aktiv në formësimin e ditës së tyre. Duke krijuar një mjedis ku mund të shprehen lirshëm, ku ka vendimmarrjeje të përbashkët dhe respekt të ndërsjellë, mbledhja e mëngjesit krijon një atmosferë pozitive për pjesën tjetër të ditës.

Kur është e mundur, mbledhja e mëngjesit mund të organizohet **jashtë në natyrë**. Natyra ofron stimuj të freskët dhe përvoja të pasura. Kjo nxit një lidhje me mjedisin dhe promovon shëndetin fizik.

Shembull i orarit:

- 09:00 – Mbërritja dhe përshëndetja
- 09:10 – Hyrje në mbledhjen e mëngjesit
- 09:20 – Diskutim mbi aktivitetet e ditës dhe reflektim mbi ditët e kaluara
- 09:30 – Këndimi i një kënge dhe rrëfimi i tregimeve

Këto momente ndihmojnë në krijimin e një fillimi të strukturuar, por dinamik të ditës, me kohë të ndarë për reflektim, planifikim dhe shprehje kreative përmes muzikës dhe rrëfimit të historive.

4.8 Loja e lirë në edukimin e hershëm

Loja e lirë është thelbësore për zhvillimin holistik të fëmijëve të vegjël. Ajo i mundëson fëmijëve të eksplorojnë, krijojnë dhe angazhohen në aktivitete që u interesojnë, duke nxitur zhvillimin holistik në mënyra që të nxënit e strukturuar nuk mund t'i ofrojë. Koha për lojë të lirë nuk ka të bëjë vetëm me lejimin e fëmijëve që të luajnë gjatë kohës së tyre të lirë. Përkundrazi, është një mundësi e qëllimshme, e lehtësuar me mendime për të zhvilluar shkathtësi kritike kognitive, sociale, emocionale dhe fizike në një mjedis që i jep përparësi interesave dhe nevojave të tyre. Thelbi i kurrikulës sonë është ndërtuar mbi respektin për kuriozitetin natyror të fëmijëve dhe dëshirën e tyre të brendshme për të eksploruar botën përreth tyre.

Autonomia dhe vetëbesimi: Koha e lirë e lojës u lejon fëmijëve të marrin kontrollin e rrugëtimit

të tyre të të nxënit duke zgjedhur aktivitete që nxisin imagjinatën dhe stimulojnë të menduarit e tyre. Kjo autonomi është thelbësore për nxitjen e pavarësisë dhe vetëbesimit.

Zhvillimi i shkathtësive kognitive: Gjatë lojës së lirë, fëmijët zhvillojnë aftësi të rëndësishme kognitive. Ata angazhohen në zgjidhjen e problemeve dhe në të menduarit kreativ. Aktivitete si ndërtimi me blloqe ose eksperimentimi me materiale arti inkurajojnë të menduarit kritik. Fëmijët mësojnë më mirë kur janë të angazhuar në mënyrë aktive në diçka që i intereson, dhe gjatë lojës së lirë, ata kanë më shumë gjasa të zhyten në eksplorim të thellë, zgjidhje problemesh dhe të menduarit kreativ.

Zhvillimi social dhe emocional: Loja e lirë është një mjedis ideal për zhvillimin e shkathtësive sociale. Fëmijët mësojnë të bashkëpunojnë, të negociojnë dhe t'i zgjidhin konfliktet. Ata praktikojnë vetërregullimin dhe shprehjen emocionale në një mjedis të sigurt. Për më tepër, koha e lojës së lirë është jetike për zhvillimin social. Gjatë lojës së pastrukturuar, fëmijët bashkëveprojnë me bashkëmoshatarët e tyre në mënyra organike dhe të vetë-drejtuar, duke mësuar aftësi kritike sociale si bashkëpunimi, negocimi dhe zgjidhja e konflikteve. Ata angazhohen në biseda, bashkëpunojnë në detyra të përbashkëta dhe thellohen në dinamika komplekse sociale, e të gjitha këto kontribuojnë në kuptimin e tyre të marrëdhënieve ndërpersonale. Qasja jonë kurrikulare i inkurajon edukatorët të vëzhgojnë dhe mbështesin këto ndërveprime pa ndërprerë ose drejtuar lojën e fëmijëve, duke u lejuar atyre të zhvillojnë ndjeshmëri, aftësi komunikimi dhe aftësinë për të punuar brenda një grupi me ritmin e tyre.

Shprehja emocionale dhe mirëqenia: Loja e lirë ofron një hapësirë të sigurt për shprehje emocionale. Fëmijët mund t'i përpunojnë përvojat dhe t'i eksplorojnë ndjenjat e tyre. Edukatorët vëzhgojnë pa paragjykim, duke ofruar mbështetje kur është e nevojshme.

Pavarësisht nëse një fëmijë bën sikur kujdeset për një kukull apo ndërtton një botë fantazie, shpesh punon me emocione dhe ide që janë kuptimplota për të. Një qasje e përqendruar te fëmija ndaj lojës së lirë njih natyrën terapeutike të lojës dhe u lejon fëmijëve ta përdorin atë për vetëshprehje dhe përpunim emocional. Edukatorët, në këtë kontekst, vëzhgojnë pa gjykim, duke ofruar mbështetje kur është e nevojshme, por duke u dhënë fëmijëve hapësirën për të punuar me emocionet e tyre në mënyrë të pavarur. Loja e lirë mund të organizohet në mënyra të ndryshme, dhe u mundëson fëmijëve të eksplorojnë dhe të mësojnë rregullimin e emocioneve të ndryshme, si:

Loja me role: Fëmijët mund të luajnë role me personazhe të ndryshëm, duke eksploruar situata emocionale.

Arte kreative: Vizatimi dhe piktura lejojnë shprehjen joverbale të emocioneve.

Lojë shqisore: Manipulimi i materialeve të tilla si rëra ose uji mund të jenë qetësues.

Zhvillimi fizik dhe motorik: Fëmijët zhvillojnë shkathtësi motorike të muskujve të vegjël ose të mëdhenj përmes aktiviteteve që përfshijnë lëvizje të tilla si vrapimi, kërcimi, ngjitja ose manipulimi i objekteve. Perspektiva e kurrikulës sonë mbi lojën e lirë thekson rëndësinë e ofrimit të mundësive të ndryshme për aktivitete fizike për fëmijët, të cilat përputhen me fazat dhe interesat e tyre të zhvillimit. Fëmijët i forcojnë trupat e tyre duke u angazhuar në lojëra në natyrë ose duke punuar me lëvizje të vogla manipulative, teksa ndërtojnë koordinimin dhe ndërgjegjësimin hapësinor.

Aktivitete motorike të muskujve të vegjël: Aktivitete si futja e rruazave në pe përmirësojnë koordinimin sy-dorë dhe saktësinë.

Lojëra në natyrë: Ngjitja dhe vrapimi forcojnë muskujt e mëdhenj dhe përmirësojnë ekuilibrin.

4.8.1 Roli i edukatorëve në lojën e lirë

Edukatorët luajnë një rol të rëndësishëm në lehtësimin e lojës së lirë. Ata krijojnë një mjedis të sigurt dhe stimulues për eksplorim. Vëzhgimi i kujdesshëm u mundëson atyre të mbështesin zhvillimin individual të secilit fëmijë. Roli i edukatorit është të shërbejë si:

- **Vëzhgues:** Edukatorët vëzhgojnë pa ndërhyrje, për t'i kuptuar interesat dhe nevojat e fëmijëve.
- **Mbrojtës:** Edukatorët sigurojnë një mjedis të sigurt fizik dhe emocional për lojë.
- **Mbështetës:** Ofrojnë ndihmë dhe inkurajim kur fëmijët e kërkojnë ose kanë nevojë për të.

Në thelb, koha për lojë të lirë në edukimin në fëmijëri të hershme është një element thelbësor i mjedisit të të nxënës. Me këtë respektojmë lirinë e veprimit të fëmijëve, duke i inkurajuar ata të eksplorojnë botën sipas kushteve të tyre, ndërkohë që ofrojmë mundësi për mësimnxënie në fusha të ndryshme. Përmes lojës së lirë, fëmijët përmirësojnë shkathtësitë e tyre kognitive, sociale, emocionale dhe fizike dhe zhvillojnë një dashuri për të nxënës që lind nga kurioziteti dhe iniciativa e tyre. Në këtë mënyrë, loja e lirë bëhet një praktikë jetësore që respekton individualitetin e secilit fëmijë dhe mbështet zhvillimin e tyre holistik dhe natyror.

4.8.2 Integrimi i lojës së lirë në orarin ditor

Loja e lirë duhet të jetë pjesë integrale e orarit ditor. Mund të planifikohet për mëngjes dhe pasdite, në grupe të vogla ose individualisht. Është e rëndësishme të sigurohet kohë e mjaftueshme për angazhim të thellë në lojë të lirë.

5. Aktivitetet kurrikulare në edukimin në fëmijërinë e hershme

Aktivitetet kurrikulare në edukimin në fëmijëri të hershme janë thelbësore për zhvillimin e fëmijëve. Ato bazohen në nevojat dhe interesat e fëmijëve, duke inkurajuar eksplorimin, zbulimin dhe angazhimin aktiv në procesin e të nxënës.

Në vend që të jetë e ngurtë ose përshtatshme, kurrikula jonë është fleksibile dhe i përgjigjet nevojave, interesave dhe fazave të zhvillimit të secilit fëmijë. Në këtë kontekst, kurrikula i udhëzon fëmijët të eksplorojnë, zbulojnë dhe angazhohen me botën përreth tyre në mënyra kuptimplota, duke nxitur një lidhje të thellë me të nxënësit e tyre dhe duke ushqyer kuriozitetin e tyre natyror.

Edukatorët i vëzhgojnë fëmijët dhe i përshtatin aktivitetet bazuar në vëzhgimet e tyre. Kjo siguron që të nxënësit të jetë relevant dhe tërheqës për secilin fëmijë.

- **Vëzhgimi:** Edukatorët vëzhgojnë interesat dhe sjelljet e fëmijëve.
- **Planifikimi:** Aktivitetet planifikohen bazuar në vëzhgimet e bëra.
- **Zbatimi:** Aktivitetet zbatohen në mënyrë fleksibile, duke u përshtatur me përgjigjet e fëmijëve.

Vetë fëmijët drejtojnë hartimin dhe zbatimin e aktiviteteve kurrikulare. Edukatorët vëzhgojnë interesat, sjelljet dhe ndërveprimet e fëmijëve, duke përdorur këtë informacion për të krijuar aktivitete që janë relevante dhe tërheqëse për secilin fëmijë. Kjo qasje siguron që fëmijët të mbeten aktivisht të përfshirë në procesin e tyre të të nxënësit, pasi aktivitetet lidhen drejtpërdrejt me përvojat e tyre dhe pyetjet që ata shprehin rreth botës. Qoftë përmes rrëfimit të historive, eksperimenteve praktike, artit apo eksplorimit të natyrës, kurrikula bazohet në dëshirat e lindura të fëmijëve për të mësuar, duke u lejuar atyre të udhëheqin rrugëtimin e tyre të të nxënësit në bashkëpunim me bashkëmoshatarët dhe edukatorët e tyre.

- **Rrëfimi i tregimeve:** Fëmijët krijojnë dhe ndajnë tregime bazuar në përvojat e tyre.
- **Eksperimente praktike:** Fëmijët kryejnë eksperimente të thjeshta për të kuptuar fenomenet shkencore.
- **Art:** Fëmijët shprehin idetë e tyre përmes vizatimit, pikturës dhe punimeve artizanale.
- **Eksplorimi i natyrës:** Fëmijët zbulojnë botën natyrore përmes shetitjeve dhe vëzhgimeve të drejtpërdrejta.

Aktivitetet kurrikulare duhet të integrojnë fusha të ndryshme zhvillimore – kognitive, sociale, emocionale, fizike dhe gjuhësore – në aktivitete të këndshme dhe edukative. Për shembull, ndërtimi me blloqe mund të mbështesë zhvillimin kognitiv përmes zgjidhjes së problemeve dhe arsyetimit hapësinor, zhvillimin social përmes bashkëpunimit me bashkëmoshatarët dhe zhvillimin fizik përmes shkathtësive motorike të muskujve të vegjël. Këto aktivitete nuk u imponohen fëmijëve, por lindin natyrshëm nga interesat e tyre, duke i inkurajuar të eksplorojnë koncepte të reja në një mënyrë të përshtatshme dhe tërheqëse. Ato gjithashtu duhet të inkurajojnë të menduarit kritik, kreativitetin dhe aftësitë e zgjidhjes së problemeve. Për shembull, një fëmijë që eksploron rritjen e bimëve në një projekt kopshtarie po mëson përmes përvojave të botës reale, duke bërë ndërlidhje midis veprimeve të tyre dhe rezultateve që vëzhgojnë. Një mësim i tillë i bazuar në eksplorim është një shenjë dalluese e kurrikulës, pasi i fuqizon fëmijët të marrin përgjegjësi për të nxënësit e tyre, teksa zhvillojnë aftësi thelbësore që do t'u shërbejnë atyre gjatë gjithë rrugëtimin të tyre edukativ.

Roli i edukatorit ndryshon nga instruktor në fasilitues dhe udhëzues. Edukatorët krijojnë një mjedis stimulues edukativ të mbushur me materiale dhe mundësi për eksplorim, por ata mbeten fleksibil në planifikimin e tyre, duke i përshtatur aktivitetet për të ndjekur interesat e fëmijëve. Kjo siguron që kurrikula të mbetet dinamike dhe të pasqyrojë nevojat në zhvillim të fëmijëve. Roli i edukatorit përfshin gjithashtu bërjen e pyetjeve të hapura, inkurajimin e të menduarit më të thellë dhe mbështetjen e fëmijëve për të reflektuar mbi përvojat e tyre. Në këtë mënyrë, kurrikula bëhet një përvojë e bashkë-ndërtuar, ku fëmijët luajnë një rol aktiv në formësimin e të nxënit të tyre.

Zhvillimi social dhe emocional: Kurrikula vë në pah zhvillimin social dhe emocional duke krijuar një hapësirë të sigurt dhe edukative ku fëmijët mund të shprehin, të ndëtojnë marrëdhënie dhe të bashkëpunojnë. Përmes aktiviteteve në grup dhe projekteve të përbashkëta, fëmijët mësojnë të komunikojnë, të negociojnë dhe të mbështesin njëri-tjetrin – aftësi jetësore për suksesin e ardhshëm në mjediset akademike dhe në jetën personale. Në këtë mjedis, zërat e fëmijëve dëgjohen, idetë e tyre vlerësohen dhe individualiteti i tyre respektohet, duke kontribuar kështu në një përvojë edukative pozitive dhe fuqizuese.

Zhvillimi i aktiviteteve kurrikulare, përvojave dhe grupeve të vogla: Gjatë mbledhjes së mëngjesit, është thelbësore të parashikohet dhe të përcaktohet një ndarje e fëmijëve në grupe të vogla. Grupet e vogla janë një aspekt i rëndësishëm i aktiviteteve kurrikulare. Ato ofrojnë një mjedis të ngushtë për shkëmbim dhe krahasim.

Në grupe të vogla, fëmijët kanë më shumë kohë për eksplorim individual. I ndajnë idetë e tyre dhe mësojnë nga njëri-tjetri.

5.1 Krijimi i konteksteve edukative për fëmijët

Kontekstet dhe situatat përgatiten nga edukatorët për t'i mundësuar fëmijëve të eksplorojnë, të eksperimentojnë, të bëjnë kërkime, të thellohen në to, të luajnë, të shkëmbejnë refleksione dhe ide, të krijojnë, të njohin dhe të rinjohin, të shprehin gjuhën, dhe të dëgjojnë.

Prandaj, kontekstet duhet të hartohen në një mënyrë të shumëfishtë. Kontekste të tilla duhet të kenë karakteristikat e mëposhtme:

- **Kontekstet e kërkimit (eksplorimit):** organizuar dhe strukturuar nga të rriturit, me propozime, materiale, sugjerime dhe situata që lidhen me objektivat e aktiviteteve/projekteve.
- **Konteksti(et) në klasë:** Hapësirat në klasa janë krijuar për të qenë lehtësisht të qasshme dhe tërheqëse për eksplorim nga grupe të vogla fëmijësh.

Përfitimet e konteksteve të shumëfishta

- **Zhvillimi i aftësive të ndryshme:** Kontekstet e ndryshme inkurajojnë zhvillimin e aftësive të ndryshme. Fëmijët përmirësojnë aftësitë e tyre motorike, sociale dhe kognitive.
- **Përshtatja ndaj stileve të ndryshme të të nxënit:** Shumëllojshmëria e konteksteve përshtatet me stile të ndryshme të të nxënit. Kjo siguron që çdo fëmijë të gjejë një mënyrë të përshtatshme për të mësuar.
- **Nxitja e pavarësisë:** Kontekstet e shumëfishta i inkurajojnë fëmijët të bëjnë zgjedhje. Kjo ndihmon në zhvillimin e pavarësisë dhe vetëbesimit.

Organizimi i aktiviteteve në grupe të vogla

- **Formimi i grupeve:** Fëmijët ndahen në grupe të vogla bazuar në interesat e tyre. Kjo mundëson vëmendje më të personalizuar.

- **Aktiviteti kryesor:** Çdo grup angazhohet në aktivitetin e zgjedhur. Edukatorët ofrojnë mbështetje dhe udhëzime sipas nevojës.
- **Reflektimi:** Pas aktivitetit, grupi diskuton përvojat e tyre. Kjo nxit të menduarit kritik dhe shkathtësitë e komunikimit.

Aktivitetet e mëngjesit në grupe të vogla mund të ofrojnë kohë shtesë për reflektim para drekës. Rreth 15 minuta janë të mjaftueshme për të përmbledhur punën e secilit grup dhe për të ndarë ngjarje të veçanta nga mëngjesi, duke përfshirë reflektimet. Kjo nuk është e detyrueshme, por është praktikë e mirë.

5.2 Aktivitetet kurrikulare

Kurrikula për EFH-në parashikon që aktivitetet të zhvillohen gjatë gjithë ditës, duke ndjekur interesin e fëmijëve, me theks të veçantë në mëngjes. Aktivitetet zakonisht fillojnë pas mbledhjes së mëngjesit dhe përcaktojnë karakterin e tërë ditës. Në këtë kuptim, mbledhja e mëngjesit mundëson një kalim të qetë nga një mbledhje në mësim të përqendruar. Mbledhjet e mëngjesit janë gjithashtu të lidhura me aktivitetet e ditës. Gjatë mbledhjes, fëmijët ndajnë mendime, përvoja ose interesa përmes bisedës, vizatimit ose mjeteve të tjera të shprehjes, me anë të të cilave edukatorët shpesh fitojnë informacione rreth interesave të fëmijëve. Aktivitetet kurrikulare të mëngjesit përdorin energjinë e lartë të fëmijëve përveç përqendrimit. Edukatorët duhet të jenë të vëmendshëm dhe fleksibilë, duke përshtatur planet nëse lidhjet vijnë nga mbledhja. Përveç kësaj, struktura ndërton rutinë dhe siguri sepse fëmijët e njohin dhe ndihen rehat me ritmin e ditës. Integrimi i mbledhjeve të mëngjesit me aktivitetet kurrikulare krijon një qasje pjesëmarrëse me fëmijën në qendër ndaj të nxënit të hershëm. Integrimi do të thotë që rrjedha e ngjarjeve gjatë ditës është fluide dhe i përgjigjet nevojave dhe interesave të fëmijëve. Koha e aktiviteteve kurrikulare mund të ndryshojë dhe të përshtatet gjithashtu në bazë të infrastrukturës ose kërkesave të tjera të personelit për aktivitetin e planifikuar kurrikular, siç është hapësira midis grupeve të fëmijëve të vegjël dhe më të rritur, përshtatjet e bëra për fëmijët me aftësi të kufizuara e kështu me radhë.

5.3 Higjiena

Puna mbi higjienën me fëmijët në edukimin në fëmijëri të hershme është thelbësore sepse i ndihmon ata të zhvillojnë zakone gjatë gjithë jetës që respektojnë stilet dhe ritmet e tyre të të nxënit. Praktikat e higjienës, të tilla si larja e duarve, larja e dhëmbëve dhe pastrimi pas aktiviteteve, mund të mësohen në një mënyrë të këndshme dhe tërheqëse që nxit pjesëmarrjen aktive. Duke i përfshirë fëmijët në diskutime dhe aktivitete që lidhen me pastërtinë personale, edukatorët promovojnë një ndjenjë përgjegjësie për mirëqenien e tyre. Qasja kurrikulare siguron që fëmijët jo vetëm t'i ndjekin udhëzimet, por edhe t'i kuptojnë arsyet pas këtyre praktikave, duke nxitur pavarësinë dhe të menduarit kritik. Angazhimi i fëmijëve në rutinat higjienike përmes këngëve, lojërave dhe ndihmave vizuale e bën të nxënit të këndshëm dhe të arritshëm, duke i ndihmuar t'i përvetësojnë këto zakone thelbësore.

Për më tepër, kjo qasje i ndihmon fëmijët të zhvillojnë aftësi sociale duke mësuar rëndësinë e ruajtjes së një mjedisi të shëndetshëm për veten dhe të tjerët. Edukimi i higjienës gjithashtu mbështet zhvillimin emocional duke rritur vetëvlerësimin, pasi fëmijët ndihen kompetentë në kujdesin për nevojat e tyre.

Edukatorët ofrojnë udhëzime dhe mbështetje, duke u lejuar fëmijëve të marrin përsipër rutinat e tyre të higjienës, duke ndërtuar besim në aftësitë e tyre. Kjo promovon shëndetin fizik dhe ushqen një ndjenjë autonomie, duke i fuqizuar fëmijët të bëjnë zgjedhje të shëndetshme gjersa rriten. Edukimi në fëmijërinë e hershme nxit mirëqenien individuale dhe kolektive duke integruar praktikat e higjienës në aktivitetet e përditshme në mënyrë natyrale dhe kuptimplotë.

Koha kur edukatorët ndërrojnë pelenat e fëmijëve (kryesisht fëmijë të moshës 0-2 vjeç) është një mundësi për të krijuar intimitet të arsyeshëm me fëmijët, veçanërisht përmes kontaktit me sy, buzëqeshjes dhe këndimit të këngëve. Aftësia për të kontrolluar trupin dhe autonomia rrjedhin nga vëmendja e individualizuar gjatë ndërrimit të pelenave, e parë si një situatë shumë edukative. Në mjediset institucionit të edukimit në femijerine e hershme, mundësia për t'u kujdesur për trupin në mënyrë të pavarur është një moment që zhvillon aftësitë individuale dhe mbështet bashkëpunimin dhe marrëdhëniet kognitive dhe eksploruese midis fëmijëve.

5.4 Koha e drekës në Edukimin në Fëmijërinë e Hershme

Në edukimin në fëmijëri të hershme, dreka është pjesë integrale e ditës, që ofron mundësi për të mësuar përtej ushqimit.

Zhvillimi i pavarësisë gjatë drekës

- **Vetëushqyerja:** Fëmijët mësojnë t'i përdorin enët e kuzhinës dhe të hanë vetë. Kjo ndërton koordinimin e shkëlqyer motorik dhe vetëbesimin.
- **Zgjedhja e ushqimit:** Fëmijët inkurajohen të zgjedhin ushqimet që duan. Kjo zhvillon vendimmarrjen dhe vetëdijen për preferencat personale.
- **Menaxhimi i porcioneve:** Fëmijët mësojnë të vlerësojnë se sa mund të hanë. Kjo zhvillon vetërrregullimin dhe ndërgjegjësimin për trupin.

Qasja ndaj kohës së drekës i inkurajon fëmijët të angazhohen në biseda me bashkëmoshatarët e tyre, duke promovuar aftësitë sociale dhe duke ndërtuar një ndjenjë komuniteti. Edukatorët duhet të nxisin diskutime dhe të edukojnë rreth ushqimit, shumëllojshmërisë së shijeve, aromave dhe ngjyrave të ushqimit, përfitimeve shëndetësore dhe preferencave të ndryshme. Koha e drekës shërben gjithashtu si një moment i vlefshëm për të mësuar aftësi praktike jetësore, ndërsa eksperimentohet me autonominë personale përmes mundësisë për t'i shërbyer vetes, për t'u shërbyer miqve, për ta shtruar dhe për ta pastruar tryezën.

Edukatorët mund t'i ndihmojnë fëmijët të zhvillojnë qëndrime pozitive ndaj ushqimit dhe të ngrënit duke krijuar një mjedis të qetë dhe mbështetës, duke siguruar që përvoja të jetë e këndshme dhe pa stres. Fëmijëve u jepet kohë për të ngrënë me ritmin e tyre, duke respektuar nevojat dhe preferencat e tyre. Fëmijët inkurajohen të zgjedhin ushqimin dhe madhësitë e porcioneve që mendojnë se mund t'i hanë, pastaj të marrin përgjegjësinë për balancimin e dietës së tyre dhe shmagjen e shpërdorimit nën mbikëqyrjen e mësuesve.

Kjo autonomi ndërton vetëbesim dhe nxit një ndjenjë përgjegjësie për mirëqenien e tyre. Për më tepër, koha e drekës u mundëson edukatorëve të vëzhgojnë dhe mbështesin zhvillimin fizik dhe emocional të fëmijëve në një mjedis natyror. Të ngrënit së bashku do të thotë të ndash rregulla, të ndash aktivitete dhe të shijosh një kohë ku fëmijët janë thellësisht të përfshirë në analizimin e asaj që po bëjnë fëmijët e tjerë dhe në harmonizimin e sjelljes së tyre me atë të bashkëmoshatarëve të tyre.

Kjo gjithashtu paraqet mundësi për të konfirmuar imazhin e një fëmije kompetent. Besimi në aftësitë e fëmijëve do të thotë të mos i detyrosh të përdorin materiale stereotipike, por t'i lejosh ata të përballen dhe të eksperimentojnë me përdorimin e materialeve "të të rriturve": pjata dhe gota qelqi/qeramike, pirunë dhe thika, mbulesa tavoline ose shishe uji në tavolinë.

Edukatorët e nivelit parashkollor mund të fitojnë njohuri ose informacione rreth shëndetit, gjendjes emocionale dhe mirëqenies së fëmijëve në një mënyrë proaktive për t'i mbështetur sa më shumë që të jetë e mundur. Koha e drekës është gjithashtu një nga kontekstet e para në të cilat fëmijët hanë pa prindërit e tyre dhe në situata sociale. Edukatorët vëzhgojnë progresin, veçanërisht në institucionete edukimit në femijerine e hershme, dhe e dokumentojnë atë për t'i informuar prindërit nëse është e nevojshme.

5.5 Koha e gjumit (ose koha e relaksimit)

Koha e gjumit ose koha e relaksimit në edukimin në fëmijërinë e hershme është thelbësore për zhvillimin e fëmijëve. Fëmijët e vegjël kanë nivele të larta energjie dhe kanë nevojë për periudha pushimi për t'u rikuperuar fizikisht dhe mendërisht.

Koha e gjumit ose e relaksimit është e rëndësishme për shëndetin fizik, pasi i lejon trupit të rikuperohet nga të mësuarit aktiv dhe loja që ndodhë gjatë gjithë ditës. Përveç kësaj, pushimi i mjaftueshëm kontribon në zhvillimin e trurit, duke mbështetur konsolidimin e kujtesës dhe përpunimin kognitiv. Nga një perspektivë emocionale, koha e pushimit ofron një moment paqeje, gjë që mund të jetë veçanërisht e rëndësishme për fëmijët që ende po mësojnë t'i menaxhojnë emocionet dhe ndjenjat e tyre gjatë gjithë ditës. Ndiemon në krijimin e një ndjenje qetësie dhe sigurie, pasi ata e dinë se është në rregull të ndalen dhe të kujdesen për nevojat e tyre në një mjedis mbështetës.

Qasja ndaj kohës së pushimit vlerëson gjithashtu autonominë e fëmijëve, duke ofruar zgjedhje se si ata relaksohen, qoftë përmes aktiviteteve individuale të qeta si leximi ose dëgjimi i muzikës qetësuese, apo gjumit të përditshëm. Edukatorët vëzhgojnë dhe mbështesin ritmin unik të secilit fëmijë, duke pranuar se jo të gjithë fëmijët kanë nevojë për pushim të njëjtë dhe duke e përshtatur rutinën në përputhje me rrethanat. Kjo qasje siguron që fëmijët të mos ndihen nën presion ose të shqetësuar për gjumin, por përkundrazi ta shohin pushimin si një pjesë pozitive dhe të nevojshme të rutinës së tyre të përditshme. Përveç promovimit të mirëqenies fizike dhe emocionale, koha e gjumit mund të jetë një moment reflektues ku fëmijët përpunojnë përvojat e ditës në një mjedis të qetë dhe paqësor.

Për pushim, kurrikula nxit pavarësinë ndërsa fëmijët mësojnë të kalojnë pa probleme nga loja aktive në reflektimin e qetë, një aftësi thelbësore për menaxhimin e niveleve të energjisë teksa rriten. Për më tepër, koha e pushimit mbështet një rutinë të ekuilibruar ditore, duke u lejuar fëmijëve të kthehen në aktivitetet e tyre të freskët dhe të gatshëm për t'u angazhuar në mundësi të reja për mësim.

Edukatorët duhet të krijojnë një atmosferë edukative gjatë kësaj kohe, duke siguruar që mjedisi të jetë i qetë, me ndriçim të zbehtë dhe rehati, duke i ndihmuar fëmijët të ndihen të sigurt dhe të mbrojtur. Çdo fëmijë i ka ritualet dhe zakonet e veta për të rënë në gjumë dhe më pas për t'u zgjuar. Të rriturit duhet t'i respektojnë dhe t'i konsiderojnë këto rituale si një kalim nga një gjendje në tjetrën (gjumë-zgjim) dhe të përpiqen të krijojnë një mjedis që respekton të drejtën e fëmijëve për t'u pushuar dhe për t'u zgjuar me qetësi. Fëmijëve që nuk dëshirojnë të flenë mund t'u ofrohet një alternativë, siç është të qëndrojnë në zonën e librave ose një kohë tjetër e qetë relaksimi në një hapësirë të qetë.

5.5.1 Alternativat për fëmijët që nuk flenë

Ofrimi i alternativave tjera përveç dremitjeve na shërben për nevojat e parashikueshme që ndryshojnë në energji dhe faza zhvillimore. Meqenëse disa fëmijë i rezistojnë gjumit gjatë orëve të ditës, detyrat e strukturuar qetësuese bëjnë që ata të qëndrojnë të përqendruar pa i shqetësuar bashkëmoshatarët e tyre që pushojnë. Klasat përfitojnë nga një zonë e dedikuar për qetësi me drita të zbehta dhe fotele të buta ku fëmijët e vëmendshëm lexojnë ose luajnë në qetësi.

Kjo zonë duhet të ofrojë një larmi librash me figura dhe tregime, ku fëmijët angazhohen në mënyrë të pavarur ose në grupe të qeta. Sendet themelore të prekshme, të tilla si copa pëlhure, lodra ose lojëra të thjeshta, gjithashtu i ndihmojnë fëmijët të ruajnë qetësinë. Kutitë personale të mbushura me aktivitete të qeta, materialet e artit së bashku me faqet për t'u ngjyrosur i japin secilit fëmijë kontroll mbi zgjedhjet që mund t'i kenë për periudhën e pushimit.

Për fëmijët që gjejnë qetësi përmes lëvizjes, dyshekët lejojnë shtrirje të butë shoqëruar me ushtrime themelore të frymëmarrjes ose relaksim të udhëhequr. Përrallat në format audio

ose tingujt e natyrës janë mundësi për të krijuar një atmosferë të qetë pa gjumë të lodhshëm. Ndonjëherë, një hapësirë e veçantë me mbulesa të rënda, e me ndenjësë të mbushura me jastëkë të butë i lejon fëmijët të qetësohen vetë. Disa gjejnë gëzim në kartat me figura ose skenat e krijuara për lojë imagjinare.

Edukatorët duhet t'u shpjegojnë fëmijëve se kjo periudhë është për të pushuar trupin dhe mendjen sipas preferencave personale të fëmijëve për rehatinë. Ata mund të përdorin shenja dhe fotografi për të treguar se cilat detyra i përshtaten këtyre momenteve të qeta. T'u mësohet fëmijëve të vënë re energjinë e tyre i ndihmon të zgjedhin aktivitete të përshtatshme. Një edukator i përkushtuar duhet t'i mbikëqyrë fëmijët që nuk flenë për ta ruajtur qetësinë gjatë gjumit.

Prindërit gjithashtu kanë një rol të rëndësishëm për kohën e qetë të pushimit. Ata ofrojnë njohuri rreth modeleve të gjumit dhe preferencave të fëmijëve të tyre, të cilat formësojnë planifikimin e kohës së qetë. Edukatorët vëzhgojnë dhe përshtaten bazuar në përgjigjen e secilit fëmijë. Të kesh një orar të qëndrueshëm, por fleksibil, krijon parashikueshmëri, megjithëse fëmijët kalojnë midis pushimit dhe lojës së qetë sipas nevojës.

Përmes një planifikimi të kujdesshëm, këto alternativa mbështesin si fëmijët që janë zgjuar, ashtu edhe ata që flenë gjatë periudhave të pushimit. Një mjedis i qetë dhe i organizuar i mundëson secilit fëmijë të rifitojë energjinë në mënyrën e vet të preferuar.

5.6 Aktivitetet e pasdites

Pas kohës së relaksimit ose të gjumit, e cila zakonisht mbaron rreth orës 13:00 - 13:30, pasdita kalon gradualisht drejt përfundimit të ditës së qëndrimit në institucion. Mjedi i klasës bëhet i qetë dhe fëmijët ngadalë kthehen në vetëdije. Periudha fillestare pas zgjimit përfshin ushqime të lehta dhe aktivitete në grupe të vogla. Kështu fëmijët zgjohen plotësisht dhe përshtaten. Edukatorët i mbështesin duke organizuar një mjedis të qetë dhe duke ofruar kujdes.

Kur fëmijët ndihen gati, mund të vazhdojnë me projektet e pasdites, ato që u interesojnë. Kjo mund të përfshijë përfundimin e një vizatimi ose një strukture të filluar më parë, ose bashkimin me një aktivitet të kaluar në grup. Nuk ka presion për t'i përfunduar detyrat. Fëmijët ftohen të ndjekin kuriozitetin dhe ritmin e tyre. Kjo kohë lejon angazhimin me idetë ose materialet e mëngjesit.

Kohë e mjaftueshme i ndahet lojës së lirë, e cila zhvillohet brenda ose jashtë, varësisht nga moti dhe vendi. Loja e lirë është një pjesë e rutinës së përditshme. Ndhmon kreativitetin, pavarësinë dhe zhvillimin social të fëmijëve. Fëmijët zgjedhin aktivitete midis një game mundësish, të tilla si loja imagjinare, ndërtimi, leximi ose aktivitetet në natyrë. Edukatorët vazhdojnë të vëzhgojnë dhe të bashkëveprojnë lehtësisht, duke ofruar mbështetje ose duke zgjeruar lojën kur është e nevojshme.

Gjersa afrohet koha e largimit, edukatorët i ndihmojnë fëmijët të përgatiten për t'u kthyer në shtëpi rehat. Fëmijët marrin pjesë në rregullimin dhe mbledhjen e sendeve, gjë që ndërton përgjegjësi dhe pavarësi. Gjatë atyre momenteve të fundit, edukatorët shpesh ndajnë informata rreth aktiviteteve të përditshme me familjet gjatë marrjes së fëmijëve. Kjo synon të lidhë shtëpinë me institucionin e edukimit në fëmijërinë e hershme, dhe të përfshijë prindërit/kujdestarët në jetëndukative. Fëmijët nuk duhet nxituar në fund të ditës. Vazhohet me qasjen e përqendruar të fëmijës që shihet gjatë gjithë ditës. Struktura e pasdites promovon përmbylljen dhe sigurinë pasi kjo pjesë e ditës i ndihmon fëmijët të përgatiten për kalimin nga institucioni i edukimit në fëmijërinë e hershme për në shtëpi dhe u jep edukatorëve mundësinë të shikojnë lojën dhe ndërveprimet e fëmijëve pa planifikim formal.

5.7 Koha e largimit për në shtëpi

Koha e largimit për në shtëpi ndodhë pasdite kur fëmijët largohen nga institucioni i edukimit në femijerine e hershme për të shkuar në shtëpi. Kjo kohë është e rëndësishme për të krijuar një qark kohor dhe për të rilidhur fëmijën me mjedisin familjar. Koha e largimit për në shtëpi në edukimin në fëmijërinë e hershme është shumë e rëndësishme pasi vendos një ton pozitiv dhe gjithëpërfshirës për ditën tjetër. Është një moment kyç kur çdo fëmijë njihet dhe mirëpritet, duke ndihmuar në krijimin e një ndjenje përkatësie dhe sigurie emocionale.

Koha e largimit për në shtëpi i ndihmon gjithashtu fëmijët të kalojnë pa probleme nga shkolla në mjedisin shtëpiak, duke krijuar një rutinë të njohur që ofron rehati dhe parashikueshmëri. Ajo u jep edukatorëve mundësi për t'u angazhuar me fëmijët duke i inkurajuar të shprehin se si ndihen për ditën e kaluar, pavarësisht nëse ishin të emocionuar gjatë ditës dhe për ditën tjetër, nëse ishin nervozë ose të lodhur. Duke i inkurajuar fëmijët të përshëndeten me njëri-tjetrin, kjo kohë nxit ndërveprimin shoqëror, duke i ndihmuar të zhvillojnë aftësi thelbësore komunikimi dhe ndjeshmëri ndaj bashkëmoshatarëve të tyre. E njëjta gjë vlen edhe për prindërit/kujdestarët, të cilët duhet ta përdorin rutinën e largimit për në shtëpi për t'i kuptuar ato emocione dhe përvoja të fëmijëve.

Kjo kohë është gjithashtu mundësi e mirë për shkëmbim informacioni midis edukatorëve dhe familjeve, dhe si e tillë, një shans i shkëlqyer për të ndërtuar besim bazuar në procesin edukativ të ndërsjellë të fëmijëve.

Mënyra se si fëmijët i përshëndesin prindërit e tyre në mëngjes dhe edukatorët kur shkojnë në shtëpi zbulon gjendjen e tyre emocionale. Vëzhgimi i përshëndetjes dhe ndarja e modaliteteve të saj me fëmijët do të thotë t'i kushtosh vëmendje "ardhjes" dhe "largimit" të tyre nga shtëpia brenda një konteksti të përkohshëm qarkullues, i cili mund të jetë qetësues.

Si të planifikoni rutina ditore gjithëpërfshirëse

Krijimi i një orari gjithëpërfshirës të rutinës ditore kërkon fleksibilitet dhe reagim ndaj nevojave të ndryshme. Filloni me një rutinë të parashikueshme me orare vizuale për t'i ndihmuar të gjithë fëmijët, përfshirë ata me dallime në të nxënë, që të ndihen të sigurt. Jepni kohë të ndryshme për zhvillim aktivitetesh, duke siguruar që fëmijët që kanë nevojë për më shumë kohë për të përpunuar ose përfunduar detyrat të mos nxitohen. Bëni një kombinim të lojës së strukturuar dhe të pastrukturuar për t'u përshtatur me stile të ndryshme të të nxënë dhe nivele energjie. Ofroni mundësi për kohë të qetë së bashku me lojën aktive për të mbështetur fëmijët që mund të kenë nevojë për pushim. Planifikoni seanca edukative në grupe të vogla ose individuale për të ofruar mbështetje shtesë aty ku është e nevojshme. Sigurohuni që tranzicionet ndërmjet aktiviteteve të jenë të qeta, duke përdorur këngë, sinjale ose nxitje vizuale për t'i ndihmuar fëmijët që të përshtaten. Ofroni mundësi për mesim në natyrë dhe me bazë në lëvizje për t'i angazhuar fëmijët kinestetikë dhe fëmijët me nevoja të ndryshme lëvizshmërie. Kini parasysh aspektet kulturore dhe dietike kur planifikoni kohën e vakteve të ushqimit dhe pushimit. Në fund, përfshini familjet në formësimin e orarit, duke mbledhur të dhëna për t'u siguruar që orari i respekton tiparet e ndryshme dhe rutinat e shtëpisë.

6. Kurrikula në praktikë

Ky kapitull ilustron qasjen holistike të edukimit me kompetenca të ndërthurura duke i udhëzuar edukatorët në përfshirjen e aktiviteteve kuptimplota dhe praktike që i angazhojnë fëmijët në dimensione të shumëfishta të të nxënit. Këto aktivitete janë vetëm shembuj dhe nuk duhen ndjekur ashtu siç janë. Ato duhet të jenë një frymëzim për t'u ofruar fëmijëve mundësinë për të filluar me projektet e tyre kërkimore.

Duke lëvizur përtej modeleve tradicionale të mësimdhënies së segmentuar, kjo kurrikulë i fton edukatorët të përqafojnë kompleksitetin e të nxënit në botën reale, ku kompetenca të tilla si të menduarit kritik, bashkëpunimi dhe kreativiteti kryqëzohen natyrshëm. Përmes aktiviteteve praktike të hartuara me kujdes, edukatorët fuqizohen për t'i kultivuar këto aftësi në të njëjtën kohë, duke përfunduar kuptimin se të nxënit është një udhëtim si individual ashtu edhe kolektiv.

Aktivitetet e paraqitura në këtë kapitull nuk kufizohen vetëm në fusha specifike tema ose kompetenca të izoluar. Përkundrazi, matematika, shkenca, gjuha dhe aftësitë sociale janë të ndërlidhura dhe përmirësohen përmes projekteve eksperimentale. Për shembull, fëmijët mund të eksplorojnë kujdesin mjedisor përmes një projekti komunitar që kombinon kërkimin shkencor, matjen matematikore, komunikimin dhe reflektimin etik. Aktivitete të tilla holistike janë tërheqëse dhe transformuese, duke i inkurajuar fëmijët ta shohin të nxënit si një proces të vazhdueshëm që shtrihet përtej klasës.

Gjersa edukatorët i zbatojnë këto aktivitete praktike, ky kapitull shërben si një udhëzues gjithëpërfshirës, duke ofruar praktika të adaptueshme që i përshtaten konteksteve të ndryshme të klasës. Ai thekson rëndësinë e fleksibilitetit në kurrikulë dhe i inkurajon edukatorët të jenë kreativë dhe të përgjegjshëm ndaj nevojave unike të fëmijëve të tyre. Duke integruar aktivitete praktike që nxisin rritjen akademike dhe emocionale, edukatorët luajnë një rol kyç në ndihmën e fëmijëve për të realizuar potencialin e tyre si qytetarë aktivë – të zhytur thellë në mendim dhe të angazhuar me kontekstin në Kosovë dhe në botë.

Kombinimi i njohurive, aftësive dhe vlerave synon të nxisë një përvojë edukative që është njëkohësisht pasuruese dhe gjithëpërfshirëse, duke i përgatitur fëmijët **jo vetëm** për sukses akademik, por edhe për një **jetë kuptimplotë dhe të përmbushur**.

Seria e shembujve në këtë kapitull duhet të konsiderohet si diçka ndryshe prej një liste aktiviteteve që duhen bërë, por si një katalog idesh se ku të fillohet ose të vazhdohet me fëmijët rreth kompetencave të ndryshme. Çdo grup dhe çdo klasë duhet të jetë e lirë të ndërtojë rrugën e vet të të nxënit bazuar në interesat e djemve dhe vajzave në grup. Edukatorët duhet të fillojnë duke vëzhguar interesat dhe bisedat e fëmijëve për të kuptuar se si ta strukturojnë planifikimin e aktivitetit dhe cilat sfida duhen trajtuar me fëmijët.

Meqenëse këto aktivitete, projekte, përvoja dhe ide mbulojnë shumë kompetenca dhe ndonjëherë të gjitha, është pjesë e rrugëtimit vëzhgues të edukatorit të kuptojë se cilat aftësi dhe shkathtësi po i zhvillojnë fëmijët dhe në cilat fusha po i thellojnë njohuritë e tyre.

6.1 Biseda në grupe të vogla dhe pyetje të hapura

Diskutimet në grupe të vogla janë pjesë thelbësore e të nxënit të hershëm, duke nxitur kështu zhvillimin e gjuhës, si dhe aftësitë kritike sociale dhe emocionale. Fëmijët ndihen të inkurajuar t'i shprehin mendimet e tyre, të dëgjojnë në mënyrë aktive dhe të krijojnë lidhje me bashkëmoshatarët e tyre në këto mjedise intime. Diskutimet në grupe të vogla u mundësojnë fëmijëve të vegjël të eksplorojnë dhe shprehin lirisht ide, duke stimuluar kuriozitetin dhe besimin në ndarjen e perspektivave të tyre. Këto ndërveprime gjithashtu ushqejnë empatinë, ndërsa fëmijët mësojnë t'i vlerësojnë pikëpamjet dhe përvojat e ndryshme. Diskutime të tilla mbështesin

rritjen e fjalorit, të kuptuarit dhe themelet e dialogut me respekt. Ky kapitull ofron strategji për krijimin e bisedave të strukturuar, por fleksibile, në grup, duke siguruar që çdo fëmijë të ndihet i vlerësuar dhe i dëgjuar.

Duke i udhëhequr fëmijët përmes këtyre diskutimeve, edukatorët hedhin themelet për të nxënit bashkëpunues dhe lidhjet shoqërore që do t'u sjellin dobi atyre për vitet që vijnë.

Edukatorët duhet të ndërhyjnë sa më pak të jetë e mundur dhe t'i lejojnë fëmijët të flasin. Roli i edukatorit është të bëjë pyetje të hapura dhe sqaruese që synojnë të mbështesin bisedën ndërmjet fëmijëve dhe të vëzhgojë e shqyrtojë çështjet e ndryshme të ngritura nga fëmijët. Jo çdo fëmijë ka nevojë të flasë; disa mund të preferojnë të heshtin, por është thelbësore t'i inkurajojmë të kontribuojnë sa më shumë që të jetë e mundur në punën në grup me idetë dhe sugjerimet e tyre përmes formave të ndryshme të shprehjes.

Biseda interesante mund të bëhen gjatë takimeve të mëngjesit ose gjatë kohës për reflektim dhe gjithashtu mund të shërbejnë si pikënisje për procese të tjera edukative.

Një edukator\e mund të fillojë një bisedë duke propozuar një temë që e ka vëzhguar me fëmijët ose duke bërë një pyetje të hapur, duke shmangur pyetjet po/jo ose pyetjet me një përgjigje të pritshme. Pyetjet e hapura janë thelbi i një bisede të mirë me fëmijët dhe formulohen si një pohim që kërkon një përgjigje më të gjatë.

Shembuj të pyetjeve me përgjigje të hapura janë dhënë më poshtë:

Pyetje strategjike

Këto pyetje i ndihmojnë fëmijët të mendojnë rreth zgjidhjes së problemeve dhe planifikimit.

- Çfarë mund të bëjmë ne nëse shoku/shoqja jonë ndihet i/e trishtuar/e?
- Si mund ta bëjmë klasën\grupin tonë edhe më argëtues për të mësuar?
- Nëse do të donim të ndërtonim kullën më të lartë, çfarë do të duhej të provonim më parë?
- Çfarë mendoni se do të ndodhë nëse i shtojmë më shumë ujë rërës?
- Si mund të bashkëpunojmë për ta zgjidhur këtë enigmë?
- Çfarë mund të bëjmë për këtë...?
- Çfarë mjetesh na duhen për të...?
- Si mendoni se duhet të vazhdojmë me...?

Pyetje reflektuese

Këto pyetje i inkurajojnë fëmijët të reflektojnë mbi përvojat dhe ndjenjat e tyre.

- Cila ishte pjesa më e mirë e ditës tënde sot? Pse?
- Si u ndjeve kur ndihmove shokun tënd dje?
- Çfarë të befaso i më shumë në tregimin tonë të sotëm?
- A mund të më tregosh për një rast kur je ndjerë vërtet krenar për veten?
- Çfarë mësuat kur luanim jashtë?
- A e keni parë ose dëgjuar ndonjëherë këtë koncept më parë?
- A e keni provuar ndonjëherë këtë përvojë?
- A ke luajtur ndonjëherë me shokun/shoqen X të grupit?
- Bazuar në përvojën tënde, a ke provuar ndonjëherë ta bësh këtë?

Pyetje jo të drejtpërdrejta

Këto pyetje i inkurajojnë fëmijët të shohin perspektiva të ndryshme dhe t'i ndërlidhin idetë me miqtë ose të tjerët.

- Çfarë mendon se mund të ndiejë shoku/shoqja jote për këtë tregim?
- Si do t'ia përshkruaje këtë fotografi dikujt që nuk e ka parë ende?
- Kush mund t'ju ndihmojë të mendoni pse kafshët jetojnë në vende të ndryshme?
- Në mesin e miqve tuaj, a ka ndonjë që mund t'ju ndihmojë të mendoni/të bëni kërkime rreth fluturave?
- Si ngjan kjo lodër me diçka tjetër me të cilën ke luajtur? Dhe a mendon se ndonjë nga miqtë e tu do të donte të diskutonte për këtë temë?
- Kush do të mund t'ju ndihmonte ta bëni këtë?
- Cili nga shokët/shoqet e klasës/grupit mund të jetë i dobishëm në...?
- Me kë do të dëshironit të punonit...?

Pyetjet me përgjigje të hapura kërkojnë që një person (një fëmijë) të ndalet, të mendojë dhe të reflektojë. Përgjigjet përfshijnë kreativitet, ndjenja, opinione dhe ide personale. Kontrolli i bisedës kalon nga personi që bën pyetjen te personi/personat ose fëmija që pyetet.

Kur flasim për pyetje të hapura, nuk janë vetëm pyetjet që duhet të jenë të hapura. Burimet që u ofrohen fëmijëve duhet të jenë gjithashtu të hapura. Fëmijëve duhet t'u jepen burime për t'i ndihmuar të realizojnë eksplorimet dhe pyetjet e tyre. Natyra përdoret për të ndihmuar në krijimin e lidhjeve dhe një përvojë autentike të të nxënit shqisor, duke nxitur njëkohësisht respektin dhe kujdesin.

6.2 Rrëfimi i tregimeve dhe zhvillimi i tyre

Për të qenë në gjendje për të rrëfyer një tregim, është e nevojshme të kesh fjalët për ta bërë këtë, që do të thotë të kesh mundësinë për ta bërë tregimin një vend për përmbushjen e përvojës së jetuar, duke e bërë atë të përhapur.



Sugjerime praktike për rrëfimin e tregimeve, përrallave dhe storjeve me fëmijë

Tregimet, përrallat dhe storjet duhet të jenë të shkurtra dhe të thjeshta.

1. Shkurtë dhe thjeshtë

- › **Qartësia është çelësi:** Mundohuni të rrëfeni tregime të shkurtra dhe të fokusuara (rrëfimet e shkurtra dhe të thjeshta janë thelbësore për këtë nivel edukimi).
- › **Gjuha e thjeshtë:** Përdorni gjuhë të drejtpërdrejtë dhe fjali të shkurtra që janë të lehta për t'u kuptuar nga fëmijët e vegjël.

2. Përdorni përsëritjen përmes njohjes:

Fëmijët e nivelit parashkollorë, veçanërisht ata më të vegjël (2-4 vjeç), kënaqen me frazat ose refrenet e përsëritura, të cilat u ndihmojnë të kujtojnë pjesë të historisë dhe të marrin pjesë aktive.

- › **Formësimi i kujtesës:** Përsëritja forcon kujtesën, duke ua bërë më të lehtë atyre që ta ritregojnë rrëfimin më vonë.

3. Interaktive

- › **Bëni pyetje:** Kërkoni nga fëmijët të hamendësojnë se çfarë do të ndodhë më pas ose të identifikojnë personazhet dhe objektet në tregime.
- › **Ndërveprimi fizik:** Inkurajoni lëvizje, të tilla si duartrokitjet ose imitimi i veprimeve të personazheve, për t'i mbajtur të angazhuar.

4. Përdorni mjete vizuale dhe mbështetëse

- › **Ilustrime:** Librat me figura janë ideale për fëmijët e vegjël, pasi imazhet i ndihmojnë të ndjekin dhe ta kuptojnë më mirë tregimin.
- › **Objekte dhe kukulla:** Sende të thjeshta si kukulla dore, lodra pelushi apo edhe objekte të përditshme e sjellin tregimin në jetë dhe e bëjnë atë të paharrueshëm.

5. Përfshini efekte zanore dhe variacione

- › **Zëra dinamikë:** Përdorni zëra të ndryshëm për secilin personazh, duke ndihmuar në dallimin e roleve dhe duke shtuar emocion.
- › **Efektet zanore:** Tingujt e kafshëve, zhurmat natyrore (p.sh., "fishkëllima" për erën) ose tinguj të thjeshtë (si një trokitje në derë) rrisin angazhimin.

6. Inkurajoni pjesëmarrjen

- › **Përgjigje korale:** Lejoni fëmijët të bashkohen me fraza të përsëritura, duke krijuar emocione dhe duke përforcuar historinë. Për shembull: "A jeni dakord me ujkun?" (dhe ata mund të përgjigjen).
- › **Loja me role:** Lejojini fëmijët t'i imitojnë veprimet e personazheve ose edhe të zgjedhin se çfarë duhet të bëjë një personazh më pas, duke krijuar një përvojë bashkëkrijuese të rrëfimit.

7. Përdorni ritëm, rima dhe këngë

- › **Shto melodi:** Përdorni këngë ose vargje me rimë për ta bërë tregimin më muzikal dhe të paharrueshëm.
- › **Frazat që rimojnë:** Rimat ndihmojnë në zhvillimin gjuhësor dhe i bëjnë historitë më argëtuese për dëgjuesit e vegjël.

8. Përshtatni historitë sipas interesave dhe mjedisit të fëmijës

- › **Personalizimi:** Përfshini mjedise, kafshë ose njerëz të njohur për ta bërë tregimin relevant.
- › **Përdorni emra të njohur:** Përdorni emrat e fëmijëve në grup ose të anëtarëve të familjes për të krijuar një lidhje personale.

9. Shfrytëzoni angazhimin fizik me shëtitje dhe rrëfime në të njëjtën kohë

- › **Shëtitje dhe rrëfime:** Rrëfëni tregimin gjersa jeni duke lëvizur, si p.sh. duke ecur në pjesë të ndryshme të klasës ose duke aktruar kinse po udhëtoni. Kjo është një mënyrë e shkëlqyer që fëmijët të harxhojnë energji gjersa dëgjojnë.
- › **Loja me role:** Lëri fëmijët të interpretojnë skena të thjeshta, veçanërisht kur rrëfejnë tregime me shumë aksion, si kërcimi mbi lumë ose ikja nga shiu.

10. Përdorni gjuhë ekspresive të fytyrës dhe trupit

- › **Shfaqni emocione:** Shtoni shprehjet e fytyrës për t'i ndihmuar fëmijët të kuptojnë emocione dhe tone të ndryshme në tregim.
- › **Gjuha e trupit:** Veprime të tilla si përkulja për t'u dukur i vogël ose qëndrimi drejt për një personazh "gjigant" e bëjnë tregimin më interesant.

11. Zgjedhni temat e tregimeve familjare ose lidhni ato me kulturën e Kosovës

- › **Subjekte të ngjashme:** Zgjedhni tema rreth përvojave të jetës së përditshme (koha e gjumit, vizitat në park, krijimi i miqësive) që lidhen me jetën e tyre.
- › **Mesazhe pozitive:** Zgjedhni histori të thjeshta me parime morale, të tilla si mirësia, ndarja e gjërave me të tjerët dhe guximi për t'i mësuar vlerat në një mënyrë delikate.

12. Përfundoni me një përmbledhje dhe reflektim

- › **Përmbledhje:** Pasi ta rrëfëni tregimin, shqyrtoni pikat kryesore me fëmijët dhe bëni pyetje të thjeshta për ta vlerësuar kuptimin e tyre.
- › **Kërkoni versionin e tyre:** Lëri fëmijët të ritregojnë pjesë të rrëfimit ose t'i përshkruajnë pjesët e tyre të preferuara, gjë që ndihmon në përfundimin e asaj që kanë mësuar.

Kompetencat e mbuluara

Kompetenca 1	Kreativiteti dhe të	Rrëfimi dhe zhvillimi i tregimeve mundëson që fëmijët të imagjinojnë personazhe të reja, përfundime alternative dhe tregime origjinale. Derisa parashikojnë se çfarë mund të ndodhë më pas ose reflektojnë mbi zgjedhjet e personazheve, ata angazhohen në forma të hershme të të menduarit kritik dhe zgjidhjes së problemeve. Kur ritregojnë rrëfime ose krijojnë të reja, ata reflektojnë mbi renditjen, emocionet dhe logjikën narrative – duke ndërtuar vetëdije metakognitive rreth mënyrës se si funksionojnë tregimet dhe si marrin formë idetë e tyre.
Kompetenca 2	Komunikimi përmes gjuhëve verbale dhe joverbale	Ky aktivitet mbështet fuqishëm shkathtësitë e komunikimit. Fëmijët dëgjojnë, përgjigjen dhe marrin pjesë përmes përsëritjes korale, diskutimit dhe lojës me role. Ata e përdorin gjuhën në mënyrë ekspresive, mësojnë fjalor të ri dhe zhvillojnë rrjedhshmëri në rrëfimin e tregimeve. Shprehjet joverbale – gjestet, shprehjet e fytyrës dhe lëvizja – pasurojnë komunikimin e tyre, veçanërisht kur luajnë skena ose përdorin kukulla dhe objekte.

Kompetenca 3	Kompetenca socio-emocionale Përveç kësaj, të menduarit kritik (Kompetenca 1).	Tregimet i ndihmojnë fëmijëve të kuptojnë emocionet, empatinë dhe marrëdhëniet. Ata i mësojnë ndjenjat dhe motivimet e personazheve dhe i lidhin ato me përvojat e tyre. Kur ftohen të luajnë role ose të bëjnë interpretime, ata shprehin iniciativë dhe vetëbesim. Reflektimi mbi mesazhet e historisë – si drejtësia, mirësia ose guximi – i ndihmon fëmijët t’i përpunojnë situatat sociale dhe ta zhvillojnë inteligjencën emocionale.
Kompetenca 4	Shkencë, teknologji dhe logjikë	Edhe pse më pak e drejtpërdrejtë, kjo kompetencë mbështetet përmes strukturave të rrëfimit të tregimeve: njohja e sekuencave (fillimi, mesi, fundi), marrëdhëniet shkak-pasojë (“Çfarë ndodh nëse...?”) dhe kuptimi i modeleve gjuhësore (përsëritja, ritmi, rimat). Disa histori mund të përfshijnë gjithashtu koncepte matematikore ose shkencore, si madhësitë, koha ose fenomenet natyrore, varësisht nga tema e zgjedhur. Ritregimi dhe renditja e ngjarjeve ndërton renditje logjike dhe arsyetim narrativ.
Kompetenca 5	Qytetaria globale	Kur tregimet pasqyrojnë kulturën lokale, jetën familjare dhe temat e bashkëjetesës, ato nxisin identitetin, përkatësinë dhe ndërgjegjësimin kulturor. Përdorimi i gjuhës dhe personazheve gjithëpërfshirëse promovon barazinë gjinore dhe sfidon stereotipet. Kur fëmijët dëgjojnë ose tregojnë histori për natyrën, kujdesin ose komunitetin, ata fillojnë të ndërtojnë një kuptim të hershëm të qëndrueshmërisë dhe qytetarisë globale. Rrethi i rrëfimit të tregimeve gjithashtu shërben si model për pjesëmarrjen gjithëpërfshirëse dhe demokratike.

6.3 Aktivitete të përditshme nga fushat e matematikës dhe logjikës

Fëmijët, kur janë duke luajtur, nuk e mendojnë botën si një vend disipline. Ata e përjetojnë atë përmes lojës. Por, gjersa luajnë, ata angazhohen në shumë aktivitete dhe përvoja që lidhen me fushat e kompetencave të të nxënës, duke përfshirë ato të përcaktuara nga kjo kurrikulë. Ata zhvillojnë shumë lojëra matematikore dhe logjike dhe kryejnë shumë operacione logjike në lojën e tyre. Grupimi, lidhja, renditja dhe krijimi i sekuencave dhe ritmeve janë vetëm disa nga veprimet logjike që i krijojnë gjatë lojës. Edukatori/i rrituri duhet t’i kushtojë vëmendje dhe të punojë për t’i bërë këto të dukshme. Është thelbësore t’i ndihmojmë të reflektojnë, dhe më vonë t’i dokumentojnë këto refleksime me ndihmën e dokumentimit, mbi aktivitetet dhe proceset e ndryshme të të nxënës që i zbatojnë në praktikë. Ndërgjegjësimi i tyre për proceset e ndryshme (metakognicioni) është jashtëzakonisht i rëndësishëm për shqyrtim.

Ja disa strategji konkrete për t’i vëzhguar eksperimentet natyrore matematikore dhe logjike të fëmijëve:

1. Vëzhgoni renditjen dhe klasifikimin e sjelljeve

- › Shikoni se si fëmijët i grupojnë materialet sipas attributeve të tilla si ngjyra, madhësia, forma ose lloji. Kjo tregon aftësi të hershme në klasifikim dhe renditje.
- › Dëgjoni shpjegimet ose arsyetimin pas zgjedhjeve të tyre të grupimit, të cilat mund të tregojnë se si i kuptojnë ngjashmëritë dhe ndryshimet.

2. Vrojttoni njohjen dhe krijimin e modeleve

- › Vëzhgoni nëse fëmijët krijojnë ose përsërisin modele (p.sh., alternimin e ngjyrave ose formave), gjë që pasqyron aftësinë e tyre për t’i njohur dhe formuar modelet.
- › Shihni nëse i vazhdojnë apo i zgjerojnë modelet që i kanë filluar, duke demonstruar një vetëdije për rendin dhe parashikueshmërinë.

3. Numëroni dhe përcaktoni sasinë e sendeve në lojë

- › Kushtojini vëmendje nëse fëmijët i numërojnë objektet me zë të lartë gjersa luajnë, duke demonstruar korrespondencë një-me-një dhe aftësi numërimi.
- › Vini re nëse e përcaktojnë sasinë ose i vlerësojnë shumat në mënyrë joformale (p.sh., “Unë kam tri blloqe”), duke treguar njohuri të qarta të numrave dhe sasive.

4. Keni parasysh ndërgjegjësimin dhe orientimin hapësinor

- › Vëzhgoni se si fëmijët i vendosin materialet në raport me njëra-tjetrën (p.sh., duke i grumbulluar, renditur ose pozicionuar sendet në kënde), duke treguar një vetëdije për marrëdhëniet hapësinore.
- › Dëgjoni gjuhën hapësinore (p.sh., “pranë”, “mbi”, “nën”) për të parë nëse përdorin dhe kuptojnë fjalorin pozicional.

5. Identifikoni strategjitë e zgjidhjes së problemeve si dhe tentimet dhe gabimet

- › Vëzhgoni se si fëmijët reagojnë ndaj sfidave, të tilla si balancimi ose stabilizimi i materialeve, pasi kjo zbulon qasjen e tyre ndaj zgjidhjes së problemeve.
- › Vëzhgoni momente kur ata eksperimentojnë me metoda të ndryshme, duke treguar fleksibilitet, të menduar logjik dhe këmbëngulje në arritjen e qëllimit të tyre.

6. Vëzhgoni aftësitë e njohjes së formave dhe gjeometrisë

- › Kushtojini vëmendje nëse fëmijët i njohin dhe i emërtojnë format gjatë lojës, duke demonstruar kuptimin bazë gjeometrik.
- › Vini re nëse i rregullojnë format në mënyrë korrekte (p.sh., vendosja e objekteve rrethore në hapësira të rrumbullakëta), duke demonstruar arsyetim hapësinor dhe gjeometrik.

7. Vlerësoni përdorimin e gjuhës krahasuese dhe matëse

- › Dëgjoni terma të tillë si “i madh”, “i vogël”, “më i gjatë”, “më i shkurtër”, të cilët tregojnë njohuri për matjen krahasuese.
- › Vëzhgoni nëse fëmijët përdorin materiale për të matur ose vlerësuar madhësinë në mënyrë joformale, duke treguar një kuptim të matjes dhe krahasimit (matje jo standarde).

8. Vini re arsyetimin shkak-pasojë

- › Vini re nëse fëmijët parashikojnë rezultate (p.sh., “Nëse e vendos këtë këtu, do të bjerë”) ose testojnë skenarë shkak-pasojë, duke demonstruar të menduarit logjik.
- › Vëzhgoni nëse e përshtatin qasjen e tyre bazuar në rezultate, siç është ndërtimi i strukturave më të qëndrueshme, duke demonstruar arsyetim adaptiv.

9. Vëreni numërimin dhe gjuhën bazë të aritmetikës

- › Vëreni fëmijët kur mbledhin ose zbresin sende gjatë lojës (p.sh., “Më duhet edhe një” ose “Tani kam dy”), duke treguar aftësi themelore aritmetike.
- › Kushtojini vëmendje nëse ata i vlerësojnë apo i numërojnë materialet e nevojshme për të përfunduar një strukturë, duke zbuluar aftësi të reja mbledhjeje dhe zbritjeje.

10. Inkurajoni gjuhën përshkruese dhe reflektuese

- › Inkurajoni fëmijët të shpjegojnë se çfarë po bëjnë, duke zbuluar procesin e tyre të të menduarit dhe arsyetimin logjik.
- › Bëni pyetje të hapura si “Pse e vendosët atë aty?” për t'i inkurajuar që t'i artikulojnë zgjedhjet dhe proceset e tyre.

11. Vëzhgoni modele të qëndrueshme me kalimin e kohës

- › Dokumentoni çdo sjellje ose strukturë të përsëritur që e ndërtojnë vazhdimisht, të cilat mund të tregojnë mjeshtëri ose rritje në të kuptuarit e fushave specifike.
- › Ndiqni kompleksitetin e lojës së tyre për të parë nëse evoluon me kalimin e kohës, duke zbuluar zhvillim në aftësitë logjike dhe matematikore.

12. Vini re lojën bashkëpunuese dhe krahasuese

- › Vëzhgoni ndërveprimet ku fëmijët krahasojnë madhësitë, sasitë ose format me bashkëmoshatarët, duke demonstruar vetëdijen për krahasimin dhe negocimin social.
- › Vëzhgoni se si i ndajnë materialet, pasi kjo mund të tregojë njohuritë e tyre për drejtësinë, sasinë dhe konceptet themelore të ndarjes.

13. Vlerësoni aftësitë në parashikimin dhe planifikimin e problemeve

- › Vini re nëse fëmijët fillojnë me një plan të qartë ose parashikojnë sfida të mundshme para se të fillojnë, duke treguar largpamësi dhe aftësi planifikimi.
- › Shihni nëse mbledhin materiale specifike më parë apo i rregullojnë ato qëllimisht, gjë që mund të tregojë renditje logjike dhe aftësi planifikimi.

14. Vëzhgoni aftësitë e vlerësimit dhe përafrimit

- › Vëzhgoni nëse fëmijët bëjnë vlerësime të sasive ose madhësive, qoftë edhe në mënyrë joformale, duke treguar ndjenjën e tyre intuitive të numrave dhe madhësive.
- › Vini re nëse e vlerësojnë se çfarë është “e mjaftueshme” ose “tepër” për krijimet e tyre, duke reflektuar një kuptim të vlerësimit dhe kufizimeve.

Kompetencat e mbuluara

Kompetenca 1
Kreativiteti dhe të menduarit kritik

Fëmijët shprehin natyrshëm kreativitet dhe angazhohen në të menduarit kritik gjersa krijojnë struktura, grupojnë objekte dhe zhvillojnë modele. Kur përballen me sfida gjatë ndërtimit ose klasifikimit, ata provojnë strategji të reja – duke demonstruar zgjidhjen e problemeve dhe fleksibilitet. Parashikimet, vlerësimet dhe eksperimentimi i tyre me metodën e provës dhe gabimit pasqyrojnë të menduarit e nivelit të lartë. Kur edukatorët i angazhojnë ata në reflektim – duke bërë pyetje ose duke dokumentuar mendimet e tyre – fëmijët fillojnë të zhvillojnë vetëdije metakognitive, duke menduar se si mendojnë dhe mësojnë.

Kompetenca 2
Komunikimi përmes gjuhëve verbale dhe joverbale

Gjersa fëmijët luajnë së bashku, ata negociojnë role, ndajnë materiale dhe shpjegojnë ide duke përdorur sinjale verbale dhe joverbale. Kjo i ndihmon të zhvillojnë gjuhën sociale dhe kapacitetin shprehës. Gjuha përshkruese e përdorur gjatë lojës (“Më duhet edhe një”, “kjo është më e madhe”) dhe komunikimi përmes gjesteve dhe pozicionimit të trupit janë të gjitha shenja të zhvillimit të kësaj kompetence. Roli i të rriturve në inkurajimin e diskutimit të fëmijëve për të artikuluar proceset e tyre të mendimit forcon aftësitë shprehëse dhe komunikuese.

Kompetenca 3	Kompetenca socio-emocionale Përveç kësaj, të menduarit kritik (Kompetenca 1).	Loja e lirë dhe eksploruese nxit rregullimin emocional dhe vetëbesimin. Kur fëmijët tregojnë këmbëngulje në zgjidhjen e problemeve – si stabilizimi i një kulle – ata demonstrojnë iniciativë dhe këmbëngulje. Ata vlerësojnë rreziqet në mënyrë intuitive, për shembull, duke testuar ekuilibrin ose duke parashikuar nëse diçka do të bjerë. Nëpërmjet këtyre momenteve, ata zhvillojnë qëndrueshmëri dhe kontroll emocional. Inkurajimi i fëmijëve për të reflektuar mbi zgjedhjet e tyre nxit vetëdijen dhe mbështet zhvillimin metakognitiv.
Kompetenca 4	Shkencë, teknologji dhe logjikë	Ky aktivitet është i rrënjësor drejtpërdrejt në zhvillimin e kësaj kompetence. Fëmijët angazhohen në klasifikim, modelim, arsyetim hapësinor, vlerësim dhe aritmetikë bazë – aftësi thelbësore të hershme matematikore dhe logjike. Arsyetimi shkallë-pasoje (p.sh., parashikimi nëse diçka do të bjerë), krahasimi i objekteve, matja në mënyrë joformale dhe përdorimi i gjuhës pozicionale janë procese thelbësore kognitive në zhvillimin e hershëm të STEM ¹ . Vëzhgimi dhe dokumentimi i këtyre momenteve vë në pah të menduarit shkencor dhe matematikor në zhvillim.
Kompetenca 5	Qytetaria globale	Edhe nëse trajtohet më pak në mënyrë të qartë në lojën logjike, kjo kompetencë është e pranishme nëpërmjet përdorimit të përbashkët të burimeve, lojës së barabartë dhe të mësuarit për të bashkëpunuar me respekt. Kur fëmijët krahasojnë, negociojnë dhe ndajnë materiale, ata angazhohen në praktika të drejta shoqërore dhe të qëndrueshme. Roli i edukatorit është jetik në sigurimin e pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse, sfidimin e stereotipeve (p.sh., djemtë dhe vajzat marrin pjesë në mënyrë të barabartë në ndërtim ose modelim) dhe nxitjen e respektit dhe kujdesit për materialet dhe bashkëmoshatarët.

6.4 Loja e lirë me materiale të riciklueshme

Për të rritur kuriozitetin e fëmijëve, për të zhvilluar logjikën e tyre dhe për të ndërtuar aftësitë e tyre, është thelbësore të krijohet një hapësirë (zakonisht në një stol) me materiale të riciklueshme. Rregullimi i këtyre materialeve, për ta bërë më të lehtë për fëmijët të gjejnë materialin e përshtatshëm për lojën e tyre, është gjithashtu thelbësor.

Kjo do t'i mundësojë atyre të përdorin materiale të ndryshme joformale për të luajtur me baraspeshën, ritmin, dimensionet, teksturën dhe komponentë të tjerë thelbësorë.

Vlera e materialeve të riciklueshme qëndron në thjeshtësinë dhe përmbajtjen e tyre të pasur. Kjo i lejon fëmijët të rilexojnë, të rizbulojnë dhe të rikuperojnë, duke u dhënë atyre kuptime të reja. Materiali i ricikluar përdoret si burim për ta eksploruar ngrohtësinë, ngjyrën, tingullin, strukturën e kështu me radhë.

Ja disa sugjerime praktike për edukatorët:

1. Vëzhgoni renditjen dhe klasifikimin

Vëzhgoni nëse fëmijët i grupojnë materialet sipastributeve të ndryshme (ngjyra, madhësia, lloji), duke treguar kështu aftësinë e tyre për të klasifikuar dhe njohur ngjashmëritë dhe ndryshimet.

2. Kërkoni prova të krijimit të modelit

Vini re nëse fëmijët i rregullojnë sendet në modele të përsëritura (siç janë ngjyrat ose format alternative), duke treguar një kuptim të hershëm të renditjes dhe njohjes së modeleve.

¹ STEM apo Science, Technology, Engineering, Mathematics (Shkencë, Teknologji, Inxhinieri, Matematikë) i referohet fushave teknike apo qasjes edukative që integron këto fusha për të zhvilluar mendimin kritik, zgjidhjen e problemeve, dhe kreativitetin.

3. Vëzhgoni veprimet e numërimit dhe përcaktimit sasior

Kushtojini vëmendje sjelljeve të numërimit, me zë të lartë ose në heshtje, gjersa fëmijët mbledhin ose rregullojnë materiale, dhe tregojnë kështu njohjen e numrave dhe korrespondencën një-me-një.

4. Vlerësoni ndërgjegjësimin hapësinor në ndërtimin e strukturës

Vëzhgoni se si fëmijët i rregullojnë ose i grumbullojnë materialet në hapësirë, gjë që mund të tregojë një kuptim të pozicionimit, baraspeshës dhe marrëdhënieve hapësinore.

5. Identifikoni qasjet për zgjidhjen e problemeve

Vëzhgoni momentet kur fëmijët përballen me sfida (si stabilizimi i sendeve) dhe mënyrën se si përshtaten ata, duke treguar fleksibilitet, qëndrueshmëri dhe të menduar logjik.

6. Vëzhgoni njohjen dhe përdorimin e formës

Shikoni nëse fëmijët identifikojnë ose preferojnë forma specifike kur krijojnë struktura, duke treguar mjeshtëri të gjeometrisë dhe ndërgjegjësim hapësinor.

7. Vini re matjet dhe gjuhën krahasuese

Vini re nëse fëmijët përdorin terma si “i madh”, “i vogël”, “më i gjatë”, “më i shkurtër” gjatë lojës, duke treguar kështu njohuri rreth matjes dhe krahasimit.

8. Vëzhgoni eksperimentet shkak-pasojë

Vëzhgoni nëse fëmijët angazhohen në arsyetim shkak-pasojë, siç është testimi i stabilitetit ose baraspeshës, gjë që pasqyron parashikimin dhe përshtatjen logjike.

9. Kërkoni prova të planifikimit dhe aktiviteteve të qëllimshme të projektimit

Shikoni nëse fëmijët fillojnë duke pasur në mendje një qëllim ose strukturë specifike, duke mbledhur dhe rregulluar materialet me një plan, duke treguar largpamësi dhe të menduar strategjik.

10. Vëzhgoni lojën bashkëpunuese dhe ndarjen e materialeve/burimeve

Shikon ndërveprimet ku fëmijët ndajnë ose shkëmbejnë materiale bashkëmoshatarët, duke treguar një kuptim të shpërndarjes së sasisë, ndarjes dhe ndërgjegjësim social.

11. Inkurajoni shpjegimet përshkruese dhe reflektimin

Inkurajoni fëmijët t'i shpjegojnë krijimet e tyre, të cilat mund të zbulojnë procesin e tyre të të menduarit, zgjedhjet dhe kuptimin e strukturës, funksionit dhe logjikës në planet e tyre.



Kompetencat e mbuluara

Kompetenca 1	Kreativiteti dhe të menduarit kritik	Loja e lirë me materiale të riciklueshme është një kontekst i fuqishëm për fëmijët që të shpikin, kombinojnë dhe transformojnë objekte të përditshme në mënyrë kreative. Ata imagjinojnë përdorime të reja për materiale të thjeshta, duke treguar fleksibilitet dhe mendim jokonvencional. Kur ndërtojnë struktura, zgjidhin probleme baraspeshe ose stabiliteti ose eksperimentojnë me shkak-pasojën, ata angazhohen në zgjidhjen e thellë të problemeve. Përmes reflektimit dhe shpjegimeve të krijimeve të tyre, fëmijët fillojnë të artikulojnë të menduarit e tyre, duke ndërtuar aftësi të hershme metakognitive.
Kompetenca 2	Komunikimi përmes gjuhëve verbale dhe joverbale	Gjersa fëmijët bashkëveprojnë rreth një hapësire të përbashkët materiale, ata negociojnë, shkëmbejnë ide dhe shprehin preferencat – duke përdorur komunikim verbal dhe joverbal. Shpjegimi pse zgjedhën materiale të caktuara ose përshkrimi i krijimit të tyre përfundimtar ushqen gjuhën shprehëse. Edukatorët që i inkurajojnë fëmijët ta përshkruajnë procesin e tyre ndihmojnë në forcimin e fjalorit dhe strategjive të tyre të komunikimit. Fëmijët gjithashtu përdorin gjuhën e trupit dhe gjestet për t'i koordinuar përpjekjet, duke përforcuar aftësitë bashkëpunuese.
Kompetenca 3	Kompetenca socio-emocionale Përveç kësaj, të menduarit kritik (Kompetenca 1).	Kjo lloj loje i nxitë fëmijët të marrin iniciativë në përzgjedhjen e materialeve dhe në vendosjen e një qëllimi. Ndërsa përpiqen t'i zbatojnë idetë e tyre – shpesh duke u përballur me sfida – ata praktikojnë këmbënguljen dhe zhvillojnë qëndrueshmëri. Gjersai testojnë kufijtë strukturorë (p.sh., grumbullimi lart ose balancimi i formave të pabarabarta) ndërmarrin edhe rreziqe, dhe kështu mësohen t'i vlerësojnë rreziqet fizike dhe emocionale në një mënyrë të sigurt. Aftësia e tyre për të reflektuar mbi atë që funksionoi ose nuk funksionoi mbështet vetërregullimin dhe rritjen metakognitive.
Kompetenca 4	Shkencë, teknologji dhe logjikë	Loja me materiale të riciklueshme është rrënjësisht e lidhur me këtë kompetencë. Fëmijët angazhohen në renditjen, klasifikimin, krijimin e modeleve, vlerësimin e sasive dhe eksplorimin e gjeometrisë dhe matjes. Ata përdorin arsyetimin hapësinor për të ndërtuar struktura dhe për të zgjidhur problemet e baraspeshës. Eksplorimi i shkakut dhe pasojës dhe planifikimi joformal shfaq të menduarit e hershëm shkencor e metodik. Eksperimentet e tyre të përsëritura dhe dizajnet strukturore pasqyrojnë aftësitë e hershme në inxhinieri dhe të nxëniet e ndërlidhur me STEM në mënyrë të gjallë dhe intuitive.
Kompetenca 5	Qytetaria globale	Përdorimi i materialeve të ricikluara u mëson fëmijëve qëndrueshmërinë dhe ripërdorimin, duke inkurajuar ndërgjegjësimin mjedisor që në moshë të vogël. Ata mësojnë se vlerë mund të gjejmë edhe në atë që të tjerët e konsiderojnë mbeturinë, duke nxitur një mendësi kujdesi dhe përgjegjësie. Përdorimi i përbashkët i burimeve të kufizuara mbështet drejtësinë dhe pjesëmarrjen gjithëpërfshirëse. Edukatorët mund ta udhëheqin lojën në një mënyrë që sfidon stereotipet gjinore (p.sh., të gjithë fëmijët të angazhohen në ndërtim ose dizajn estetik), duke promovuar barazinë dhe vlerat e qytetarisë globale.



6.5 Reflektim mbi situatat për të cilat nevojitet të menduarit kritik

Është jashtëzakonisht e rëndësishme të krijohen situata në të cilat fëmijët duhet të jenë në gjendje t'i identifikojnë problemet dhe të përpiqen t'i zgjidhin ato, ose të paktën t'i analizojnë ato. Paraqitja e problemeve gjatë lojës do të thotë që edukatorët mund të shtrojnë pyetje "si të ...?", të cilat u lejojnë fëmijëve të identifikojnë në mënyrë të pavarur zgjidhjet. Shembull: Si mund ta masim rrushin? Fëmijët duhet të shpikin ose të gjejnë zgjidhje për ta matur (dhe ndoshta edhe të krijojnë një sistem matës).

Ja disa sugjerime praktike për krijimin e kësaj lloj përvoje:

1. Shtroni pyetje të hapura


- › Inkurajoni fëmijët të mendojnë përtej përgjigjeve të thjeshta po/jo duke u bërë pyetje të tilla si: "Pse mendoni se ndodhë kjo?" ose "Çfarë do të ndodhte nëse...?"
- › Përdorni sugjerime që sfidojnë supozimet e tyre, të tilla si "A mund të mendoni për ndonjë mënyrë tjetër për ta bërë këtë?" për të inkurajuar të menduarit kritik.

2. Inkurajoni vëzhgimin dhe reflektimin

- › Nxitini fëmijët të vëzhgojnë detajet në mjedisin e tyre (p.sh., "Çfarë mendoni për retë kur i shikoni?") dhe reflektoni mbi vëzhgimet e tyre.
- › Bëni pyetje përcjellëse si "Si ndryshon kjo nga dje?" për t'i ndihmuar të mendojnë për ndryshimet me kalimin e kohës.

3. Përdorni problemet e përditshme si mundësi për të mësuar

- › Shndërroni sfidat e përditshme në aktivitete për zgjidhjen e problemeve (p.sh., "Çfarë mund të bëjmë për ta bërë bartjen... më të lehtë?"), duke i inkurajuar ata të mendojnë për zgjidhje.
- › Lejojini fëmijët të propozojnë dhe të testojnë idetë e tyre, duke nxitur të menduarit kritik dhe zgjidhjen praktike të problemeve.



4. Prezantoni skenarët “Po sikur”

- › Përdorni skenarë hipotetikë për t’i ndihmuar fëmijët të mendojnë në mënyrë kreative (p.sh., “Po sikur të mos kishim dritë?”).
- › Diskutoni mundësi të ndryshme dhe pasojat e tyre, duke i inkurajuar fëmijët të eksplorojnë marrëdhëniet shkak-pasojë.

5. Analizoni dhe krahasoni objekte ose situata të përditshme

- › Kërkojuni fëmijëve të përshkruajnë se si dy objekte ose situata janë të ngjashme ose të ndryshme (p.sh., “Si ndryshon luga nga piruni?”).
- › Kjo i ndihmon të zhvillojnë aftësi analitike dhe t’i kuptojnë vetitë dhe funksionet e sendeve të ndryshme.

6. Inkurajoni parashikimet dhe hipotezat

- › Përpara se të kryeni ndonjë aktivitet, pyetini fëmijët se çfarë mendojnë se do të ndodhë (p.sh., “Çfarë mendoni se do të ndodhë nëse e vendosim këtë në ujë?”).
- › Diskutoni parashikimet e tyre dhe rishikojini ato pas aktivitetit për të reflektuar mbi rezultatin dhe për ta përmirësuar të menduarit e tyre.

7. Përdorni rrëfimin e historive për të paraqitur problemet

- › Krijoni histori ose skenarë të thjeshtë ku një personazh përballet me një problem (p.sh., “Lepuri nuk mund ta arrijë mollën. Çfarë duhet të bëjë?”).
- › Kërkojuni fëmijëve të sugjerojnë zgjidhje, duke i inkurajuar të zbatojnë aftësitë e tyre të zgjidhjes së problemeve dhe të kreativitetit.

8. Eksploroni të kundërtat dhe kontradiktat

- › Paraqitini fëmijëve ide ose rezultate të kundërta (p.sh., “Çfarë do të ndodhte nëse do të ishte gjithmonë ditë?” kundërt “Çfarë do të ndodhte nëse do të ishte gjithmonë natë?”).
- › Diskutoni përparësitë dhe dobësitë e secilit skenar, duke i ndihmuar fëmijët të kuptojnë se situata të ndryshme mund të kenë perspektiva të shumëfishta.

Kompetencat e mbuluara

Kompetenca 1	Kreativiteti dhe të menduarit kritik	Ky aktivitet synon drejtpërdrejt zhvillimin e kësaj kompetence. Fëmijët inkurajohen të identifikojnë një problem të botës reale (p.sh., si të matet një rrush), të mendojnë për zgjidhje të mundshme dhe të testojnë idetë e tyre. Pyetjet e hapura, hipotezat dhe analizat stimulojnë të menduarit kritik dhe kreativ. Gjersa reflektojnë mbi atë që funksionoi ose nuk funksionoi, ata zhvillojnë aftësi metakognitive, duke fituar vetëdije për proceset e tyre të të menduarit dhe strategjitë e të nxënës.
Kompetenca 2	Komunikimi përmes gjuhëve verbale dhe joverbale	Zgjidhja e problemeve në grupe të vogla ose në çifte i inkurajon fëmijët të flasin, të ndajnë ide dhe të negociojnë zgjidhje. Ata shpjegojnë arsyetimin e tyre, i bëjnë pyetje njëri-tjetrit dhe madje mund të vizatojnë ose modelojnë zgjidhjet e tyre duke përdorur gjeste, diagrame ose materiale. Këto ndërveprime forcojnë si shprehjen verbale ashtu edhe komunikimin joverbal, duke i ndihmuar fëmijët të shprehin ide komplekse në mënyrë bashkëpunuese.
Kompetenca 3	Kompetenca socio-emocionale Përveç kësaj, të menduarit kritik (Kompetenca 1).	Kur përballen me një sfidë si matja e një kokrrë rrushi, fëmijët marrin iniciativën për ta eksploruar dhe zgjidhur atë, duke treguar kuriozitet dhe vendosmëri. Ata mund të dështojnë ose të marrin rezultate të papritura, por të mësuarit për të menaxhuar frustrimin, për të këmbëngulur dhe për të provuar përsëri forcon qëndrueshmërinë e tyre. Hamendësimi dhe testimi i ideve gjithashtu zhvillon një qëndrim të shëndetshëm ndaj rrezikut dhe pasigurisë. Me mbështetje, ata rriten në vetëbesim dhe vetëdije.
Kompetenca 4	Shkencë, teknologji dhe logjikë	Ky aktivitet është një pikënisje perfekte për të nxënësit e hershëm të STEM. Fëmijët zbatojnë logjikën gjersa shqyrtojnë formën, madhësinë dhe strategjitë e matjes. Ata mund të shpikin njësi joformale (p.sh., “është 3 kopsa i gjatë”) ose të përdorin mjete si një vizore, duke zhvilluar një ndjenjë intuitive të matjes, sasisë dhe krahasimit. Ata formojnë hipoteza, testojnë rezultatet dhe rishikojnë qasjet e tyre – duke pasqyruar metodën shkencore në mënyra të përshtatshme për moshën.
Kompetenca 5	Qytetaria globale	Edhe pse nuk është fokusi i detyrës, kjo kompetencë mbështetet kur fëmijët punojnë së bashku me respekt, ndajnë burimet dhe marrin pjesë në mënyrë të barabartë në zgjidhjen e problemeve. Edukatorët mund të sigurohen që të dëgjohen të gjitha mendimet dhe të sfidojnë stereotipet se kush është “i mirë” në matematikë ose shkencë. Nëse materialet e ricikluara ose lokale përdoren në aktivitetet e matjes, koncepti i qëndrueshmërisë mund të zhvillohet natyrshëm.

6.6 Kontekstualizimi i koncepteve shkencore

Fëmijëve është e nevojshme t’u ofrohen shembuj konkretë (objekte, libra dhe materiale të tjera) për t’u lejuar atyre që ta eksplorojnë çdo temë. Në të njëjtën kohë, është thelbësore të komunikohen proceset e ndryshme të fëmijëve, si individualisht ashtu edhe në grupe.

Prandaj, nëse vendosni, për shembull, të punoni mbi një temë specifike, filloni duke sjellë libra, objekte ose materiale të tjera që mund të rrisin kuriozitetin e fëmijëve. Në foto, hapësira është e përgatitur për të punuar mbi konceptin e shkëmbinjve dhe mineraleve.

Për të mbështetur këto lloj aktivitete, ne sugjerojmë si në vijim:

1. Vëzhgoni ndërlidhjet me përvoja të përditshme

- › Kërkoni shenja që fëmijët po i lidhin konceptet shkencore me jetën e tyre të përditshme (p.sh., “Kjo është si kur bie shi”), duke treguar aftësinë e tyre për të lidhur aktivitetet e lojës me fenomenet e botës reale.
- › Inkurajoni fëmijët të flasin për situata të ngjashme me të cilat janë përballur, duke e lidhur konceptin me përvoja të njohura.

2. Kushtojini vëmendje përdorimit të fjalorit të përshtatshëm

- › Kushtojini vëmendje nëse fëmijët po i përdorin saktë termet shkencorë (p.sh., “shtangem”, “rritem”, “notoj”), duke demonstruar kuptimin e tyre të koncepteve.
- › Përforconi përdorimin e saktë të terminologjisë duke dhënë shembull për gjuhën shkencore në kontekst.

3. Kërkoni shembuj të arsytimit shkak-pasojë në kontekst

- › Vëzhgoni nëse fëmijët e shpjegojnë shkakun e një ngjarjeje bazuar në njohuritë e mëparshme (p.sh., “Akulli shkrihet sepse është ngrohtë”), duke treguar aftësinë e tyre për të zbatuar konceptet shkencore për të shpjeguar rezultatet.
- › Inkurajojini të zgjerojnë arsytimin e tyre duke bërë pyetje plotësuese.

4. Vëzhgoni zgjidhjen e problemeve në kontekste të jetës reale

- › Kushtojini vëmendje kur fëmijët përdorin të kuptuarit e tyre të parimeve shkencore për të zgjidhur problemet e përditshme (p.sh., kur përdorin objekte të rënda për të fundosur diçka që noton).
- › Udhëzojini të mendojnë për zgjidhjet duke i pyetur se çfarë tjetër dinë rreth konceptit.



5. Identifikoni shembuj të zbatimit të konceptit në lojë

- › Vëzhgoni situata ku fëmijët zbatojnë natyrshëm ide shkencore gjatë lojës (p.sh., përdorimi i pjerrtësive për t'i bërë makinat të ecin më shpejt), duke demonstruar kuptimin e tyre kontekstual të forcave dhe lëvizjes.
- › Mësoni dhe diskutoni këto momente për të përforcuar lidhjen midis lojës dhe parimeve shkencore.

6. Kushtojini vëmendje komenteve reflektuese rreth vëzhgimeve

- › Vini re nëse fëmijët reflektojnë mbi arsyen pse ndodhin gjërat (p.sh., “Gjethet bien sepse fryn era”), duke treguar aftësinë e tyre për të kontekstualizuar vëzhgimet brenda kornizave shkencore.
- › Kërkojuni që t'i shpjegojnë mendimet e tyre për të thelluar reflektimin dhe kuptimin.

7. Inkurajoni eksplorimin e fenomeneve natyrore

- › Jepni mundësi për të eksploruar natyrën (p.sh., duke vëzhguar vetitë e ujit, tokës ose bimëve) dhe shikoni se si fëmijët i lidhin përvojat e tyre me idetë shkencore.
- › Inkurajojini të mendojnë për atë që vënë re, duke përforcuar aftësitë e tyre vëzhguese dhe duke i lidhur përvojat e tyre me konceptet shkencore.

8. Vëzhgoni përdorimin e krahasimit dhe klasifikimit

- › Vëzhgoni fëmijët teksa i kategorizojnë sendet bazuar në vetitë e tyre (p.sh., klasifikimin e materialeve nëse janë magnetike apo jo), duke demonstruar një kuptim të klasifikimit dhe kategorizimit bazuar në tipare shkencore.
- › Diskutoni kriteret që përdoren për klasifikim për të mbështetur një kuptim më të thellë konceptual.

9. Kërkoni shembuj të arsytimit parashikues bazuar në njohuritë paraprake

- › Vëzhgoni nëse fëmijët bëjnë parashikime bazuar në atë që dinë (p.sh., parashikimi se një objekt do të fundoset sepse është i rëndë), duke treguar se po e zbatojnë kuptimin e tyre të vetive shkencore.
- › Mbështetni arsytimin e tyre parashikues duke diskutuar pse mendojnë se do të ndodhë një rezultat i caktuar.

10. Angazhohuni në diskutime të menjëhershme rreth shkakut, pasojës dhe ndryshimit të vazhdueshëm

11. Angazhoni fëmijët në biseda rreth asaj se si dhe pse ndryshojnë gjërat me kalimin e kohës (p.sh., stinët, rritja e bimëve), duke e kontekstualizuar të nxënit e tyre në proceset natyrore dhe ndryshimet shkencore.

- › Përdorni mjete vizuale ose afate kohore për t'i ndihmuar që të shohin dhe të kuptojnë ndryshimin brenda kontekstit.

Kompetenat e mbuluara

Kompetenca 1	Kreativiteti dhe të menduarit kritik	Përmes përvojës së eksplorimit të koncepteve shkencore me materiale reale dhe vëzhgimit të udhëhequr, fëmijët zgjerojnë kapacitetin e tyre për të menduar kritik dhe kreativitet. Ata mësojnë jo vetëm të pyesin veten rreth fenomeneve që hasin, por edhe të kërkojnë shpjegime, të bëjnë lidhje dhe të propozojnë hipoteza. Kur u kërkohet të reflektojnë mbi faktin pse bien gjethet ose pse shkëmbinjtë janë të ndryshëm nga njëri-tjetri, ata zhvillojnë aftësi arsyetimi të bazuara në vëzhgim dhe njohuri paraprake. Zgjidhja e problemeve bëhet një proces organik, ndërsa fëmijët zbatojnë atë që dinë rreth parimeve shkencore në situata të reja, duke krijuar zgjidhje të menduara mirë, shpesh imagjinative. Ndërsa inkurajohen të reflektojnë mbi vëzhgimet e tyre dhe të shpjegojnë proceset e tyre të të menduarit, ata zhvillojnë vetëdije metakognitive, duke fituar njohuri se si mësojnë, pyesin dhe arsyetojnë.
Kompetenca 2	Komunikimi përmes gjuhëve verbale dhe joverbale	Në kontekstin e hetimit të fenomeneve shkencore, fëmijët i përsosin aftësitë e tyre të komunikimit si individualisht ashtu edhe në grupe. Ata mësojnë t'i shprehin qartë idetë e tyre, ta përdorin fjalorin e duhur shkencor dhe të dëgjojnë në mënyrë aktive interpretimet dhe shpjegimet e të tjerëve. Diskutimet në grup nxisin bashkëpunimin ndërsa fëmijët krahasojnë vëzhgimet e tyre, negociojnë kuptimet dhe ndërtojnë kolektivisht një kuptim më të thellë të koncepteve të eksploruara. Hapësira për shprehje nuk kufizohet vetëm te fjalët; përmes vizatimeve, demonstrimeve fizike dhe madje edhe lojërave eksperimentale, fëmijët gjejnë mënyra joverbale për të përcjellë ide shkencore. Këto forma të larmishme komunikimi i ndihmojnë ata të ndërtojnë një gjuhë të përbashkët eksplorimi.
Kompetenca 3	Kompetenca socio-emocionale Përveç kësaj, të menduarit kritik (Kompetenca 1).	Projekti ofron një kontekst për zhvillimin e aftësive socio-emocionale, ndërsa fëmijët angazhohen në eksplorim shkencor që kërkon durim, bashkëpunim dhe respekt për perspektiva të ndryshme. Duke punuar përmes eksperimenteve dhe vëzhgimeve, ata bëhen më të vetëdijshëm për përgjigjet e tyre emocionale - emocionin e zbulimit, zhgënjimin e rezultateve të papritura - dhe mësojnë t'i menaxhojnë këto ndjenja në mënyrë konstruktive. Iniciativa kultivohet ndërsa fëmijët inkurajohen të ndjekin kuriozitetet e tyre, të bëjnë pyetje dhe të testojnë ide pa frikën se do të gabojnë. Këmbëngulja rritet natyrshëm përmes vëzhgimeve të përsëritura dhe procesit të ngadaltë të vërejtjes së modeleve dhe ndryshimeve me kalimin e kohës. Menaxhimi i riskut shfaqet gjersa fëmijët mësojnë t'i trajtojnë materialet me kujdes, të njohin rëndësinë e sigurisë kur eksplorojnë fenomenet natyrore dhe të mendojnë me kujdes kur nxjerrin përfundime.

Kompetenca 4	Shkencë, teknologji dhe logjikë	Ky projekt i forcon thellësisht aftësitë logjike, matematikore dhe shkencore të fëmijëve. Ndërsa vëzhgojnë, klasifikojnë, krahasojnë dhe parashikojnë, ata zhyten në proceset themelore të të menduarit shkencor. Ata mësojnë ta zbatojnë arsyetimin shkallë-pasojë, të masin dhe t'i ndjekin ndryshimet dhe kategorizojnë objektet bazuar në veti të tilla si pesha, tekstura ose forca magnetike. Duke përdorur mjete si syze zmadhuese, vizore ose tabela vizuale, ata gjithashtu familjarizohen me instrumente të thjeshta shkencore dhe teknologjike, duke lidhur konceptet abstrakte me përvoja konkrete. Ky themel në praktikat shkencore të botës reale hedh themelet për të mësuarit shkencor më formal në të ardhmen.
Kompetenca 5	Qytetaria globale	Edhe në një eksplorim shkencor që përqendrohet në materiale si shkëmbinj, mineralet dhe fenomenet natyrore, zhvillohen fushat e qëndrueshmërisë dhe ndërgjegjësimit global. Duke inkurajuar vëzhgimin dhe respektin për botën natyrore, fëmijët fillojnë ta shohin veten si pjesë të një ekosistemi më të madh, përgjegjës për ta kuptuar dhe mbrojtur atë. Natyra gjithëpërfshirëse e aktiviteteve siguron që të gjithë fëmijët, pavarësisht nga gjinia, të kenë mundësi të barabarta për të eksploruar, pyetur dhe kontribuar, duke ndihmuar në ndërtimin e një kulture barazie dhe kurioziteti të përbashkët. Për më tepër, duke lidhur fenomenet e përditshme me parime më të gjera shkencore, fëmijët fillojnë të vlerësojnë se shkencë nuk është e panjohur ose abstrakte, por e endur në strukturën e jetës së përditshme në të gjitha kulturat dhe komunitetet.

6.7 Kopsht me perime

Është e rëndësishme të reflektohet me fëmijët mbi kuptimin e përvojave të tilla si planifikimi dhe kujdesi për një kopsht me perime, i cili dikur ishte një mënyrë jetese për shumë familje. Fëmijët e sotëm shpesh duhet të mësojnë vlerën e një hapësire toke ku mund të rriten perimet për ushqim. Kjo është mundësi për t'u përqendruar në kuptimin e vlerave dhe krijimin e ndjeshmërisë tek fëmijët ndaj qëndrueshmërisë, respektit dhe vëmendjes ndaj natyrës.

Planifikimi i përbashkët përfshin pjesëmarrjen e fëmijëve dhe ndjenjën e të qenit pjesë e një projekti të përbashkët.

Fëmijët mund të dalin me teoritë e tyre rreth të kuptuarit të formave, ndërkohë që zgjerojnë njohuritë e tyre duke i krahasuar me njëra-tjetrën.

Krijimi i një hapësire të përbashkët në parkun ose kopshtin e institucionit të edukimit në fëmijërinë e hershme do t'u mundësojë fëmijëve të kenë vëmendje të përditshme dhe kështu të kuptojnë konceptet që lidhen me jetën dhe natyrën.

Ja disa sugjerime për të krijuar përvoja në një kopsht me perime:

1. Përfshijini fëmijët në procesin e planifikimit

- › Lejoni fëmijët të vendosin llojin e perimeve që do të mbjellin duke u treguar fotografi të perimeve të ndryshme dhe duke diskutuar se cilat prej tyre u pëlqejnë ose u duken interesante.
- › Flisni për kushtet që i duhen secilës bimë (p.sh., rrezet e diellit, uji) për t'i prezantuar konceptet bazë të kopshtarisë dhe për t'i ndihmuar që ta kuptojnë procesin e planifikimit.

2. Përgatitni kopshtin së bashku

- › Përfshijini fëmijët në përgatitjen e tokës, germimin dhe krijimin e rreshtave të mbjelljes. Shpjegoni pse këta hapa janë të nevojshëm për rritjen e bimëve.

- › Diskutoni mjetet e përdorura (p.sh., mistria, kova ujitëse) dhe funksionet e tyre që fëmijët t'i mësojnë pajisjet e kopshtit.
- 3. Mbillni farat dhe fidanët sipas udhëzimeve (me fotografi)**
- › Tregojuni fëmijëve si të mbjellin fara ose fidanë në thellësinë dhe hapësirën e duhur, duke shpjeguar pse këta faktorë janë të rëndësishëm për rritje.
 - › Inkurajoni fëmijët të mbjellin në rreshta, duke nxitur punën në grup dhe të nxënit praktik.
- 4. Inkurajoni kujdesin e rregullt**
- › Caktoni një orar ujitjeje dhe lërin fëmijët t'i ujin bimët me radhë, duke shpjeguar se si uji i ndihmon bimët të rriten.
 - › Flisni për nevojat e tjera të kujdesit, siç është heqja e barërave të këqija, dhe lejojini fëmijët të ndihmojnë që kopshti të mbahet i shëndetshëm.
- 5. Përdorni ditarët e vëzhgimit për të ndjekur/identifikuar ndryshimet**
- › Jepuni fëmijëve ditarë ose tabela të thjeshta për t'i regjistruar vëzhgimet e tyre në kopsht, të tilla si vizatime të rritjes së bimëve, shënime me simbole rreth kushteve të motit ose shfaqjes së gjethëve ose luleve të reja.
 - › Kërkojuni të shënojnë ndryshimet që vëzhgojnë çdo javë, duke inkurajuar aftësitë e tyre vëzhguese dhe vëmendjen ndaj detajeve.
- 6. Prezantoni konceptin e kohës me fazat e rritjes**
- › Diskutoni se si ndryshojnë bimët me kalimin e kohës duke prezantuar terma të tillë si “farë”, “fidan”, “filiz” dhe “bimë e pjekur”.
 - › Përdorni kalendar për të ndjekur/identifikuar se sa kohë duhet që farat të mbijnë ose që perimet të shfaqen, duke i ndihmuar fëmijët të kuptojnë kohën dhe rritjen.
- 7. Inkurajoni parashikimet rreth rritjes së bimëve**
- › Para mbjelljes, kërkojuni fëmijëve të parashikojnë se cilat fara do të mbijnë të parat ose cilat bimë do të rriten më shumë.
 - › Rishikojini periodikisht këto parashikime për t'i krahasuar ato me rezultatet aktuale, duke i mësuar ata rreth hipotezave dhe rezultateve.
- 8. Eksploroni rolin e dritës së diellit dhe hijes**
- › Tregojuni fëmijëve se si bimë të ndryshme kanë nevojë për sasi të ndryshme të dritës së diellit dhe vëzhgoni se si bimët rriten në vende me më shumë diell krahasuar me ato në zona me hije.
 - › Diskutoni pse rrezet e diellit janë të rëndësishme dhe inkurajojini fëmijët të vënë re se cilat zona të kopshtit kanë më shumë dritë.
- 9. Vëzhgoni dhe diskutoni insektet dhe kafshët e tjera të egra**
- › Inkurajoni fëmijët të kërkojnë insekte ose krijesa në kopsht dhe të diskutojnë se si këto qenie bashkëveprojnë me bimët (p.sh., bletët që polenizojnë lulet, krimbat në tokë).
 - › Mësojuni fëmijëve rreth roleve që luajnë krijesa të ndryshme në ekosistemin e kopshtit.
- 10. Prezantoni konceptet e matjes me rritjen e bimëve**
- › Përdorni vizore ose shirita matëse për të ndjekur rritjen e bimëve me kalimin e kohës, duke u mësuar fëmijëve të matin lartësinë dhe t'i numërojnë gjethet.
 - › Regjistroni matjet në një tabelë rritjeje për të paraqitur vizualisht ndryshimet, duke i ndihmuar fëmijët të kuptojnë rritjen në terma të matshëm.

11. Diskutoni ndryshimet e motit dhe ndikimin e tyre

- › Flisni rreth asaj se si kushtet e motit (shiu, nxehtësia, të ftohtit) ndikojnë në kopsht dhe inkurajoni fëmijët të vëzhgojnë se si bimët reagojnë ndaj këtyre ndryshimeve.
- › Përdorni aktivitete të thjeshta për përcjelljen e motit (p.sh., shënimi i ditëve me diell ose me shi) për t'i ndihmuar fëmijët të bëjnë lidhje midis motit dhe shëndetit të bimëve.

12. Mblidhni perimet së bashku dhe flisni për rezultatet

- › Përfshijini fëmijët në mbledhjen e perimeve kur të jenë gati, duke diskutuar se si bimët kanë ndryshuar nga fara në perime të pjekura.
- › Nxiti shijimin ose gatimin me perimet e korrura për të demonstruar ciklin e plotë nga mbjellja deri te ngrënia, duke përfunduar konceptin e prodhimit të ushqimit.

13. Reflektoni mbi përvojën e kopshtarisë

- › Pas disa muajsh, diskutoni me fëmijët se çfarë mësuara nga kopshti dhe çfarë vuna re rreth ndryshimeve.
- › Pyetini se çfarë do të bënin ndryshe herën tjetër ose cilat bimë të tjera do të donin t'i provonin, duke nxitur një mendësi reflektive dhe adaptive.

Kompetencat e mbuluara

Kompetenca 1

Kreativiteti dhe të menduarit kritik

Përmes projektit të kopshtit me perime, fëmijët zhvillojnë një mënyrë fleksibile dhe kreative të të menduarit. Ata mësojnë se idetë e tyre – qoftë në zgjedhjen e bimëve apo në hartimin e planimetrisë së kopshtit – mund të çojnë në rezultate reale dhe kuptimplota. Planifikimi dhe vëzhgimi i kopshtit i nxitë të bëjnë parashikime, të krahasojnë rezultatet dhe të përshtasin veprimet e tyre në përputhje me rrethanat, duke thelluar kapacitetin e tyre për të menduar kritik dhe reflektues. Me kalimin e kohës, ata ndërtojnë besim në aftësinë e tyre për të eksploruar problemet, për të kërkuar zgjidhje në mënyrë kreative dhe për të menduar për proceset e tyre të të menduarit. Ata e kuptojnë se gabimet ose rezultatet e papritura nuk janë dështime, por mundësi për të mësuar dhe për t'u përshtatur.

Kompetenca 2

Komunikimi përmes gjuhëve verbale dhe joverbale

Puna e përbashkët e krijimit dhe mirëmbajtjes së një kopshti i ndihmon fëmijët ta përjetojnë drejtpërdrejt rëndësinë e bashkëpunimit. Ata mësojnë se dëgjimi i të tjerëve, ndarja e përgjegjësi dhe puna drejt qëllimeve të përbashkëta mund të çojnë në rezultate të suksesshme dhe të kënaqshme. Në diskutimet në grup, fëmijët forcojnë aftësinë e tyre për t'u shprehur verbalisht, për të negociuar ide dhe për të kuptuar pikëpamjet e të tjerëve. Ndërkohë, duke vizatuar fazat e rritjes, duke krijuar grafikë vëzhgimi dhe duke përdorur gjeste gjatë punës, ata zbulojnë se komunikimi mund të marrë shumë forma, secila e rëndësishme për ndarjen e përvojave dhe për të kuptuar botën përreth tyre.

Kompetenca 3	Kompetenca socio-emocionale Përveç kësaj, të menduarit kritik (Kompetenca 1).	Gjersa kujdesen për kopshtin me kalimin e kohës, fëmijët ndërtojnë aftësi socio-emocionale duke mësuar të punojnë me durim, të menaxhojnë zhgënjimet e vogla dhe të festojnë sukseset së bashku. Ata rriten në vetëdije, duke njohur emocionet e tyre të krenarisë, frustrimit dhe kënaqësisë si pjesë natyrale të të mësuarit dhe arritjes së qëllimeve. Nevoja për vëmendje të përditshme ndaj bimëve ushqen iniciativën dhe këmbënguljen, duke u treguar fëmijëve se përkushtimi dhe kujdesi i vazhdueshëm janë thelbësorë për rritjen – jo vetëm në kopsht, por në çdo përpjekje afatgjatë. Duke përdorur mjetet në mënyrë të sigurt dhe duke vëzhguar mjedisin jetësor me kujdes, ata gjithashtu fillojnë të zhvillojnë një ndjenjë të hershme të menaxhimit të rrezikut dhe përgjegjësisë.
Kompetenca 4	Shkencë, teknologji dhe logjikë	Duke vëzhguar rritjen e bimëve, duke matur lartësitë, duke numëruar gjethet dhe duke ndjekur ditët, fëmijët fitojnë aftësi praktike të të menduarit matematik dhe logjik, duke lidhur konceptet abstrakte me përvoja të prekshme të botës reale. Përdorimi i mjeteve të thjeshta si mistritë, kovat e ujitjes dhe shiritat matës prezanton njohuritë themelore teknologjike, duke u dhënë fëmijëve një kuptim praktik se si mjetet ndihmojnë aktivitetin njerëzor. Gjersa bëjnë parashikime rreth zhvillimit të bimëve, testojnë idetë e tyre dhe vëzhgojnë marrëdhëniet shkak-pasojë në natyrë, fëmijët hyjnë në fazat e para të arsytimit shkencor, duke mësuar që ta shohin botën përmes një këndvështrimi hulumtimi, provash dhe eksplorimi.
Kompetenca 5	Qytetaria globale	Duke marrë pjesë në ciklin jetësor të mbjelljes, kujdesit dhe korrjes së perimeve, fëmijët zhvillojnë një respekt të thellë për botën natyrore dhe fillojnë t'i kuptojnë parimet e qëndrueshmërisë. Ata arrijnë të kuptojnë se prodhimi i ushqimit është një proces që kërkon përpjekje, kujdes dhe ekuilibër me mjedisin, dhe përjetojnë kënaqësinë e kujdesit për gjallesat. Përmes bisedave rreth varësisë së brezave të kaluar nga kopshtet dhe sfidave të sotme, fëmijët ndërtojnë një ndjenjë të hershme të qytetarisë globale, duke mësuar vlerën e burimeve natyrore dhe përpjekjet e komunitetit në kultura dhe kohë të ndryshme. Qasja gjithëpërfshirëse ndaj pjesëmarrjes – ku çdo fëmijë, pavarësisht nga gjinia, ka një rol aktiv dhe të vlerësuar – nxit një themel barazie dhe respekti për diversitetin.

6.8 Bisedat në grupe të vogla dhe pyetjet e hapura

Diskutimet në grupe të vogla janë një pjesë thelbësore e të nxënit në edukimin e hershëm, sepse nxësin zhvillimin e gjuhës, si dhe të aftësive kritike sociale dhe emocionale. Fëmijët ndihen të inkurajuar t'i shprehin mendimet e tyre, të dëgjojnë në mënyrë aktive dhe të krijojnë lidhje me bashkëmoshatarët e tyre në këto mjedise intime. Diskutimet në grupe të vogla u lejojnë fëmijëve të vegjël të eksplorojnë dhe shprehin lirisht ide, duke stimuluar kuriozitetin dhe besimin në ndarjen e perspektivave të tyre. Këto ndërveprime gjithashtu zhvillojnë empatinë, ndërsa fëmijët mësojnë të vlerësojnë pikëpamjet dhe përvojat e ndryshme. Diskutime të tilla mbështesin pasurimin e fjalorit, të kuptuarit dhe themelet e dialogut të respektueshëm. Ky kapitull ofron strategji për krijimin e bisedave të strukturuar, por fleksibile, në grup, duke siguruar që çdo fëmijë të ndihet i vlerësuar dhe i dëgjuar. Duke i udhëhequr fëmijët përmes këtyre diskutimeve, edukatorët hedhin themelet për të nxënit bashkëpunues dhe lidhjet shoqërore që do t'u sjellin dobi atyre për vitet që vijnë.

Fëmijët duhet të mësojnë si të diskutojnë në grupe të vogla dhe të eksplorojnë interesat e tyre të ndërsjella në një mjedis që stimulon respektin për diversitetin dhe mendimet e ndryshme. Edukatorët duhet të ndërhyjnë sa më pak të jetë e mundur dhe t'u lejojnë fëmijëve të flasin. Roli i edukatorit është të bëjë pyetje të hapura dhe sqaruese që synojnë të mbështesin bisedën midis fëmijëve dhe të vëzhgojë e shqyrtojë çështjet e ndryshme të ngritura nga fëmijët.

Biseda interesante mund të zhvillohen gjatë takimeve të mëngjesit ose gjatë kohës për reflektim dhe gjithashtu mund të shërbejnë si pikënisje për procese të tjera edukative.

Jo çdo fëmijë ka nevojë të flasë; disa preferojnë të heshtin, por është thelbësore t'i inkurajojmë ata që të kontribuojnë sa më shumë që të jetë e mundur në punën në grup me idetë dhe sugjerimet e tyre përmes formave të ndryshme të shprehjes.

Biseda është themeli i zhvillimit dhe ka evoluar tek njerëzit në një mënyrë komplekse dhe të rafinuar, duke u bërë një element që karakterizon vetë njerëzimin.

Një edukator mund të fillojë bisedën duke propozuar një temë që e ka vëzhguar me fëmijët ose duke bërë një pyetje të hapur. Ju lutemi shmangni pyetjet me përgjigje po/jo ose pyetjet me një përgjigje të pritshme.

Pyetjet e hapura janë në qendër të një bisede të mirë me fëmijët. Biseda është një akt kognitiv, emocional, relational dhe shoqëror, që përfshin sjelljen, aftësitë motorike dhe aspekte ekzistenciale. Pyetjet me përgjigje të hapura kërkojnë që një person (një fëmijë) të ndalet, të mendojë dhe të reflektojë. Përgjigjet përfshijnë kreativitet, ndjenja, opinione dhe ide personale. Kontrolli i bisedës kalon nga personi që bën pyetjen te personi (personat) ose fëmija që pyetet.

Kur flasim për pyetje të hapura, nuk janë vetëm pyetjet që duhet të jenë të hapura. Burimet që u ofrohen fëmijëve duhet të jenë gjithashtu të hapura. Fëmijëve duhet t'u jepen burime për t'u ndihmuar që të realizojnë eksplorimet dhe pyetjet e tyre. Natyra përdoret gjithashtu për të ndihmuar në krijimin e lidhjeve dhe një përvojë autentike të të nxëniet shqisor. Si edukator, ju mund t'i ndihmoni fëmijët të krijojnë lidhje dhe t'i thellojnë njohuritë e tyre në bashkëpunim me mjedisin. Kjo krijon respekt dhe kujdes.

Pyetjet e hapura nuk mund të marrin përgjigje me një "po" ose "jo" të thjeshtë ose me një përgjigje statike. Ato formulohen si një pohim që kërkon një përgjigje më të gjatë. Ato mund të krahasohen me pyetjet e mbyllura, të cilat kërkojnë një përgjigje "po"/"jo" ose një përgjigje të shkurtër.

Shembuj të pyetjeve me përgjigje të hapura janë dhënë më poshtë:

Pyetjet strategjike

Këto pyetje i ndihmojnë fëmijët të mendojnë rreth zgjidhjes së problemeve dhe planifikimit.

- Çfarë mund të bëjmë ne nëse shoku/shoqja jonë ndihet i/e trishtuar/e?
- Si mund ta bëjmë klasën tonë edhe më argëtuese për të mësuar?
- Nëse do të donim të ndërtonim kullën më të lartë, çfarë do të duhej të provonim më parë?
- Çfarë mendoni se do të ndodhë nëse i shtojmë më shumë ujë rërës?
- Si mund të bashkëpunojmë për ta zgjidhur këtë enigmë?
- Çfarë mund të bëjmë për këtë...?
- Çfarë mjetesh na duhen për të...?
- Si mendoni se duhet të vazhdojmë me...?

Pyetjet reflektuese

Këto pyetje i inkurajojnë fëmijët të reflektojnë mbi përvojat dhe ndjenjat e tyre.

- Cila ishte pjesa më e mirë e ditës tënde sot? Pse?
- Si u ndjeve kur ndihmove shokun tënd dje?
- Çfarë të befasoï më shumë në tregimin tonë të sotëm?
- A mund të më tregosh për një rast kur je ndjerë vërtet krenar për veten?
- Çfarë mësuat kur luanim jashtë?
- A e keni parë ose dëgjuar ndonjëherë këtë koncept më parë?
- A e keni provuar ndonjëherë këtë përvojë?
- A ke luajtur ndonjëherë me shokun/shoqen X të grupit?
- Bazuar në përvojën tënde, a ke provuar ndonjëherë ta bësh këtë?

Pyetjet jo të drejtpërdrejta

Këto pyetje i inkurajojnë fëmijët të shohin perspektiva të ndryshme dhe t'i ndërlidhin idetë me miqtë ose të tjerët.

- Çfarë mendon se mund të ndiejë shoku/shoqja jote për këtë tregim?
- Si do t'ia përshkruaje këtë fotografi dikujt që nuk e ka parë ende?
- Kush mund t'ju ndihmojë të mendoni pse kafshët jetojnë në vende të ndryshme?
- Në mesin e miqve tuaj, a ka ndonjë që mund t'ju ndihmojë të mendoni/të bëni kërkime rreth fluturave?
- Si ngjan kjo lodër me diçka tjetër me të cilën ke luajtur? Dhe a mendon se ndonjë nga miqtë e tu do të donte të diskutonte për këtë temë?
- Kush do të mund t'ju ndihmonte ta bëni këtë?
- Cili nga shokët/shoqet e klasës mund të jetë i dobishëm në...?
- Me kë do të dëshironit të punonit...?



7. Prindërit, kujdestarët dhe pjesëmarrja

Pjesëmarrja është një aspekt thelbësor i rrugëtimit edukativ të institucionit të EFH-së . Një projekt bashkëkohor edukativ duhet domosdoshmërisht të konceptohet, zbatohet dhe vlerësohet kolektivisht. Prandaj, përvojat e të nxënësve nuk ndahen dhe bashkë-ndërtohen vetëm, brenda shërbimeve, midis edukatorëve dhe fëmijëve, por edhe jashtë tyre, pra, me prindërit/ kujdestarët ligjorë dhe komunitetin “edukues” (lagje, qytet, shoqëri civile). Të gjithë akterët janë bashkautorë të të nxënësve dhe kontribuojnë në kërkim dhe komunikim publik. Pjesëmarrja e prindërve dhe komunitetit, si dhe promovimi i edukimit integral të fëmijëve, krijon njohuri, respektim dhe pëlqim nga ana e qytetarëve për shërbimet, një element i rëndësishëm për integrimin, përfshirjen dhe qëndrueshmërinë e sistemit.

Ndërveprimi zhvillohet nëpërmjet takimeve individuale midis stafit të institucionit të EFH-se dhe prindërve, duke përfshirë një takim paraprak, i cili do të mbahet në kohën e regjistrimit, për të ndarë elementet kryesore të projektit edukativ dhe për të bërë lidhje ndërmjet tij dhe përvojave edukative dhe zhvillimore në shtëpi. Mund të zhvillohen edhe takime kolektive, me grupe të vogla ose me të gjithë prindërit për të eksploruar disa tema edukative me ndihmën e ekspertëve ose për aktivitete argëtuese ose festa, ekspozita dhe ngjarje të tjera. Praktikën pjesëmarrëse mund të përfshijnë gjithashtu përfshirjen e drejtpërdrejtë të prindërve në aktivitetet e projektit që zhvillohen në shërbime.

Kjo marrëdhënie e vazhdueshme ndërmjet shërbimeve dhe prindërve garanton vazhdimësinë e procesit të të nxënësve edhe në shtëpi me përfitime të mëdha për të miturit në aspektin e zhvillimit; si dhe zgjeron njohuritë mbi objektivat dhe aktivitetet e shërbimit komunitar, dhe në veçanti ndërgjegjësimin për rëndësinë e Edukimit në Fëmijërinë e Hershme, dhe identifikimin e tij si një e drejtë dhe një e mirë e përbashkët. Në të njëjtën kohë, pjesëmarrja garanton vëmendjen dhe njohjen e dallimeve socio-ekonomike, fetare, kulturore, të familjeve dhe nevojave të tyre dhe të fëmijëve, duke përforcuar përfshirjen e shërbimeve në fëmijërinë e hershme.

7.1 Mundësitë për pjesëmarrje për prindërit dhe kujdestarët ligjor

Në kompleksitetin e pjesëmarrjes, bëhen propozime të ndryshme të cilat artikulojnë gjatë vitit, por që duhet të jenë gjithmonë pjesë e planifikimit pedagogjik. Përpara se të fillohet pjesëmarrja, këshillohet të planifikohen vizita përgatitore, të cilat janë veçanërisht të dobishme për prindërit dhe kujdestarët që të fillojnë të formojnë një ide.

Duhet të ketë një takim hyrës midis tyre, në të cilin institucioni i EFH –së dhe funksionimi i strukturës u ilustrohen familjeve të reja dhe atyre që tashmë marrin pjesë. Drejtori i institucionit = zakonisht merr pjesë në këtë takim. Takimi hyrës zakonisht mbahet në javën e tretë të gushtit, para vitit të ri edukativ\shkollor Këshilli drejtues i institucionit të EFH-se rekomandohet të zgjidhet brenda javës së tretë të shtatorit, kur prindërit njihen me njëri-tjetrin dhe fëmijët janë në fund të adaptimit/përshtatjes së tyre në institucion.

Gjatë vitit, mbahen të paktën tre takime sipas grupmoshave, në të cilat marrin pjesë edukatorët e grupmoshës, p.sh. edukatorët e grupmoshës 0-3 vjeç, si dhe një përfaqësues i stafit i caktuar për shërbimet e përgjithshme.

Në takimin e parë, zakonisht në shtator, ilustrohet procesi i familjarizimit të fëmijëve (i cili duhet të përfundojë ose është afër përfundimit) dhe planifikimi vjetor. Në takimin e dytë të klasës/grupit, në mes të vitit, ndahet gjendja e grupit, projektet në vazhdim dhe familjeve u ofrohet ose ilustrohet një dokumentim i punimeve të prodhuara nga fëmijët për të mbështetur reflektimet e tyre.

Në takimin e tretë, bëhet vlerësimi i vitit që po mbaron, shqyrtohen portofoliot e fëmijëve, kthehen punimet ose format e tjera të mundshme të dokumentimit dhe bëhet propozimi për verën për të krijuar një vazhdimësi aktiviteteve në mesin e fëmijëve, gjë që është e dobishme për fillimin e vitit të ardhshëm. Është gjithashtu e nevojshme që të organizohen aktivitete shtesë dhe mbrëmje pune me prindërit/kujdestarët. Disa prej këtyre mund të jenë rreth festave ose datave të rëndësishme për notat, ku stafi i institucionit punon me prindërit për të përgatitur materiale të ndryshme për fëmijët, ose për të gjithë klasën\grupin ose institucionin e EFH-së

Sugjerohet të organizohet të paktën një mbrëmje tematike, në të cilën diskutohen tema që lidhen me fëmijërinë e hershme, prindërimin dhe jetën e institucionit me prindërit dhe ekspertë të ndryshëm të fushës, të ftuar.

Këshilli drejtues i institucionit të EFH-së luan një rol kyç kur bëhet fjalë për organizimin e formave të pjesëmarrjes së prindërve në menaxhimin e institucionit. Këshilli mund të aktivizojë të ashtuquajturat grupe projektesh, të cilat janë grupe tematike që aktivizohen gjithmonë me një qëllim specifik, në të cilat mund të marrin pjesë prindërit e interesuar dhe të paktën dy edukatorët e grupit . Ekipet e projektit janë një strategji shumë efektive për të arritur rezultate të caktuara në fusha të caktuara sepse ato zakonisht përbëhen nga një numër i kufizuar njerëzish që janë shumë të motivuar.

Është e rëndësishme që gjatë planifikimit të mundësive për pjesëmarrje, t'i kushtohet vëmendje e madhe mundësisë që të gjithë subjektet/anëtarët në dialog të japin mendimin e tyre, duke shtruar pyetjet e rëndësishme që familjet shpesh duhet t'i bëjnë.

Takimet, mbledhjet tematike, këshillat e menaxhimit, grupet e punës, si dhe prodhimi dhe kthimi i dokumentimit bëhen momente dhe mjete që u mundësojnë prindërve/kujdestarëve të marrin pjesë në institucionin e EFH-se në mënyrë kuptimplotë, dhe në të njëjtën kohë të kalojnë nëpër ngjarjet e institucionit edukativ. Mbi të gjitha, ky reciprocitet ndërtohet përmes fëmijës dhe asaj që ai/ajo përjeton, që di dhe që e jeton çdo ditë.

Takimi	Shpeshtësia	Kur?
Mbledhja e përgjithshme	1	Në javën e tretë të gushtit
Takime sipas grupmoshave	3 ose më shumë	Në shtator, janar-shkurt, maj-qershor, dhe përveç kësaj edhe sipas marrëveshjes\nevojës
Mbrëmje pune	1-2	Kurdo që dakordohen
Mbrëmje tematike	Të paktën 1	Në pranverë
Festa/takime argëtuese	2	Të paktën një në fund të vitit
Këshilli drejtues i institucionit të EFHsë	Sipas rregullores së institucionit	
Grupet e projektit	Në varësi të nevojave tuaja	Në pranverë



UNICEF/2024/S.Karahoda

8. Tranzicionet në Edukimin në Fëmijërinë e Hershme

8.1 Tranzicionet në kontekstin e Edukimit në Fëmijërinë e Hershme dhe institucioneve të EFH-së

Tranzicionet janë momentet dhe proceset që përfshijnë lëvizjen e fëmijës nga një mjedis në tjetrin, nga një aktivitet në tjetrin, ose nga një person tek tjetri. Që nga momentet e para të jetës, fëmijët kalojnë nëpër shumë tranzicione, dhe midis tyre kalimi nga shtëpia në institucionet e edukimit të hershëm ka një rëndësi dhe peshë të madhe në jetën e tyre. Ky tranzicion i madhe pasohet nga momente të tjera të tranzicionit, siç është nga një aktivitet në tjetrin, nga një grup në tjetrin, dhe pastaj përsëri me kalimin në shtëpi. Të gjitha këto tranzicione janë përvoja të rëndësishme për fëmijët pasi i prezantojnë ata me rutinat, mundësitë për bashkëveprim, të nxënimit dhe eksplorimit, dhe për këtë arsye kanë rëndësi të madhe për formësimin e përvojave të të nxënimit përtej edukimit të hershëm.

Tranzicionet në fëmijërinë e hershme, duke filluar që nga vitet e para të jetës, janë aspekte kryesore në promovimin e zhvillimit të tyre nga një perspektivë personale dhe shoqërore. Akterë të ndryshëm janë thelbësorë në udhëzimin dhe mbështetjen e fëmijëve përmes fazave të rritjes dhe në kontekste të ndryshme jetësore dhe të të nxënimit. Suksesi i këtyre proceseve varet gjithashtu nga bashkëpunimi dhe përcaktimi i përgjegjësisve të përbashkëta edukative ndërmjet figurave të ndryshme referuese të fëmijës, siç janë prindërit, të afërmit, komuniteti, edukatorët e kështu me radhë. Për këtë arsye, përveç kontekstit edukativ dhe institucioneve, është e nevojshme të vendosen masa efektive të politikave familjare, të identifikohen mënyra të reja për t'u kujdesur për marrëdhënien familje-EFH, të aktivizohet dhe zgjerohet rrjeti joformal si një burim për familjen dhe të inkurajohet rrjetëzimi midis shërbimeve dhe sektorëve të ndryshëm në këtë sferë.

8.1.2 Pse janë të rëndësishme tranzicionet?

Tranzicionet janë thelbësore për fëmijët sepse mund të jenë stresuese dhe nivelet e larta të stresit ndikojnë negativisht në aftësinë e tyre për të mësuar dhe për tu zhvilluar. Të rriturit duhet ta kuptojnë se stresi ndikon në shëndetin dhe të nxëniet e fëmijëve, dhe për këtë arsye, të përpiqen të krijojnë një mjedis të qetë. Stresi i vazhdueshëm mund të dëmtojë aftësitë intelektuale të një fëmije, duke e bërë të vështirë të nxëniet. Fëmijë të ndryshëm reagojnë ndaj stresit në mënyra të ndryshme, ku disa i përballojnë mirë tranzicionet dhe të tjerët bëhen anksozë (apo të shqetësuar), madje edhe gjatë ndryshimeve të vogla si ndërrimi i aktiviteteve. Ndërtimi i marrëdhënieve të forta me fëmijët dhe familjet e tyre i ndihmon edukatorët të kuptojnë nevojat unike të secilit fëmijë dhe të ofrojnë mbështetjen më të mirë gjatë tranzicioneve¹.

Fëmijët përballen me ndërprerje si një pjesë e natyrshme e zhvillimit dhe edukimit të tyre. Prandaj, apo gjersa kalojnë nëpër tranzicione, është e rëndësishme që fëmijët të mësojnë të jenë fleksibil, duke u përshtatur me ndryshimin. Aspekti themelor është se, gjersa ndryshimi është konstant, qëllimi në menaxhimin e tranzicioneve është një mjedis mbështetës dhe i sigurt ku edukatorët dhe të rriturit e tjerë ofrojnë gjithë mbështetjen dhe mirëkuptimin për fëmijët gjersa kalojnë nëpër tranzicione.

8.2. Llojet e tranzicioneve

Ekzistojnë katër lloje tranzicionesh:



Tranzicioni nga shtëpia në institucion të edukimit në fëmijërinë e hershme dhe anasjelltas (**çdo ditë**)



Tranzicioni nga shtëpia në institucionin e edukimit në fëmijërinë e hershme (**ditët e para**)



Tranzicioni në shkollën fillore – klasën parafilelore



Tranzicionet brenda ditës

8.2.1 Tranzicioni nga shtëpia në IEFH (ditët e para)

Tranzicioni nga shtëpia në shërbimet e edukimit dhe kujdesit në fëmijërinë e hershme është një ngjarje e rëndësishme si për fëmijët ashtu edhe për familjet e tyre. Gjatë kësaj periudhe, familjet mund të ndihen në ankth, ashtu si fëmijët. Fëmijët mund ta kenë të vështirë të përshtaten me rutinat e reja dhe të jenë larg familjeve të tyre. Nga ana tjetër, prindërit mund të shqetësohen për aftësinë e fëmijës së tyre për t'u përballur me mjedisin e ri, për të kuptuar se çfarë pritjet prej tyre dhe për të ditur si të kërkojnë ndihmë. Duke pranuar që fëmijët mund ta kenë të vështirë të përballen me ndryshime të tilla, shumica e mjediseve të edukimit në fëmijërinë e hershme, duke përfshirë edukatorët, menaxhmentin dhe administratorët, duhet të bëjnë përpjekje për

të lehtësuar tranzicionin në edukimin në fëmijërinë e hershme duke i përgatitur si fëmijët ashtu edhe familjet e tyre për situatat, emocionet dhe reagimet – qoftë nga ana e fëmijës apo e tyre – që do të hasin gjatë kalimit nga shtëpia në edukimin në fëmijërinë e hershme².

Ndërtimi i një partneriteti të fortë midis edukatorëve dhe familjes së fëmijës është thelbësor. Kjo i ndihmon të dyja palët të kuptojnë pritjet dhe perspektivat e njëra-



tjetrës. Në këtë mënyrë, si prindërit ashtu edhe edukatorët mund të punojnë së bashku për të mbështetur tranzicionin e qetë të fëmijës.

Strategjitë për ta bërë këtë tranzicion sa më të lehtë që është e mundur mund të ndryshojnë. Para së gjithash, qëndrimi dhe mendësia e edukatorëve janë të rëndësishme. Sa më pozitiv të jetë edukatori ndaj fëmijëve, aq më mirë. Mund të duket e thjeshtë, por ky është themeli.

Këshilla për ta realizuar tranzicionin e parë nga shtëpia në institucionin e edukimit në fëmijërinë e hershme

Institucioni i EFH-së duhet ta marrë parasysh dhe ta pasqyrojë në rregulloret e brendshme pritjen e prindërve në institucion gjatë javës së parë pas regjistrimit, veçanërisht për fëmijët nga zero deri në tre vjeç (0-3 vjeç) të cilët mund të vuajnë nga mungesa e prindërve të tyre. Prindi mund të qëndrojë për një kohë (dy orë) ditën e parë dhe fillon ta zvogëlojë qëndrimin çdo ditë pasuese. Javët në vijim prindërit mund të mos kenë nevojë të vijnë; megjithatë, kjo mbetet për t'u vlerësuar bazuar në situatën specifike.

Por, që kjo të ndodhë siç duhet, edukatorët ose udhëheqësi i institucionit duhet të takohen me prindërit dhe të japin disa informacione për të krijuar një kontekst besimi të ndërsjellë.

Për më tepër, për fëmijët nuk duhet të kujdesen vetëm edukatorët; është e rëndësishme që mjedisi të ofrojë një gamë të gjerë aktivitete në mënyrë që fëmija të jetë i lumtur që ndodhet në qerdhe.

Ja disa këshilla praktike shtesë për t'u marrë parasysh:

Krijoni një libër me figura: Tregoni foto të qendrës së edukimit në fëmijërinë e hershme dhe të stafit për t'i ndihmuar fëmijët të njihen me mjedisin e tyre të ri.

Vizita graduale: Lejojini fëmijët të vizitojnë institucionin për disa orë gjatë një ose dy javësh përpara se të fillojnë shkollën me orar të plotë.

Përdorni informatat familjare: Përfshijini në aktivitete ato që mësoni nga familjet rreth interesave të fëmijës së tyre.



Objekte kalimtare: Objektet kalimtare ofrojnë siguri emocionale për fëmijët. Ato janë lidhje të rëndësishme me shtëpinë. Lejojini fëmijët të sjellin sende (lodra, jastëkë, batanije) nga shtëpia në qendrën e edukimit në fëmijërinë e hershme për t'i ndihmuar që të ndihen më të sigurt.

Përgatitni mjedisin: Krijoni hapësira të qarta dhe të organizuara për t'i ndihmuar fëmijët të kalojnë pa probleme nga një aktivitet në tjetrin.

8.2.2 Tranzicioni nga shtëpia në institucion parashkollor dhe anasjelltas (çdo ditë)

Kalimet nga shtëpia në institucionin e EFH-së, duhet të jenë të lehta për fëmijët, edukatorët dhe prindërit. Për të siguruar këtë, rituali është një mënyrë shumë e rëndësishme e tranzicionit. Për shembull, krijimi i një mënyre të veçantë për të përshëndetur secilin fëmijë në mëngjes, siç është një shtrëngim duarsh ose një këngë mirëseardhjeje, mund të ndihmojë në vendosjen e një atmosfere pozitive për ditën. Gjithashtu, zhvillimi i një aktiviteti të shkurtër ditor, si p.sh. t'i lejojnë fëmijës të vendosë sendet e veta personale, i ndihmon fëmijët të kuptojnë se ky është fillimi i ditës së tyre dhe krijon një ndjenjë pronësie dhe përkatësie.

Ritualet janë të rëndësishme në çdo tranzicion që lidhet me jetën e përditshme të institucionit. Në mëngjes dhe në fund të ditës, një shkëmbim i shpejtë informacioni midis stafit të institucionit të EFH-së dhe prindërve është thelbësor. Ky shkëmbim nuk duhet të kufizohet vetëm në aspekte të kujdesit, siç janë ushqyerja dhe gjumi, por gjithashtu duhet të ndihmojë të dyja palët të qendrojnë të informuara rreth përvojave dhe emocioneve të fëmijës gjatë ditës duke shpjeguar shkurtimisht aktivitetet dhe pjesëmarrjen e fëmijës.

Inkurajimi i bisedave në shtëpi rreth përvojave në institucionin e EFH-së është gjithashtu një mënyrë e mirë për të mbështetur tranzicionin, në mënyrë që fëmija të mos e konsiderojë institucionin si një alternativë ndaj mjedisit shtëpiak, por më tepër si një plotësues të tij. Kur prindërit diskutojnë për atë që fëmija i tyre ka bërë gjatë ditës dhe reflektojnë mbi aspekte të përvojës së institucionit, kjo e ndihmon fëmijën ta shohë institucionin e EFH-se si një pjesë të vlefshme dhe plotësuese të viteve të para të jetës së tij. Kjo qasje ndihmon në integrimin e përvojës së institucionit me shtëpinë, duke e bërë tranzicionin më të lehtë dhe duke sjellë idenë se institucioni është një pjesë e rëndësishme dhe e këndshme e rutinës së tij.

Ja disa këshilla praktike shtesë për t'u marrë parasysh:

Krijoni rituale të mbërritjes dhe largimit: Krijoni rutina të qëndrueshme kur fëmijët mbërrijnë dhe largohen nga institucioni i EFH-së, si një përshëndetje e veçantë ose një aktivitet i shpejtë në fund të ditës. Këto rituale i ndihmojnë fëmijët të ndihen të sigurt dhe të kuptojnë se çfarë të presin.

Personalizoni hapësirën e tyre: Lejojini fëmijët të vendosin dhe dekorojnë sirtarin ose zonën e tyre personale në institucionin e EFH-së. Kjo i ndihmon të kenë një ndjenjë pronësie dhe përkatësie.

Ndani përditësimet ditore: Komunikoni shkurtimisht me prindërit gjatë kohës arritjes dhe të largimit të fëmijës në lidhje me ditën e kaluar. Ky shkëmbim ndihmon në ruajtjen e vazhdimësisë dhe i mban të gjithë të informuar.

Inkurajoni bisedat në shtëpi: Nxiti diskutime në shtëpi rreth aktiviteteve dhe përvojave në institucionin e EFH-se. Kjo i ndihmon fëmijët të integrojnë përvojën e tyre të përjetuara në institucionin e EFH-së në rutinën e tyre të përditshme dhe ta shohin atë si një pjesë pozitive të jetës së tyre.



8.2.3 Tranzicionet ditore

Tranzicionet ditore mund të jenë mjaft stresuese për fëmijët. Nevojat unike të secilit fëmijë duhet të merren parasysh gjatë këtyre ndryshimeve. Për shembull, një fëmijë me vështirësi në të nxënë mund të përfitojë më shumë nga sinjalet vizuale sesa prej vetëm udhëzimeve verbale për të kuptuar se çfarë do të ndodhë më pas. Planifikimi i kujdesshëm nga edukatorët është thelbësor për të siguruar që nevojat e çdo fëmije të përmbushen gjatë këtyre tranzicioneve, duke siguruar një përvojë më të qetë dhe më pak stresuese për të gjithë. Kalimi nga një aktivitet në tjetrin është një pikë thelbësore e cilësisë. Fëmijët duhet të jenë në gjendje ta përfundojnë atë që po bëjnë, si një çështje respekti nga edukatorët. Në të njëjtën kohë, është e nevojshme të respektohet struktura kohore e institucionit të EFH-së sepse është një kontekst komunitar me rregulla dhe mënyra pune.

Për këtë arsye, është thelbësore të filloni t'i këshilloni fëmijët se një aktivitet do të përfundojë brenda disa minutash dhe se është në rregull të vazhdojnë për pak kohë duke u përgatitur për aktivitetin tjetër të ditës. Por nëse fëmijët janë ende duke punuar, mund t'u ofrojmë atyre pesë minuta shtesë në mënyrë që çdo tranzicion të jetë i qetë.

Një pikë tjetër e rëndësishme është ta lini materialin gati për ditën tjetër kur një aktivitet nuk ka mbaruar, në mënyrë që fëmijët që punojnë në të, ta dinë se do të kenë një punë për të vazhduar.

Kur fëmijët, dinë se çfarë ndodh më pas i ndihmon të ndihen të sigurt. Për shembull, nëse koha e ushqimit të lehtë vjen gjithmonë pas kohës së përrallave, fëmijët do të fillojnë të përgatiten për ushqimet e lehta kur koha e përrallave të ketë mbaruar. Të qenit fleksibil me orarin dhe t'i lejojnë të luajnë më gjatë kur janë vërtet të angazhuar mund t'i bëjë tranzicionet më të lehta dhe më të rehatshme për ta.

Këshilla për t'i bërë tranzicionet ditore më të lehta

Për t'i ndihmuar fëmijët të kalojnë pa probleme, filloni duke postuar një orar vizual që tregon renditjen e aktiviteteve të përditshme duke përdorur foto ose vizatime. Kjo i ndihmon fëmijët të kuptojnë se çfarë të presin. Për ata që kanë vështirësi me udhëzimet verbale, shfaqja e fotografive të aktiviteteve mund të jetë veçanërisht e dobishme.

Jepni shembullin e sjelljes së qetë gjatë tranzicioneve duke folur butësisht dhe duke lëvizur ngadalë: Fëmijët shpesh pasqyrojnë sjelljen që shohin, kështu që të qëndruarit të qetë mund t'i ndihmojë edhe ata të qëndrojnë të qetë. Kur i përgatitni fëmijët për tranzicion, shpjegoni butësisht se çfarë do të ndodhë më pas, si p.sh. duke thënë: “Kur të mbarojmë së luajturi, do ta pastrojmë vendin për kohën e ushqimit të lehtë (snack)”.

Kuptoni nevojat dhe zhvillimin individual të secilit fëmijë për ta mbështetur atë në mënyrë efektive: Njohja e interesave, frikës dhe situatës së fëmijëve ndihmon në përshtatjen e tranzicionit sipas nevojave të tyre. Ofroni mbështetje shtesë për fëmijët që duken të shqetësuar duke i përfshirë ata në detyra dhe duke u dhënë udhëzime të qarta, si p.sh. t'u kërkoni atyre të ndihmojnë në shtrimin e tryezës. Jini të vëmendshëm dhe të kujdesshëm, pasi fëmijët ndihen më të sigurt kur u besojnë edukatorëve të tyre.

8.2.4 Tranzicioni nga institucioni të edukimit në fëmijërinë e hershme dhe në shkollën fillore (klasën parafillore)

Tranzicioni në shkollën fillore (klasën parafillore) është kompleks, pasi ndryshon konteksti, si dhe mënyra e mësimdhënies dhe e të nxënit. Disa fëmijë janë gati, disa të tjerë jo, dhe mënyra se si i qasen shkollës së re është tejet e rëndësishme.

Prandaj, është e rëndësishme të lehtësohet kalimi i tyre në shkollën fillore me strategji. Për shembull, është e rëndësishme të ftohen për vizitë edukatori\ja e shkollës fillore në institucionin e edukimit në fëmijërinë e hershme . Ata mund ta përshkruajnë shkollën fillore dhe t'i sigurojnë fëmijët për atë që do të ndodhë.

Është gjithashtu një praktikë e mirë të fillosh një projekt në institucionin në fëmijërinë e hershme dhe ta përfundosh atë në shkollë, në mënyrë që projekti të jetë një ngjarje kalimtare.

Në të njëjtën kohë, është një praktikë e mirë të sillen tabela të kopshteve në shkollë (objekte, vizatime) dhe gjithashtu të ndahet dokumentimi pedagogjik me edukatorit , për t'i mësuar ata për kapacitetet e të nxënit të fëmijëve para tranzicionit, me qëllim krijimin e një mjedisi mikpritës.

Një shembull i një projekti mund të jetë krijimi i një tregimi, që mund të fillojë në fund të pranverës në qendrën e edukimit në fëmijërinë e hershme dhe të vazhdojë deri në ditët e para të shkollës(klasës parafillore). Për shembull, fëmijët mund të fillojnë t'i vizatojnë personazhet e tregimit, të shkruajnë disa nga emrat e tyre dhe ta zhvillojnë pjesën e parë të tregimit. Tregimi mund të dramatizohet gjithashtu; mund të kompozohet muzikë ose mund të përdoren gjuhë të tjera. Është shumë e rëndësishme që hapat e parë të fillojnë në qendrën e edukimit në fëmijërinë e hershme dhe të përfundojnë në vitin shkollor pasues. Edukatorët duhet t'ua dorëzojnë materialet mësuesve të shkollës fillore.

8.2.5 Pse tranzicionet mund të bëhen procese sfiduese?

Sjellja e fëmijëve gjatë tranzicionit mund të ndikohet nga disa faktorë:

- **Tranzicione të shpeshta:** Ndryshimet e shpeshta mund t'i mbingarkojnë fëmijët.
- **Tranzicione të njëkohshme:** Kur të gjithë fëmijët kalojnë nëpër tranzicion në të njëjtën kohë, siç është të ngrënit së bashku, kjo mund të jetë stresuese.
- **Kohë të gjata pritjeje:** Pritja e tepërt pa asgjë për të bërë mund të shkaktojë frustrim.
- **Udhëzime të paqarta:** Mungesa e udhëzimeve të qarta verbale ose vizuale mund t'i ngatërrojë fëmijët.
- **Ndryshime të papritura:** Kalimet pa paralajmërim paraprak mund të çojnë në rezistencë.
- **Rutina të ndryshme:** Dallimet e rëndësishme midis rutinës në shtëpi dhe asaj të shërbimit mund të krijojnë konfuzion.

- **Praktika jokonsistent:** Ndryshimet në rutinat midis edukatorëve mund të shkaktojnë pasiguri.
- **Nevoja shtesë:** Fëmijët me nevoja specifike, siç është autizmi, mund të kenë vështirësi me ndryshimet dhe kanë nevojë për mbështetje shtesë.
- **Mungesa e interesit:** Fëmijët mund t'u rezistojnë tranzicioneve nëse nuk janë të angazhuar ose të interesuar në aktivitetin tjetër.
- **Dukshmëria e strategjive:** Bëjini strategjitë e fëmijëve të dukshme për ta dhe për prindërit, në mënyrë që të përforcohen sjelljet pozitive.

8.2.6 Parimet e përgjithshme që duhet ndjekur për të siguruar tranzicione të qeta për fëmijët

- **Familjarizimi:** Lejoni fëmijët dhe familjet e tyre ta vizitojnë shkollën e re para se të zhvendosen. Edukatori/ja e shkollës duhet të vizitojnë gjithashtu çerdhen dhe, nëse është e nevojshme, shtëpinë e fëmijës për të kuptuar nevojat e tyre.
- **Puna së bashku:** I gjithë stafi i institucionit të EFH-së dhe shkollës së re, si dhe agjencitë e tjera duhet të punojnë së bashku për ta mbështetur fëmijën.
- **Komunikoni hapur:** Organizoni takime paraprakisht për të diskutuar se çfarë mbështetjeje do t'i duhet fëmijës dhe si ta përshtatni mjedisin e ri për të. Mbajeni komunikimin të qartë dhe të vazhdueshëm.
- **Dëgjoni fëmijët:** Kushtojini vëmendje asaj që thonë fëmijët në lidhje me gjërat që u ndihmojnë të ndihen më mirë gjatë tranzicionit, edhe nëse nuk përdorin fjalë.
- **Përfshini prindërit:** Përfshijini prindërit në procesin e tranzicionit sepse ata e njohin më mirë fëmijën e tyre dhe mund të ndihmojnë që tranzicioni të jetë më i lehtë.
- **Planifikoni paraprakisht:** Përgatituni mirë për tranzicionet përpara se të ndodhin, për të shmangur ndryshimet e minutës së fundit.
- **Kufizoni tranzicionet:** Zvogëloni numrin e tranzicioneve për të ndihmuar në minimizimin e stresit për fëmijët.
- **Tregojuni pritshmëritë:** Shpjegoni qartë se çfarë duhet të presin fëmijët gjatë çdo tranzicioni.
- **Rishikoni dhe përshtatni:** Vlerësoni rregullisht se si po shkon procesi i tranzicionit dhe bëni ndryshime sipas nevojës.

8.2.7 Projektet e vazhdimësisë

Projektet e vazhdimësisë krijohen, ndër të tjera, për të lehtësuar një tranzicion të qetë për fëmijët nga institucionet e edukimit në fëmijërinë e hershme, duke përfshirë klasat parafillore në shkolla, drejt klasës së parë në shkollën fillore. Qasja përqendrohet në kultivimin e kuriozitetit natyror të fëmijëve, duke inkurajuar eksplorimin dhe duke ndërtuar njohuritë dhe përvojat e tyre. Krijimi i një përvoje të ndërlidhur mësimore synon ta bëjë këtë tranzicion të qetë, tërheqës dhe mbështetës për të gjithë fëmijët.

Projekti i vazhdimësisë fokusohet në një proces edukativ me fëmijët në qendër, ku interesat dhe idetë e fëmijëve vlerësohen dhe eksplorojnë. Mjedi i edukativ duhet të planifikohet për të qenë dinamik, fleksibil dhe i përgjegjshëm ndaj nevojave dhe mendimeve të fëmijëve. Qëllimi është të krijohet një rrugëtim edukativ që eliminon hendekun ndërmjet institucioneve të edukimit në fëmijërinë e hershme dhe shkollës fillore, duke nxitur një ndjenjë përkatësie dhe vazhdimësie.

Objektivat e projektit të vazhdimësisë

- Inkurajon pjesëmarrje aktive dhe bashkëpunim ndërmjet fëmijëve, edukatorëve, mësuesve dhe prindërve\kujdestareve ligjor.
- Bazohet mbi njohuritë dhe përvojat e mëparshme të fëmijëve nga institucioni i edukimit në fëmijërinë e hershme.
- Krijon një tranzicion të qetë duke ruajtur rutina të qëndrueshme dhe të njohura, ndërkohë që prezanton sfida të reja.
- Nxitet një ndjenjë identiteti dhe përkatësie brenda mjedisit të ri-shkollor.
- Nxitja e zhvillimit të vazhdueshëm të të menduarit kritik, kreativitetit dhe shkathtësive të zgjidhjes së problemeve.

Për t'i arritur objektivat e mësipërme, disa parime janë thelbësore dhe duhet të pasqyrohen në punë në nivelin e shkollës fillore (klasën parafillore), të tilla si:

Angazhimi në projekte grupore: Inkurajoni punën në grup, komunikimin dhe përgjegjësinë e përbashkët, bazuar në tema që u interesojnë fëmijëve dhe integrojnë lëndë të ndryshme si arti, shkenca dhe gjuha (p.sh., dinosaurët, kafshët, pemët, personazhet e vizatimeve e kështu me radhë).

Mundësitë për eksplorim: Ofroni fëmijëve mundësi dhe inkurajoni të eksplorojnë mjedisin e tyre dhe të shprehin njohuritë e tyre përmes formave të ndryshme të dokumentimit, duke përfshirë vizatime, modele dhe reflektime me shkrim. Ky proces do t'i ndihmojë që ta ndërlihdin të nxëniet dhe përvojat e tyre të mëparshme në EFH me konceptet e reja të prezantuara në klasën parafillore .

Hyrja graduale dhe e hershme në mjedisin e ri të shkollës fillore (klases parafillore): Përpara se të kalojnë në klasën e parë, fëmijët në nivelin e edukimit në fëmijërinë e hershme, duhet ta vizitojnë shkollën fillore (klases parafillore) një ose më shumë herë për t'i takuar edukatorët e tyre të mundshëm në të ardhmen, për të parë dhe eksploruar klasat. Nëse është e mundur, ata duhet të marrin pjesë në një aktivitet që bëjnë fëmijët e klasës së parë. Këto vizita do të ndihmojnë në uljen e ankthit të fëmijëve dhe do të krijojnë një ndjenjë familjarizimi me mjedisin e ri.

Përfshirja aktive e prindërve në procesin e tranzicionit: Duhet organizuar takime dhe aktivitete të mundshme me prindërit në institucionin e edukimit në fëmijërinë e hershme për t'i informuar ata rreth tranzicionit të rëndësishëm të radhës në jetën e fëmijëve të tyre, ndryshimeve të pritshme në qasjen ndaj të nxëniet dhe mjedisit, dhe se si mund të ndikojë kjo tek fëmijët. Duhet diskutuar gjithashtu parimet dhe objektivat e një tranzicioni të qetë, së bashku me mënyrën se si prindërit mund ta mbështesin tranzicionin e fëmijës së tyre në shtëpi. Prindërit do të ftohen gjithashtu të marrin pjesë në aktivitetet e klasës.

Periudha e tranzicionit dhe projekti i vazhdimësisë duhet të shoqërohen me vëzhgim dhe reagime të vazhdueshme nga fëmijët, edukatorët, mësuesit dhe prindërit\kujdestaret ligjor . Kjo përfshin pyetje të vazhdueshme, diskutime ndërmjet edukatorëve, fëmijëve dhe prindërve para tranzicionit, gjatë fazës përgatitore dhe, më e rëndësishmja, pas tranzicionit, si dhe komunikim të vazhdueshëm ndërmjet mësuesit të shkollës, fëmijëve, prindërve dhe edukatorëve. Progresi i fëmijëve në klasën e parë duhet të dokumentohet dhe duhet të mbahen seanca reflektuese midis mësuesit dhe edukatorit, si dhe me prindërit\kujdestaret ligjor, për të vlerësuar efektivitetin e aktiviteteve. Përshtatjet duhet të bëhen sipas nevojës për të siguruar që vazhdimësia ndërmjet institucionit të edukimit në fëmijërinë e hershme dhe shkollës fillore (Klasa 1) të ruhet dhe të mbetet e qetë. Siç edhe specifikohet, transferimi i dokumentimit të punës së fëmijëve rregullohet përmes legjislacionit në fuqi

8.2.8 Shembull i organizimit të tranzicioneve efektive

Në mënyrë që fëmijët të kalojnë pa probleme nga EFH në shkollën fillore (klasen parafilllore), atyre u kërkohet të krijojnë një libër të personalizuar me titull “Libri për aventurat e mia në shkollën e re” gjersa janë ende në institucionin e EFH-së dhe u jepet udhëzim për ta plotësuar atë gjatë muajve të parë të shkollës fillore. Kohëzgjatja e këtij aktiviteti duhet të përcaktohet bazuar në nevojat dhe interesat e fëmijës, të cilat duhet të respektohen nga mësuesi/ja i/e shkollës fillore (klasen parafilllore) në pajtim me prindërit e fëmijës.

Projekti mund të fillojë duke i çuar fëmijët në një vizitë në shkollën fillore për të eksploruar fusha kyçe si p.sh. klasën, zonën e lojërave dhe mjedisin shkollor. Gjatë vizitës, fëmijët inkurajohen të bëjnë fotografi ose t’i vizatojnë këto hapësira dhe mund t’u bëhen pyetje të tilla si: “Çfarë është e ngjashme në këtë klasë/shkollë me klasën tonë?” ose “A pe ndonjë vizatim ose lodër interesante në zonën e lojërave?” Më pas, secili fëmijë mbështetet në krijimin e librit të vet duke i përdorur këto fotografi dhe përshkrime. Ata gjithashtu mund të shtojnë detaje personale, të tilla si emri i tyre, aktivitetet e tyre të preferuara dhe çdo objekt që duket interesant në mjedis.

Projekti mund të fillojë gjatë dy javëve të fundit të kohës së tyre në EFH. Gjatë dy javëve pasuese pas vizitës, edukatorët duhet të vazhdojnë t’i mbështesin fëmijët në plotësimin e librave të tyre me atë që kanë vëzhguar gjatë vizitës në shkollën fillore (klasen parafilllore) dhe cilat janë pritjet e tyre.

Gjersa fëmijët fillojnë shkollën fillore (klasen parafilllore), do të vazhdojnë ta përditësojnë librin e tyre me përvoja dhe vëzhgime të reja.

Edukatori/ja i/e shkollës fillore (klases parafilllore), duhet të sigurojë që çdo javë të caktohet kohë për këtë aktivitet, duke i lejuar fëmijët ta dokumentojnë mjedisin dhe aktivitetet e tyre të reja.

Në fund të projektit, fëmijët dorëzojnë librat e tyre të plotësuar, të cilët më pas ndahen me prindërit, si dhe me edukatorin (sipas nevojës). Projekte të tilla do t’i ndihmojnë fëmijët të përshtaten me shkollën e tyre të re duke ofruar një mënyrë kreative për t’u lidhur me mjedisin e tyre të ri dhe për të ndjekur progresin e tyre. Kjo gjithashtu do të ndihmojë që edukatori/ja dhe edukatori/jae shkollës fillore të fitojnë një pasqyrë më të qartë se si ndihet fëmija në lidhje me tranzicionin dhe të shërbejë si udhëzim për ta nëse duhet të ndërmerret ndonjë hap gjatë kësaj periudhe të rëndësishme tranzicioni.



9. Zhvillimi motorik

Zhvillimi motorik përfshin përvetësimin e aftësive që lidhen me lëvizjen dhe kontrollin e trupit, duke përfshirë si shkathtësitë motorike të muskujve të mëdhenj ashtu edhe ato të muskujve të vegjël. Shkathtësitë motorike të muskujve të mëdhenj përfshijnë lëvizje më të mëdha që angazhojnë muskujt e mëdhenj të trupit, siç janë ecja, vrapimi, kërcimi dhe ngjitja. Nga ana tjetër, shkathtësitë motorike të muskujve të vegjël përfshijnë lëvizje më të vogla dhe më të sakta, siç është kapja e objekteve të vogla, mbajtja e lapsave ose përdorimi i gërsërëve. Këto aftësi zhvillohen gradualisht dhe mbështeten përmes ndërveprimeve të përditshme dhe aktiviteteve të fokusuara që u lejojnë fëmijëve të eksplorojnë, të mësojnë dhe të rriten.

Zhvillimi motorik është një pjesë thelbësore e edukimit në fëmijërinë e hershme, veçanërisht në vitete edukimit në fëmijërinë e hershme, pasi formon themelin për rritjen fizike, kognitive, sociale dhe emocionale të një fëmije. Gjatë kësaj periudhe, fëmijët përjetojnë një zhvillim të shpejtë si në shkathtësitë motorike të muskujve të mëdhenj ashtu edhe në ato të muskujve të vegjël. Institucionet e edukimit në fëmijërinë e hershme (EFH) luajnë një rol vendimtar në zhvillimin e këtyre shkathtësive përmes aktiviteteve të strukturuar dhe lojës së lirë, duke i ndihmuar fëmijët të ndërtojnë vetëbesim, koordinim dhe gatishmëri për detyra më komplekse të të nxënës.

9.1 Pse është i rëndësishëm zhvillimi motorik?

Zhvillimi motorik është shumë i rëndësishëm për rritjen dhe zhvillimin e përgjithshëm të fëmijëve, pasi luan një rol themelor në mënyrën se si ata bashkëveprojnë me botën përreth tyre dhe në zhvillimin e shkathtësive të tjera thelbësore. Ja disa arsye pse zhvillimi motorik është kaq i rëndësishëm: zhvillimi motorik ndihmon në përmirësimin e forcës muskulore, koordinimit dhe baraspeshës, duke i mundësuar fëmijëve të jenë më të qëndrueshëm dhe të aftë për lëvizje të qëndrueshme. Lëvizja dhe aktivitetet fizike janë të lidhura ngushtë me zhvillimin e aftësive kognitive. Fëmijët që i zhvillojnë mirë shkathtësitë e tyre motorike gjithashtu përmirësojnë përqendrimin, vëmendjen dhe aftësitë e tyre për zgjidhjen e problemeve. Kur fëmijët mësojnë t'i kontrollojnë lëvizjet e tyre dhe të përballen me sfidat fizike, ata fitojnë vetëbesim dhe ndihen më të pavarur. Zhvillimi i aftësive të tilla si ecja, kapja ose përdorimi i mjeteve si lapsa dhe gërsërë i bën ata më të aftë për të kryer detyrat e përditshme pa ndihmë, duke rritur ndjenjën e tyre të arritjes dhe pavarësisë.

Përmes aktiviteteve motorike, fëmijët mësojnë të bashkëpunojnë, të ndajnë gjësendet dhe të ndjekin rregullat në lojëra të ndryshme. Zhvillimi motorik krijon mundësi për ndërveprim shoqëror, i cili është i rëndësishëm për ndërtimin e marrëdhënieve të shëndetshme dhe aftësive emocionale. Lojërat fizike të kryera në grupe i ndihmojnë fëmijët të kuptojnë rëndësinë e punës në grup dhe ndjeshmërisë ndaj të tjerëve. Shkathtësitë motorike të muskujve të vegjël, të tilla si mbajtja e një lapsi dhe përdorimi i gërsërëve, janë thelbësore për detyrat themelore shkollore si shkrimi, vizatimi dhe përdorimi i mjeteve të klasës. Fëmijët që nuk i zhvillojnë mirë këto shkathtësi mund të përballen me sfida në kryerjen e detyrave shkollore, të cilat mund të ndikojnë në vetëbesimin dhe gatishmërinë e tyre për sukses akademik. Në përgjithësi, zhvillimi motorik u ofron fëmijëve një bazë të fortë për të pasur sukses në fusha të ndryshme të jetës. Është thelbësor për shëndetin fizik, zhvillimin intelektual dhe ndërtimin e vetëbesimit dhe pavarësisë, duke siguruar që ata të rriten në një mënyrë të ekuilibruar dhe të gëzojnë mirëqenie të përgjithshme.


Për fëmijët e vegjël, lëvizja nuk është vetëm një aktivitet fizik; është një pjesë integrale e procesit të tyre të të nxënës dhe zhvillimit. Aktivitetet që përfshijnë lëvizjen fizike jo vetëm që ndihmojnë në përmirësimin e shkathtësive motorike, por janë gjithashtu thelbësore për funksionet e përgjithshme të trurit dhe zhvillimin e aftësive kognitive, të cilat i ndihmojnë fëmijët të përfitojnë më shumë nga të nxënës e tyre.

Ja disa mënyra specifike se si lëvizja ndikon në funksionet kognitive dhe sjell përfitime për të nxënëit:

1. **Rritja e neurotrofinave dhe përmirësimi i kujtesës-** Kur fëmijët angazhohen në aktivitete fizike, të tilla si lojëra ku aktivizohen muskujt e mëdhenj ose duke ecur nëpër klasë, truri i tyre zhvillon më shumë lidhje që mbështesin kujtesën si afatshkurtër ashtu edhe atë afatgjatë. Për shembull, një lojë që përfshin ndjekjen e udhëzimeve dhe përdorimin e lëvizjeve të ndryshme i ndihmon fëmijët të përforcojnë informacionin dhe t'u japin kuptim koncepteve të reja.
2. **Përmirësimi i vëmendjes dhe qëndrueshmërisë kognitive-** Lëvizja i ndihmon fëmijët të përqendrohen më mirë dhe të ruajnë qëndrueshmëri më të lartë në ndjekjen e detyrave të të nxënëit. Aktivitetet që përfshijnë ndryshimin e pozicioneve ose lëvizjen e lirë në klasë, si ecja midis tavolinave të klasës, i ndihmojnë fëmijët të ruajnë vëmendjen për periudha më të gjata dhe të kalojnë nga një aktivitet në tjetrin me lehtësi më të madhe.
3. **Përpunimi dhe integrimi i të dhënave shqisore-** Lëvizja përfshin përdorimin e shqisave, gjë që është thelbësore për përpunimin e informacionit dhe zhvillimin e aftësive kognitive. Kur fëmijët angazhohen në aktivitete që përfshijnë të dhëna vizuale, ndijore dhe dëgjimore, ata zhvillojnë aftësinë për ta integruar këtë informacion dhe për ta përpunuar atë më saktë. Për shembull, një lojë ku fëmijët duhet t'i identifikojnë objektet me anë të prekjes me sytë e mbyllur dhe më pas t'i emërtojnë ato i ndihmon ata të përforcojnë kujtesën dhe të përpunojnë informacionin më shpejt nga shqisa të ndryshme.
4. **Krijimi i një mjedisi edukativ dinamik dhe mobil-** Lejimi i lëvizjes së lirë gjatë ditës i ndihmon fëmijët të ndihen të çliruar dhe më të përgatitur për të mësuar. Klasat që ofrojnë aktivitete të ndryshme fizike, të tilla si kërcimi në dysheme ose kalimi nëpër pika të ndryshme edukative, krijojnë një mjedis të gjallë që përputhet me mënyrën natyrale të funksionimit të trurit të fëmijëve të vegjël. Për shembull, një rutinë mësimdhënieje që ndryshon midis aktiviteteve statike dhe dinamike i ndihmon fëmijët të zhvillojnë një ritëm natyror të të nxënëit që plotëson nevojat e tyre kognitive dhe emocionale.

Brain after sitting quietly

Brain after 20 minute walk



Research/scan compliments of Dr. Chuck Hillman, University of Illinois

9.2 Ndërlidhja e zhvillimit motorik me fushat e tjera të zhvillimit

Shëndeti fizik dhe mirëqenia: Zhvillimi i shkathtësive motorike në fëmijërinë e hershme është i lidhur drejtpërdrejt me shëndetin fizik. Aktivitetet e rregullta fizike si vrapimi, baraspesha dhe loja në fushat e lojërave ndihmojnë në forcimin e muskujve, përmirësimin e shëndetit kardiovaskular dhe rritjen e qëndrueshmërisë. Inkurajimi i lëvizjes që në fillim zvogëlon rrezikun e sjelljes sedentare (mungesës së aktivitetit fizik) më vonë në jetë, duke promovuar zakone të aktivitetit fizik gjatë gjithë jetës, të cilat janë thelbësore për parandalimin e obezitetit të fëmijërisë dhe problemeve shëndetësore që lidhen me të.

Zhvillimi motorik ndërlidhet ngushtë me fusha të tjera zhvillimore, të tilla si zhvillimi kognitiv, social dhe emocional. Për shembull, kur një fëmijë mëson të ecë, gjithashtu fiton besim në aftësitë e veta dhe zhvillon vetëvlerësim. Zhvillimi motorik gjithashtu ndihmon në përmirësimin e fokusit dhe përqendrimit, të cilat janë kritike për zhvillimin kognitiv. Gjersa fëmijët angazhohen në aktivitete fizike, ata gjithashtu mësojnë aftësi për zgjidhjen e problemeve, ndërgjegjësimin hapësinor dhe marrëdhëniet shkak-pasojë. Për shembull, grumbullimi i blloqeve ose kalimi i pengesave kërkon planifikim, përqendrim, dhe koordinim mendor. Studimet kanë treguar se zhvillimi i aftësive motorike mbështet funksionet ekzekutive si vëmendja, kujtesa dhe vetërregullimi, të cilat janë thelbësore për suksesin akademik.

Për më tepër, kur fëmijët luajnë së bashku në aktivitete motorike, ata mësojnë aftësi sociale siç janë ndarja e gjësendeve me të tjerët dhe bashkëpunimi. Pjesëmarrja në aktivitete në grup që përfshijnë lëvizje, siç është loja me top ose pjesëmarrja në ushtrime në grup, nxit ndërveprimet sociale dhe punën në grup midis fëmijëve. Këto aktivitete u mësojnë fëmijëve si të shkëmbejnë gjëra, të ndjekin rregullat dhe të bashkëpunojnë me bashkëmoshatarët. Zotërimi me sukses i detyrave motorike gjithashtu rrit vetëvlerësimin, duke u dhënë fëmijëve besimin për t'u përballur me sfida të reja dhe për të vazhduar përballë vështirësive. Përveç kësaj, aktiviteti fizik ofron një rrugëdalje nga stresi dhe rregullim emocional, duke i ndihmuar fëmijët t'i menaxhojnë emocionet e tyre në mënyrë efektive. Duke mbështetur zhvillimin motorik, edukatorët përmirësojnë aftësitë fizike dhe inkurajojnë rritjen e përgjithshme në fusha të ndryshme të jetës.

9.3 Një qasje zhvillimore e baraspeshuar

Programet e edukimit në fëmijërinë e hershme me cilësi të lartë integrojnë zhvillimin motorik me fusha të tjera të të nxënës, duke u ofruar fëmijëve një qasje gjithëpërfshirëse që mbështet edukimin e hershëm. Një kurrikulë e baraspeshuar përfshinë kohë për aktivitete fizike, mundësi për lojë imagjinative dhe hapësirë për shprehje kreative, duke siguruar që fëmijët të zhvillohen si fizikisht ashtu edhe intelektualisht. Kjo qasje i ndihmon fëmijët jo vetëm t'i përmirësojnë aftësitë e tyre motorike, por edhe të fitojnë aftësi sociale dhe emocionale që janë thelbësore për zhvillimin e përgjithshëm.

Edukatorët mund ta mbështesin zhvillimin motorik përmes aktiviteteve të strukturuar që nxisin forcën dhe koordinimin. Disa nga këto aktivitete mund të përfshijnë vallëzimin, lojërat sportive apo edhe jogën, të cilat jo vetëm që ndihmojnë në zhvillimin fizik, por edhe përmirësojnë fokusin dhe vetëkontrollin. Përveç aktiviteteve të strukturuar, edukatorët duhet të ofrojnë mjedise të sigurta dhe stimuluese ku fëmijët mund ta eksplorojnë lëvizjen e lirë dhe të zhvillojnë aftësi motorike përmes lojës spontane. Duke krijuar një mjedis që mbështet eksplorimin, edukatorët i ndihmojnë fëmijët të ndërtojnë një themel të fortë për sukses të mëvonshëm në shkollë dhe në jetën e përditshme.

9.4 Komponentët e zhvillimit motorik

9.4.1 Zhvillimi i shkathtësive motorike të muskujve të mëdhenj

Shkathtësitë motorike të muskujve të mëdhenj janë thelbësore për lëvizje të mëdha dhe përfshijnë aktivitete të tilla si ecja, vrapimi, kërcimi, ngjitja, rrotullimi dhe hedhja. Këto aftësi janë gjithashtu jetësore për aktivitetet e përditshme të kujdesit për veten, të tilla si veshja dhe zhveshja (fëmijët që kanë shkathtësi motorike të muskujve të mëdhenj të zhvilluara mirë janë më të aftë të përkulen, të qëndrojnë në baraspeshë dhe të lëvizin trupin e tyre për të veshur rroba ose këpucë). Pavarësia në lëvizje (si ecja, vrapimi, marrja e objekteve) i ndihmon fëmijët të lëvizin lirshëm në mjedise të ndryshme dhe të mbajnë në mënyrë të sigurt gjërat që mund t'u nevojiten për aktivitetet e përditshme. Aftësitë jetësore të zhvilluara përmes aktiviteteve motorike të muskujve të mëdhenj përfshijnë: vetëmenaxhimin dhe pavarësinë, përqendrimin dhe durimin në rritje, përgatitjen për detyrat akademike dhe zakonet e përditshme të kujdesit për veten, të tilla si veshja, ngrënia dhe ruajtja e pastërtisë.

Shkathtësitë motorike të muskujve të mëdhenj janë thelbësore për mbështetjen e funksioneve të ndryshme të përditshme. Për shembull, aftësia e një fëmije për të ruajtur qëndrimin e duhur në tavolinë është thelbësore për t'u angazhuar në aktivitete motorike të muskujve të vegjël si shkrimi dhe vizatimi, si dhe për t'u përqendruar në aktivitetet në grup, të cilat ndikojnë në performancën akademike. Këto aftësi ndikojnë gjithashtu në qëndrueshmërinë e një fëmije për t'u përballur me kërkesat fizike të një dite shkollë, siç është ulja në tavolinë, lëvizja ndërmjet klasave dhe mbajtja e një çante shpine. Për më tepër, shkathtësitë motorike të muskujve të mëdhenj i ndihmojnë fëmijët të eksplorojnë mjedisin e tyre, siç është manovrimi rreth mobiljeve të klasës ose ngjitja dhe zbritja e shkallëve. Pa shkathtësi të zhvilluara motorike të muskujve të mëdhenj, fëmijët mund të përballen me vështirësi në detyrat e përditshme. Disa shembuj të aktiviteteve për zhvillimin e shkathtësive motorike të mëdha përfshijnë:

- **Vrapimi dhe ecja në natyrë**– Këto aktivitete ndihmojnë në zhvillimin e forcës dhe qëndrueshmërisë fizike dhe janë të rëndësishme për shëndetin e përgjithshëm të fëmijës, duke përmirësuar orientimin hapësinor.
- **Shtegu me pengesa dhe kërcimi mbi pengesa**– Duke i kapërcyer pengesat, fëmijët zhvillojnë baraspeshën, koordinimin dhe vetëdijen për mjedisin përreth. Këto aktivitete i ndihmojnë ata të përballen me sfidat fizike dhe të fitojnë besim në shkathtësitë e tyre.
- **Ngjitja në struktura të ndryshme (p.sh., litarë, shkallë, mure të ulëta)** – Ky aktivitet ndihmon në forcimin e muskujve të krahëve dhe këmbëve, përmirëson ekuilibrin dhe koordinimin, dhe i mëson fëmijët të ruajnë baraspeshën në lartësi të ndryshme, duke përforcuar ndjenjën e sigurisë dhe vetëbesimit.
- **Lojëra me hedhje dhe top**– Këto lojëra përmirësojnë koordinimin sy-dorë, si dhe aftësinë për të kontrolluar lëvizjet dhe zhvillojnë një ndjenjë bashkëpunimi përmes lojës në grup, siç janë detyrat si të ngrënit, paketimi i lodrave ose përdorimi i tualetit në mënyrë të pavarur.

9.4.2 Zhvillimi i shkathtësive motorike të muskujve të vegjël

- Cili është qëllimi i dokumentimit që po kryej? A e përdor atë për të ndjekur zhvillimin, për të ndarë progresin me prindërit apo për të planifikuar aktivitete të ardhshme?
- Sa qartë e dokumentoj të nxënit e fëmijëve? A e tregon dokumentimi im në mënyrë kuptimplotë historinë e të nxënit të fëmijës?

Saktësia dhe rëndësia:

- A janë shënimet e mia të dokumentuara mjaftueshëm të detajuara dhe të sakta për të ofruar njohuri kuptimplota mbi procesin e të nxënit të fëmijës?
- Si t'i kap momentet më të rëndësishme të të nxënit të një fëmije pa e mbingarkuar veten me shumë detaje?

Vazhdimësia:

- A po dokumentoj rregullisht dhe vazhdimisht për fëmijët, aktivitetet dhe fusha të ndryshme të zhvillimit?
- Si mund të sigurohem që po i dokumentoj të gjithë fëmijët në mënyrë të barabartë, duke marrë parasysh rrugën unike të zhvillimit të secilit fëmijë?

Përdorimi i dokumentimit:

- Si po e përdor dokumentimin për të mbështetur strategjitë e mia të ardhshme të mësimdhënies dhe planifikimin e kurrikulës?
- A po e shqyrtoj dhe reflektoj rregullisht dokumentimin për ta vlerësuar zhvillimin e fëmijës me kalimin e kohës?

Bashkëpunimi dhe shkëmbimi:

- Si mund ta ndaj dokumentimin tim me kolegët? A po diskutojmë zhvillimin e fëmijëve si ekip për të krijuar një kuptim më të thellë?
- Si mund t'i përfshijë prindërit në procesin e dokumentimit? A po ndaj në mënyrë efektive njohuritë me ta për të mbështetur të nxënit e fëmijës në shtëpi?

Mjetet dhe metodat:

- Çfarë metodash (foto, shënime, video, shembuj pune) po përdor për dokumentim dhe a janë këto më efektive për ta pasqyruar rrugëtimin edukativ të fëmijës?
- Si mund t'i përmirësoj mjetet dhe metodat e dokumentimit për ta bërë procesin më efikas dhe kuptimplotë?

Reflektimi dhe rritja:

- Si mund ta përdor dokumentimin tim për të reflektuar mbi praktikat e mia të mësimdhënies? Çfarë modelesh shoh në të nxënit e fëmijëve dhe si mund të ndikojë kjo në qasjen time?
- Me çfarë sfidash po përballem në procesin e dokumentimit dhe si mund t'i adresoj ato për ta përmirësuar praktikën time?

10.5 Vlerësimi në edukimin në fëmijërinë e hershme

Vlerësimi në Edukimin në Fëmijërinë e Hershme (EFH) është një proces i mbledhjes dhe analizimit të informacionit në lidhje me zhvillimin dhe progresin e një fëmije për të kuptuar nevojat e tij individuale dhe për të planifikuar dhe ofruar më mirë mbështetje edukative dhe zhvillimore. Qëllimi i vlerësimit në EFH është t'i ndihmojmë fëmijët të arrijnë potencialin e tyre të plotë duke krijuar një mjedis edukativ mbështetës dhe të përshtatur që nxit zhvillimin e tyre në të gjitha fushat.

Qëllimi i vlerësimit në edukimin e hershëm **NUK** është të matë performancën e fëmijëve përmes testeve standarde, por të vëzhgojë dhe dokumentojë momentet e tyre zhvillimore, proceset edukative dhe ndërveprimet me qëllim mbështetjen e zhvillimit të tyre të plotë në një mënyrë që është e përshtatur dhe e ndjeshme ndaj nevojave individuale, duke siguruar një bazë të fortë për arritje të mëtejshme në jetë.

10.5.1 Qëllimi i vlerësimit në edukimin në fëmijërinë e hershme

Qëllimi i vlerësimit në edukimin në fëmijëri të hershme është të mbështesë zhvillimin holistik të fëmijëve duke ndjekur progresin e tyre dhe duke përshtatur përvojat edukative sipas nevojave të tyre individuale. Vlerësimi i të nxënit të fëmijëve, bazuar në dokumentim dhe të dhëna pedagogjike, është një element kritik i edukimit modern, veçanërisht në mjediset e fëmijërisë së hershme. Kjo qasje u mundëson edukatorëve të vëzhgojnë, dokumentojnë dhe analizojnë proceset e të nxënit në një mënyrë të strukturuar dhe reflektuese. Duke mbledhur të dhëna nga burime të shumta, edukatorët mund ta kuptojnë më mirë trajektoren zhvillimore të secilit fëmijë dhe ta përshtasin mësimdhënien për t'i përmbushur nevojat e tyre individuale. Konkretisht, qëllimet kryesore përfshijnë:

- **Identifikimi i nevojave individuale:** Vlerësimi ndihmon në kuptimin e ritmit dhe stilit të të nxënit të secilit fëmijë, duke identifikuar fushat ku ata kanë nevojë për mbështetje shtesë ose ku mund të përfitojnë nga ndërhyrje specifike.
- **Mbështetja e zhvillimit holistik:** Qëllimi është të monitorohet progresi në fusha të ndryshme zhvillimore - fizike, kognitive, sociale dhe emocionale - duke u përqendruar në zhvillimin e ekuilibruar dhe të shëndetshëm.
- **Përshtatja e qasjeve edukative :** Të dhënat e vlerësimit u mundësojnë edukatorëve të përshtasin aktivitetet dhe qasjet për t'iu përgjigjur më mirë stileve dhe interesave të të nxënit të fëmijëve, duke krijuar përvoja të personalizuar dhe efektive të të nxënit.
- **Vendimmarrja për ndërhyrjet dhe mbështetjen e hershme:** Vlerësimi është thelbësor për identifikimin e fëmijëve që mund të kenë nevojë për ndërhyrje të hershme ose shërbime të specializuara për të mbështetur zhvillimin e tyre, duke ndihmuar në referime dhe vendime për mbështetje të mëtejshme.
- **Përfshirja dhe ndërgjegjësimi i prindërve:** Vlerësimi ndihmon në ndarjen e informacionit të dobishëm me prindërit dhe kujdestarët në lidhje me progresin dhe nevojat e fëmijës, duke i përfshirë ata në procesin e të nxënit dhe në vendimmarrje sipas nevojave të fëmijës.

- **Monitorimi i progresit dhe vlerësimi i përvojave edukative:** Vlerësimi i ndihmon edukatorët të kuptojnë nëse praktikatat dhe aktivitetet që përdorin janë efektive dhe të përshtatshme për fëmijët e vegjël, duke lejuar përmirësime të vazhdueshme në qasjen e tyre edukative dhe duke rritur vetëreflektimin dhe vetëvlerësimin e edukatorëve në lidhje me praktikatat e tyre të mësimdhënies.

Qëllimi nuk është **KURRË** të matet performanca e fëmijëve përmes testeve ose instrumenteve të standardizuara, por të vëzhgohen dhe dokumentohen momentet e tyre të zhvillimit, proceset edukative dhe ndërveprimet me qëllim mbështetjen e zhvillimit të tyre të plotë në një mënyrë të përshtatur dhe të ndjeshme ndaj nevojave të tyre individuale, duke siguruar një fillim të fortë për arritjet e ardhshme në jetë.

10.5.2 Parimet e vlerësimit në EFH

Parimet e vlerësimit në fëmijërinë e hershme bazohen në praktika që mbështesin zhvillimin holistik të fëmijëve dhe janë të përshtatura për t'i përmbushur nevojat dhe potencialin e tyre individual. Elementet kryesore të vlerësimit përfshijnë ruajtjen e fokusit në atë që thotë dhe bën fëmija pa paragjykimet personale, dhënien e detajeve rreth mjedisit të të nxënës, aktiviteteve dhe ndërveprimeve të përfshira, si dhe ndërlidhjen e vëzhgimeve dhe vlerësimeve me momentet zhvillimore dhe/ose objektivat e të nxënës. Disa nga parimet kryesore përfshijnë:

- **Qasje e qëndrueshme dhe e vazhdueshme:** Vlerësimi duhet të jetë një proces i vazhdueshëm që ndodhë natyrshëm gjatë gjithë përvojave të fëmijës në mjedis të ndryshmedukative, duke u zhvilluar nëpërmjet vëzhgimeve dhe ndërveprimeve të përditshme.
- **Individualizimi dhe personalizimi:** Vlerësimi duhet të marrë parasysh fazat e zhvillimit, interesat, pikat e forta dhe nevojat unike të secilit fëmijë, duke e parë secilin si një individ unik me ritme të ndryshme zhvillimi dhe të nxënës.
- **Qasja holistike:** Vlerësimi duhet t'i përfshijë të gjitha aspektet e zhvillimit të fëmijës, duke përfshirë zhvillimin fizik, kognitiv, social, emocional dhe shpirtëror, për të mbështetur rritjen e tyre të përgjithshme.
- **Mbështetja e procesit të të mësuarit:** Qëllimi i vlerësimit është të përmirësojë procesin e të nxënës dhe të krijojë mundësi për të nxënës më të mirë në përputhje me qëllimet e përcaktuara. Vlerësimi nuk përqendrohet në krahasimin me të tjerët, por në përparimin individual dhe ndihmën për zhvillimin e plotë të fëmijës.
- **Përdorimi i metodave të ndryshme dhe vëzhgimi i natyrshëm:** Edukatorët duhet të përdorin metoda të ndryshme për të mbledhur informacion, të tilla si vëzhgime, diskutime, lojëra, shkrim, fotografi dhe aktivitete praktike që përfshijnë fëmijë dhe janë të përshtatshme për moshën.
- **Përfshirja e familjes:** Vlerësimi efektiv përfshin bashkëpunimin me familjen, duke marrë parasysh kontributet dhe perspektivat e prindërve për të kuptuar më mirë zhvillimin dhe përparimin e fëmijës dhe për t'i identifikuar fushat për forcimin e mbështetjes.
- **Etika dhe konfidencialiteti:** Privatësia e fëmijëve dhe familjeve të tyre duhet të respektohet, duke trajtuar informacionin e mbledhur në mënyrë konfidenciale dhe duke e përdorur atë vetëm për të çuar përpara zhvillimin dhe për të përmirësuar përvojat e të nxënës.

Vlerësimi **NUK** ndërtohet **KURRË** duke përdorur vetëm një aktivitet ose vetëm një qasje ndaj dokumentimit, por duhet të mbështetet nga forma të shumta provash.

Vlerësimi duhet të mbështetet gjithmonë nga aktivitete të shumta dokumentare, sepse zhvillimi dhe të nxënës fëmijëve janë shumështrësore dhe dinamike. Për të kuptuar zhvillimin e një fëmije,

është thelbësore të mblidhen prova, vëzhgime dhe dokumentim nga aktivitete, kontekste dhe periudha kohore të ndryshme.

Këto parime ndihmojnë në krijimin e një mjedisi të sigurt dhe mbështetës për fëmijët, ku ata mund të mësojnë dhe të rriten me ritmin e tyre, ndërsa edukatorët marrin vendime të bazuara për të përmirësuar qasjen e tyre pedagogjike ndaj mësimdhënies dhe të nxënit.

10.5.3 Llojet e vlerësimit

Në edukimin në fëmijërinë e hershme (EFH), përdoren disa lloje vlerësimesh për të monitoruar dhe mbështetur zhvillimin e fëmijëve. Llojet kryesore të vlerësimit në këtë fazë përfshijnë:

- **Vlerësimi formativ:** Ky lloj vlerësimi është i vazhdueshëm dhe përdoret për të monitoruar progresin e fëmijës gjatë aktiviteteve të përditshme. Qëllimi i tij është të ndihmojë edukatorët të bëjnë përshtatje në qasjen e tyre edukative për të mbështetur më mirë të nxënit dhe zhvillimin e fëmijës. Vlerësimi formativ përfshinë komponentë zhvillimore për të matur progresin e fëmijës në fusha të tilla si zhvillimi fizik, kognitiv, social dhe emocional.
- **Vlerësim përmbledhës:** Zakonisht kryhet në fund të një periudhe specifike (si p.sh. fundi i një programi ose viti akademik) për të përmbledhur arritjet e fëmijës. Ky vlerësim ofron një pasqyrë të përgjithshme të progresit të fëmijës dhe i ndihmon edukatorët dhe prindërit të kuptojnë zhvillimin gjatë një periudhe më të gjatë.
- **Vlerësim autentik:** Kjo qasje përqendrohet në vëzhgimin dhe dokumentimin e të nxënit të fëmijëve në situata reale dhe natyrore, duke përfshirë aktivitetet që janë pjesë e rutinës së tyre të përditshme. Vlerësimi autentik i ndihmon edukatorët t'i kuptojnë aftësitë, interesat dhe mënyrën se si mësojnë fëmijët në mjedise ku ndihen rehat dhe natyrshëm.
- **Vlerësimi diagnostifikues:** Përdoret për të identifikuar nevojat ose sfidat specifike që një fëmijë mund të ketë në një fushë të caktuar të zhvillimit. Ky vlerësim është i dobishëm në identifikimin e fushave ku fëmija kërkon mbështetje shtesë ose ndërhyrje të veçantë. Në mjediset edukative, ky vlerësim bazohet në referim dhe përdoret për të identifikuar nevojën për referim profesional dhe ndërhyrje të hershme në zhvillim.
- **Vlerësimi me portfolio:** portfolio është një koleksion i punës dhe arritjeve të një fëmije gjatë një periudhe kohore. Ky lloj vlerësimi ndihmon në pasqyrimin e punës së vazhdueshme të fëmijës dhe në identifikimin e pikave të forta dhe fushave ku nevojitet përmirësim.
- **Vetëvlerësimi dhe vlerësim nga bashkëmoshatarët:** Ndonëse është më pak e zakonshme në EFH, në disa raste, teknika të thjeshta vetëvlerësimi ose vlerësimi nga bashkëmoshatarët mund të përdoren për të ndihmuar fëmijët të kuptojnë progresin e tyre dhe të ndërtojnë një vetëdije më të madhe për të nxënit e tyre.

Çdo lloj vlerësimi ka rolin e vet dhe përdoret për të siguruar një pasqyrë gjithëpërfshirëse të zhvillimit të fëmijës, duke mbështetur kështu qasjen holistike dhe nevojat individuale të fëmijëve në këtë fazë të rëndësishme të jetës.

10.5.4 Dokumentimi i vlerësimit në edukimin në fëmijërinë e hershme (EFH)

Dokumentimi i vlerësimit në edukimin në fëmijërinë e hershme (EFH) është procesi i mbledhjes dhe regjistrimit të të dhënave mbi zhvillimin dhe progresin e fëmijëve në një mënyrë sistematike. Ky dokumentim shërben për t'i pasqyruar përvojat, arritjet dhe sfidat e fëmijëve, duke i ndihmuar edukatorët dhe prindërit që ta kuptojnë dhe mbështesin më mirë procesin e të nxënit dhe zhvillimit të fëmijës. Ja disa forma dhe praktika për dokumentimin e vlerësimit në EFH:

- **Vëzhgimet sistematike:** Vëzhgimet janë një nga format kryesore të dokumentimit dhe përfshijnë shënime mbi sjelljen, aftësitë dhe ndërveprimet e fëmijëve gjatë aktiviteteve të përditshme. Këto shënime përqendrohen në progresin e fëmijëve dhe karakteristikat e tyre të të nxënit.
- **Portfolio e fëmijëve:** Një portofol përmban një koleksion të punimeve, vizatimeve, punimeve artizanale dhe fotografive të fëmijës që tregojnë progresin dhe interesat e tij. Ky dokumentim ndihmon në pasqyrimin e përvojave dhe arritjeve individuale të fëmijës në kohë të ndryshme. Portofoli përfshin gjithashtu fotografi dhe video të fëmijëve gjatë aktiviteteve të ndryshme, duke treguar se si ata bashkëveprojnë dhe përjetojnë mjedisin e tyre. Këto të dhëna janë mjete të fuqishme për të ilustruar dhe analizuar momentet e zhvillimit dhe progresit.
- **Intervista dhe komente nga fëmijët:** Në disa raste, fëmijëve mund t'u kërkohet të shprehin ndjenjat e tyre ose të ndajnë mendime rreth përvojave të tyre. Bisedat e shkurtra me fëmijët, përmes pyetjeve të hapura, janë një burim i mirë të dhënash. Ky informacion mund të jetë shumë i dobishëm për të kuptuar se si e përjetojnë dhe interpretojnë botën përreth tyre dhe mund të dokumentohet në formën e shënimeve.
- **Bisedat dhe komunikimi me prindërit:** Dokumentimi përfshin edhe biseda me prindërit rreth përvojave dhe progresit të fëmijës në shtëpi. Këto komunikime regjistrohen për të krijuar një pasqyrë të plotë të zhvillimit dhe për të siguruar vazhdimësinë ndërmjet mjedisit shtëpiak dhe mjedisit edukativ.
- **Analiza dhe vlerësime nga edukatorët:** Edukatorët mund të shkruajnë vlerësime dhe reflektime mbi progresin e fëmijëve, duke identifikuar fushat ku ata tregojnë përmirësim ose kanë nevojë për më shumë mbështetje. Ky dokumentim gjithashtu i ndihmon edukatorët të vetëreflektojnë dhe të përshtasin qasjen e tyre pedagogjike ndaj mësimdhënies. Ditarët janë një mënyrë për të regjistruar mendimet dhe vëzhgimet e përditshme të edukatorëve mbi përvojat dhe përgjigjet e fëmijëve. Këto reflektime ndihmojnë në monitorimin e vazhdueshëm të zhvillimit të fëmijëve dhe përmirësimin e praktikave edukative.

Dokumentimi i rregullt dhe i plotë i vlerësimit i ndihmon edukatorët të krijojnë një pamje gjithëpërfshirëse dhe holistike të zhvillimit të fëmijëve, duke u dhënë atyre mjetet e nevojshme për të ndihmuar secilin fëmijë të arrijë progres sipas potencialit të tij. Për më tepër, ky dokumentim u lejon prindërve të jenë më të përfshirë në përvojat edukative të fëmijës dhe të marrin vendime të informuara për mbështetje të mëtejshme.

10.5.5 Vlerësimi përmes dokumentimit

Përdorimi i dokumentimit për ta vlerësuar të nxënit e fëmijëve përqendrohet si në procesin edukativ ashtu edhe në rezultatet e tij, duke krijuar një qasje gjithëpërfshirëse që ndryshon nga formatet tradicionale të vlerësimit, të cilat shpesh përqendrohen në produktin përfundimtar ose në përgjigjet e sakta. Përmes dokumentimit, edukatorët pasqyrojnë proceset e të menduarit të fëmijëve, strategjitë që përdorin dhe evolucionin e të nxënit të tyre me kalimin e kohës.

Procesi i vlerësimit përmes dokumentimit përfshin disa hapa kryesorë:

- **Mbledhja e provave**– Ky hap përfshin mbledhjen e vazhdueshme të formave të ndryshme të dokumentimit, siç janë shënimet e vëzhgimit, punimet e fëmijëve, fotografitë dhe videot, për të përfaqësuar një spektër të gjerë përvojash edukative dhe për të pasqyruar progresin e fëmijës në detaje.
- **Analiza e modeleve**– Edukatorët analizojnë dokumentimin për t'i identifikuar modelet në sjelljet, aftësitë dhe strategjitë e të nxënit të fëmijëve, duke u përqendruar në pikat e forta dhe sfidat specifike të secilit fëmijë. Kjo analizë ndihmon në kuptimin e tendencave dhe stileve të të nxënit të fëmijëve.

- **Komentet dhe reflektimi**– Edukatorët ndajnë provat e dokumentuara me fëmijët (për të inkurajuar vetëreflektimin) dhe prindërit, në mënyrë që edhe ata të përfshihen në proces. Ky shkëmbim ndihmon në krijimin e një partneriteti dhe transparence më të fortë në mbështetjen e zhvillimit të fëmijëve.
- **Përshtatja e qasjes edukative**– Dokumentimi shërben si një burim për modifikimin dhe përshtatjen e qasjeve edukative bazuar në nevojat individuale të fëmijëve. Ky hap siguron që edukimi i tyre të vazhdojë në një mënyrë të personalizuar, duke i mbështetur ata në zhvillimin e aftësive të reja dhe ndërtimin e vetëbesimit.

Kjo qasje e integruar ndaj vlerësimit i ndihmon edukatorët të krijojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të zhvillimit të fëmijëve, duke i përfshirë ata dhe prindërit e tyre në një proces të vazhdueshëm të të nxënës dhe rritjes.

10.5.6 Përparësitë dhe sfidat e vlerësimit në edukimin në fëmijërinë e hershme (EFH)

Përparësitë e vlerësimit në edukimin e hershëm të fëmijëve (EFH) janë të shumta dhe ndikojnë drejtpërdrejt në mbështetjen e zhvillimit të fëmijëve, përmirësimin e qasjeve edukative dhe fuqizimin e prindërve dhe edukatorëve. Disa nga përparësitë kryesore janë:

- **Mbështetje për një qasje holistike dhe zhvillim individual:** Vlerësimi në EFH përfshin vëzhgimin e fëmijëve në fusha të shumta zhvillimore (fizike, kognitive, emocionale dhe sociale), duke ofruar një pasqyrë gjithëpërfshirëse dhe të ekuilibruar të zhvillimit të tyre. Vlerësimi në EFH gjithashtu ndihmon në identifikimin e nevojave dhe aftësive unike të secilit fëmijë. Vlerësimi i rregullt dhe i vazhdueshëm ofron informacion në kohë reale në lidhje me progresin e fëmijës, duke i ndihmuar edukatorët dhe prindërit të vëzhgojnë zhvillimin dhe të ndërmarrin hapa të menjëhershëm për të mbështetur çdo nevojë të re që mund të lindë.
- **Përshtatja e punës edukative dhe planifikimi:** Të dhënat nga vlerësimi i ndihmojnë edukatorët të përshtasin strategjitë dhe planifikimin e tyre edukativ, duke krijuar aktivitete dhe përvoja që janë të personalizuar sipas moshës dhe interesave të fëmijëve. Edukatorët mund të identifikojnë se çfarë funksionon më mirë dhe të bëjnë përmirësime të vazhdueshme në metodologjitë e tyre.
- **Inkurajimi i pavarësisë dhe vetëbesimit tek fëmijët:** Kur fëmijët marrin reagime pozitive dhe mbështetje, ata ndihen më të sigurt dhe të motivuar për të eksploruar, mësuar dhe bashkëvepruar me mjedisin e tyre. Kjo i ndihmon të zhvillojnë pavarësinë dhe vetëbesimin e tyre.
- **Angazhimi i prindërve:** Vlerësimi në EFH ofron një bazë për komunikim të rregullt dhe efektiv me prindërit, duke i përfshirë ata më shumë në procesin e të nxënës dhe zhvillimit të fëmijës së tyre. Prindërit marrin informacion të dobishëm dhe bëhen partnerë aktivë në mbështetjen e zhvillimit të fëmijës së tyre.
- **Identifikimi i nevojave për ndërhyrje të hershme:** Vlerësimi në EFH ndihmon në zbulimin e hershëm të sfidave ose vështirësive të mundshme në zhvillimin e një fëmije, duke lejuar referime për ndërhyrje të hershme dhe mbështetje të specializuar. Kjo është thelbësore për t'i ndihmuar fëmijët të kapërcejnë çdo pengesë në fazat e hershme të jetës.

Megjithatë, vlerësimi në edukimin në fëmijërinë e hershme (EFH) përballë gjithashtu me disa sfida, pasi procesi kërkon një qasje të ndjeshme dhe të përshtatur për t'i përmbushur nevojat e fëmijëve të vegjël. Disa nga sfidat kryesore përfshijnë:

- **Diversiteti në zhvillimin individual:** Fëmijët zhvillohen me ritme dhe në mënyra të ndryshme, gjë që krijon vështirësi në përcaktimin e standardeve të përgjithshme të vlerësimit. Çdo fëmijë ka një stil unik të të nxënës dhe një fazë të ndryshme të zhvillimit, duke e bërë të vështirë krahasimin ose vlerësimin e tyre me një qasje uniforme.

- **Sfidat në objektivitet:** Vlerësimi kërkon që edukatorët të jenë të paanshëm dhe objektivë në vëzhgimet e tyre. Megjithatë, mendimet dhe perceptimet personale mund të ndikojnë në mënyrën se si interpretohen sjelljet dhe arritjet e fëmijëve, duke çuar potencialisht në një pikëpamje të pjesshme të zhvillimit të tyre.
- **Kufizimet e kohës dhe të burimeve:** Vlerësimi cilësor kërkon kohë dhe burime të konsiderueshme për të mbledhur dhe analizuar informacionin. Edukatorët mund të kenë ngarkesa të mëdha pune dhe kohë të kufizuar për të kryer vëzhgime të hollësishme dhe për të përgatitur dokumentim të plotë për secilin fëmijë.
- **Sfidat në vlerësimin e aspekteve emocionale dhe sociale:** Zhvillimi emocional dhe social i fëmijëve është kompleks për t'u matur në mënyrë objektive, pasi përfshin sjellje, ndjenja dhe marrëdhënie që janë më delikate dhe subjektive. Ky aspekt kërkon mjete vlerësimi që mund të përfshijnë më shumë interpretime dhe jo vetëm rezultate të matshme.
- **Qasje e përshtatshme për moshën:** Për të kryer vlerësime efektive në EFH, metodat e përdorura duhet të jenë të përshtatshme për moshën dhe të ndjeshme ndaj fazave të ndryshme të zhvillimit të fëmijëve. Kjo mund të jetë sfiduese, pasi formatet tradicionale të vlerësimit (testet, pyetësorët) nuk janë të përshtatshme për fëmijët e vegjël.
- **Mungesa e trajnimit të specializuar:** Edukatorët mund të mos kenë trajnim të mjaftueshëm për të kuptuar dhe zbatuar metodologji efektive të vlerësimit për fëmijët e vegjël. Pa trajnim të duhur, vlerësimet mund të bëhen më pak të sakta dhe mund të mos përmbushin standardet profesionale.
- **Komunikimi me prindërit:** Ndarja e rezultateve të vlerësimit me prindërit mund të jetë sfiduese, veçanërisht në rastet kur fëmija ka nevoja të veçanta ose vështirësi në zhvillim. Komunikimi efektiv kërkon ndjeshmëri, empati dhe një qasje konstruktive për t'i ndihmuar prindërit të kuptojnë progresin e fëmijës.
- **Ruajtja e konfidencialitetit dhe etikës:** Dokumentimi dhe ndarja e rezultateve të vlerësimit kryhet bazuar në një qasje etike për të mbrojtur privatësinë e fëmijëve dhe familjeve të tyre. Edukatorët duhet të jenë të kujdesshëm që të mos ndajnë informacion pa leje dhe të ruajnë konfidencialitetin e plotë.

Për t'i kapërcyer këto sfida, është e rëndësishme të përdoren qasje të ndjeshme dhe gjithëpërfshirëse, si dhe të ofrohet trajnim i vazhdueshëm për edukatorët dhe të nxitet bashkëpunim i ngushtë me prindërit dhe familjet. Edukatorët duhet të trajnohen për të interpretuar dokumentimin me saktësi, pa paragjykime, dhe për të nxjerrë përfundime kuptimplota që shërbejnë si bazë për punën e tyre. Edukatorët duhet të jenë në gjendje t'i identifikojnë fushat për përmirësim të mëtejshëm në praktikën e tyre pedagogjike, njësoj si çdo profesionist tjetër. Ata gjithashtu duhet të jenë të hapur për ta përshtatur dhe pasuruar gjuhën e tyre profesionale dhe të jenë të gatshëm që t'i ndajnë vëzhgimet dhe reflektimet e tyre me kolegët për t'i zhvilluar vlerësimet sa më objektive për fëmijët.

Edukatorët duhet të jenë gjithashtu në gjendje t'i identifikojnë kufizimet e tyre, si çdo profesionist tjetër, dhe të jenë të hapur për të përshtatur dhe pasuruar gjuhën e tyre dhe gatishmërinë për të ndarë vëzhgimet dhe reflektimet e tyre me kolegët në mënyrë që të zhvillojnë vlerësime sa më objektive për fëmijët. Siç e kemi përmendur tek parimet, vlerësimi nuk duhet të ndërtohet kurrë duke përdorur vetëm një aktivitet ose një qasje të vetme ndaj dokumentimit, por duhet të mbështetet nga prova të shumta. Të mësuarit dhe zhvillimi i fëmijëve është shumëshresor dhe dinamik. Për ta kuptuar zhvillimin e një fëmije, është thelbësore të mblidhen prova, vëzhgime dhe dokumentim nga aktivitete, kontekste dhe afate kohore të ndryshme. Qasje të ndryshme, të tilla si vëzhgimet dhe bisedat me fëmijët, kapin aspekte unike të të mësuarit që mund të mos jenë të dukshme në një aktivitet të vetëm. Duke përdorur qasje të shumta, edukatorët mund të vëzhgojnë se si një fëmijë zbaton aftësitë në skenarë të ndryshëm, duke ofruar një vlerësim më gjithëpërfshirës dhe të saktë. Kjo qasje gjithashtu zvogëlon rrezikun e paragjykimeve, duke marrë parasysh stilet e ndryshme të të mësuarit dhe shtigjet e zhvillimit.

10.6.7 Si kryhet vlerësimi, nga kush dhe sa shpesh?

Vlerësimi në edukimin në fëmijërinë e hershme (EFH) kryhet vazhdimisht dhe kryesisht nga edukatorët që punojnë drejtpërdrejt me fëmijët. Ky proces zakonisht përfshin vëzhgime të rregullta, dokumentim dhe reflektim mbi progresin dhe zhvillimin e secilit fëmijë. Në tabelën vijuese janë dhënë disa detaje rreth mënyrës se si kryhet vlerësimi, kush është përgjegjës dhe shpeshtësia e vlerësimit në EFH:

Si kryhet vlerësimi?	Kush e kryen vlerësimin?	Sa shpesh kryhet vlerësimi?
Vëzhgimi ditor –Edukatorët vëzhgojnë sjelljen, ndërveprimet dhe aktivitetet e fëmijëve në mjedisin natyror të klasës/grupit. Vëzhgimet bëhen gjatë lojës, aktiviteteve të strukturuar dhe ndërveprimeve të përditshme për të kuptuar aftësitë sociale, emocionale, gjuhësore dhe motorike të fëmijës. Dokumentimi i progresit –Përmes ditarëve të vëzhgimit, portfoliove të punës së fëmijëve, fotografive dhe videove, edukatorët mbledhin vazhdimisht informacion rreth zhvillimit të fëmijëve. Ky dokumentim përdoret për të ndjekur progresin dhe për të pasqyruar arritjet e fëmijës. Vlerësimi përmes aktiviteteve praktike– Vlerësimi shpesh bëhet përmes lojës së përshtatshme për moshën dhe aktiviteteve praktike, siç janë projektet në grup, rrëfimi i tregimeve ose aktivitetet e punimeve artizanale. Edukatorët i përdorin këto aktivitete për të vlerësuar aftësitë dhe interesat e fëmijëve në një mënyrë natyrale dhe joformale. Komentet dhe vetëvlerësimi i thjeshtë– Fëmijët mund të inkurajohen të ndajnë mendimet e tyre rreth aktiviteteve që kanë bërë, gjë që i ndihmon edukatorët të kuptojnë se si e perceptojnë ata të nxënit. Edukatorët gjithashtu ofrojnë komente të menjëhershme për të inkurajuar dhe mbështetur fëmijët në zhvillimin e tyre.	Edukatorët– Ata janë individët kryesorë përgjegjës për kryerjen e vlerësimeve në EFH, pasi kalojnë më shumë kohë me fëmijët dhe i dijnë aftësitë dhe nevojat e tyre. Edukatorët përdorin metoda të ndryshme për të mbledhur dhe dokumentuar informacionin. Prindërit/Kujdestarët ligjor – Prindërit\ kujdestarët ligjor gjithashtu mund të kontribuojnë në vlerësim duke ndarë informacion në lidhje me përvojat dhe përparimin e fëmijës në shtëpi. Komunikimi me prindërit i ndihmon edukatorët të kuptojnë më mirë kontekstin e fëmijës dhe të krijojnë vazhdimësi ndërmjet mjedisit shtëpiak dhe të nxënit. Specialistët e zhvillimit të fëmijëve– Në rastet kur një fëmijë ka nevoja specifike, specialistë të zhvillimit të fëmijës, siç janë psikologët, logopedët ose terapistët e punës, mund të përfshihen në vlerësim për të ofruar mbështetje të specializuar dhe ndërhyrje të përshtatura.	Vlerësim i përditshëm dhe i vazhdueshëm– Edukatorët kryejnë vlerësime të vazhdueshme çdo ditë përmes vëzhgimeve dhe dokumentimit të aktiviteteve të përditshme. Vlerësim periodik– Në intervale të caktuara, si çdo muaj ose çdo tremujor, edukatorët kryejnë vlerësime më të strukturuar për të analizuar dhe përmbledhur progresin e fëmijëve. Këto vlerësime ndihmojnë në planifikimin afatgjatë dhe përgatitjen e raporteve për prindërit. Vlerësimi i fundit të periudhës ose vitit– Në fund të një periudhe, siç është viti akademik, një vlerësim përmbledhës bëhet për të pasqyruar përparimin e fëmijës gjatë gjithë periudhës. Ky vlerësim ofron një pasqyrë të përgjithshme të arritjeve të fëmijës dhe i ndihmon edukatorët dhe prindërit që ta planifikojnë mbështetjen për vitin pasardhës. Vlerësimi identifikues– Vlerësimet identifikuese mund të aplikohen në kohë të ndryshme, jo gjithmonë të paracaktuara. Gjersa përcaktimi i periudhave kohore pas të cilave një fëmijë i nënshtrohet një vlerësimi identifikues është i rëndësishëm, kjo mund të ndryshojë në varësi të rasteve individuale të fëmijëve dhe nevojës për mbështetje/ ndërhyrje të hershme.

10.6.8 Praktika dhe shembuj në Vlerësimin në Fëmijërinë e Hershme (VFH)

Shembuj praktikë të vlerësimit në edukimin në fëmijërinë e hershme (EFH) i ndihmojnë edukatorët të mbledhin informacion në mënyrë të natyrshme dhe të përshtatshme për moshën, duke përfshirë aktivitete që janë të integruara në përvojat e përditshme të fëmijëve. Ja disa shembuj praktikë:

Vëzhgimi i sjelljeve dhe ndërveprimeve gjatë lojës së lirë: Edukatorët i vëzhgojnë fëmijët gjatë lojës së lirë, duke vënë re se si ata bashkëveprojnë me të tjerët, zgjedhin lojëra, zgjidhin probleme dhe shprehin emocionet e tyre. Përmes vëzhgimit të lirë, edukatorët kapin momentet ku fëmijët demonstrojnë aftësitë e tyre, të tilla si zgjidhja e problemeve, ndarja e detyrave, aftësitë gjuhësore dhe shprehja emocionale.

Vlerësimi përmes aktiviteteve dhe projekteve praktike: Në vend që të përdorin teste formale, fëmijët angazhohen në projekte dhe aktivitete praktike që i ndihmojnë edukatorët t'i kuptojnë aftësitë dhe mënyrat e tyre të të menduarit. Për shembull, ndërtimi i një strukture me blloqe ose krijimi i një historie me figura ndihmon në vlerësimin e aftësive motorike, kreativitetit dhe të menduarit kritik. Përmes këtyre aktiviteteve, edukatorët mund të vëzhgojnë se si fëmijët angazhohen, zgjidhin probleme, bashkëpunojnë dhe tregojnë përkushtim.

Përdorimi i portfolios së fëmijëve: portfolio është një koleksion i punës së fëmijës, siç janë vizatimet, projektet e punimeve artizanale, puna shkencore ose krijime të tjera që pasqyrojnë progresin e tyre. Kjo përfshin gjithashtu fotografi dhe shënime vëzhgimi. Përmes portfolios, edukatorët dhe prindërit mund të ndjekin zhvillimin dhe të shohin progresin e fëmijës me kalimin e kohës, duke krahasuar përvoja të ndryshme të të nxënës.

Ditari i vëzhgimit: Edukatori mban një ditar/fletore ku shënon sjellje të rëndësishme, zhvillime të reja aftësish ose përvoja specifike të fëmijëve gjatë gjithë ditës. Ditari përmban përshkrime narrative të përvojave të fëmijës gjatë aktiviteteve të caktuara, duke reflektuar atë që fëmija po mëson, emocionet e tij dhe mënyrën se si i qaset situatave të ndryshme.

Fotografi dhe video të momenteve të rëndësishme: Edukatorët mund të bëjnë fotografi ose video gjatë aktiviteteve për të kapur momente të rëndësishme zhvillimore, si p.sh. kur një fëmijë ndihmon një bashkëmoshatar, shpreh një emocion të veçantë ose përfundon një aktivitet kompleks. Këto dokumente vizuale janë të dobishme për analiza dhe ndarje me prindërit.

Vlerësimi përmes bisedave dhe pyetjeve të hapura: Edukatorët i përfshijnë fëmijët në biseda dhe i pyesin ata për përvojat dhe ndjenjat e tyre. Për shembull, pas një aktiviteti leximi, edukatori\ja mund ta pyesë fëmijën për personazhin e tij të preferuar ose të kërkojë një përshkrim të asaj që ndodhi në tregim. Nëse është e përshtatshme për moshën e tyre, fëmijët mund të inkurajohen të reflektojnë mbi përvojat e tyre përmes pyetjeve të thjeshta si “Çfarë ju pëlqeu më shumë?” ose “Si mendoni se e përfunduat këtë projekt?” Kjo i ndihmon edukatorët të kuptojnë perceptimin e fëmijës për të nxënësit e vet dhe u ofron atyre një perspektivë nga fëmija në lidhje me përvojat e tij të të nxënësit.

Zhvillimi i tregimeve dhe narrativave: Fëmijët inkurajohen të krijojnë dhe të tregojnë historitë e tyre. Për shembull, një fëmijë mund të krijojë një histori për një personazh imagjinar ose një aventurë që dëshiron ta ketë. Kjo i ndihmon edukatorët të vëzhgojnë zhvillimin gjuhësor, aftësitë e të menduarit kreativ dhe të kuptuarit e strukturës narrative.

Vëzhgimi i aftësive motorike dhe fizike: Gjatë aktiviteteve fizike, siç janë lojërat në natyrë ose sportet, edukatorët vëzhgojnë zhvillimin e aftësive motorike të fëmijëve, siç janë baraspesha, koordinimi dhe forca. Për shembull, mund të vërehet se si një fëmijë përdor këmbët dhe duart për të kapur ose shtyrë një top gjatë lojës.

Këta shembuj praktikë të vlerësimit i ndihmojnë edukatorët të mbledhin të dhëna të vlefshme në mënyra që janë të natyrshme dhe jo stresuese për fëmijët, duke krijuar një proces vlerësimi të përshtatshëm për moshën dhe fazën e tyre të zhvillimit.

10.6.9 Vlerësimi dhe stresi i fëmijëve

Vlerësimi nuk duhet të krijojë stres për fëmijët ose t'i largojë nga të nxënit e bazuar në lojë. Gjithashtu, nuk duhet të jetë proces stresues as për edukatorët ose prindërit.

Në edukimin në fëmijëri të hershme në Kosovë, vlerësimi duhet të shihet si një pjesë e natyrshme dhe mbështetëse e procesit të të nxënit, dhe jo si një burim stresi për fëmijët, edukatorët ose prindërit. Fokusi kryesor i Edukimit në Fëmijërinë e Hershme është të mbështesë zhvillimin e një fëmije përmes edukimit të bazuar në lojë, i cili inkurajon eksplorimin, kreativitetin dhe ndërveprimin shoqëror. Kur zbatohet siç duhet, vlerësimi duhet të integrohet pa probleme në këtë mjedis pa ndërprerë ose krijuar presion për fëmijët e vegjël.

Fëmijët në këtë moshë mësojnë më mirë përmes lojës, pasi është mënyra e tyre e natyrshme për ta kuptuar botën përreth tyre. Prandaj, praktikat e vlerësimit nuk duhet t'i largojnë fëmijët nga aktivitetet e tyre të lojës, por përkundrazi të vëzhgojnë dhe dokumentojnë të nxënit e tyre ndërsa fëmija zhvillohet natyrshëm. Duke u përqendruar në vëzhgim dhe duke përdorur forma të ndryshme dokumentimi, të tilla si shënime, fotografi dhe shembuj pune, edukatorët mund të vlerësojnë progresin e fëmijëve pa ndërprerë lojën e tyre ose pa prezantuar detyra që duken si testime formale. Vlerësimi duhet të ndodhë në kontekstin e natyrshëm të fëmijës, duke vëzhguar ndërveprimet dhe aktivitetet e tyre të përditshme. Vëzhgimet e vazhdueshme dhe të natyrshme ndihmojnë në kapjen e sjelljeve dhe progresit të natyrshëm të fëmijëve pa presion ose ndërhyrje të jashtme. Në këtë mënyrë, vlerësimi bëhet pjesë e përvojës së përditshme të të nxënit, duke nxitur një atmosferë pa stres dhe të këndshme ku fëmijët ndihen të sigurt për t'u shprehur dhe për të marrë rreziqe në të nxënit dhe ndërveprimet e tyre me mjedisin dhe të tjerët.

Për edukatorët dhe prindërit, procesi i vlerësimit duhet të jetë gjithashtu mbështetës, bashkëpunues dhe i menaxhueshëm. Edukatorët duhet të ndihen të lirë të përdorin metoda të ndryshme fleksibile dhe madje edhe joformale që përputhen me fazat e zhvillimit të fëmijëve. Kjo zvogëlon presionin e testimit të formalizuar dhe krijon një qasje më të relaksuar dhe të natyrshme për ta ndjekur progresin e secilit fëmijë. Prindërit gjithashtu nuk duhet ta shohin vlerësimin si një masë të suksesit të fëmijës së tyre, por më tepër si një mjet për të kuptuar dhe mbështetur më mirë rritjen e fëmijës së tyre. Kur edukatorët ndajnë rezultatet e vlerësimit në mënyrë pozitive dhe konstruktive me prindërit, kjo ndihmon në nxitjen e një partneriteti më të fortë, duke i inkurajuar prindërit të angazhohen në mënyrë aktive në përvajat e të nxënit të fëmijës së tyre pa stres.

Vlerësimi në edukimin në fëmijëri të hershme në Kosovë duhet t'i japë përparësi mirëqenies dhe nevojave zhvillimore të fëmijëve, duke u integruar natyrshëm në mjediset e të nxënit të bazuara në lojë. Duhet të jetë një proces reflektues dhe mbështetës si për edukatorët ashtu edhe për prindërit, duke u lejuar të gjithë të përfshirëve të përqendrohen në zhvillimin dhe edukimin holistik të fëmijës pa përjetuar stres ose presion të panevojshëm.

10.6.10 Rëndësia e komunikimit ndërmjet edukatorëve dhe profesionistëve të tjerë

Komunikimi efektiv ndërmjet edukatorëve brenda të njëjtit grup, nëpër grupe të ndryshme, dhe me profesionistë të tjerë, siç janë psikologët, pedagogët dhe asistentët për fëmijët me aftësi të kufizuara, është çelësi për të rritur vetëreflektimin, për t'i përmirësuar praktikat dhe për të siguruar vlerësime më objektive. Komunikimi bashkëpunues i ndihmon edukatorët të reflektojnë mbi metodat e tyre të mësimdhënies, të ndajnë njohuri dhe t'i përshtatin praktikat për të përmbushur nevojat e ndryshme të fëmijëve. Kur edukatorët komunikojnë hapur me njëri-tjetrin dhe me specialistë të tjerë, ata mund t'i identifikojnë së bashku fushat e përmirësimit, t'i adresojnë sfidat dhe të zhvillojnë strategji më efektive për ta mbështetur rritjen dhe zhvillimin e çdo fëmije. Ky bashkëpunim është thelbësor jo vetëm për rritjen profesionale, por edhe për t'u ofruar fëmijëve përvajën më mbështetëse dhe të individualizuar të të nxënit. Duke u mbështetur

në ekspertizën e profesionistëve të ndryshëm, edukatorët mund t'i përsosin praktikat e tyre, të marrin vendime më të informuara dhe të sigurohen që të gjithë fëmijët, përfshirë ata me nevoja të veçanta, të marrin mbështetjen e synuar që u nevojitet për sukses.

10.6.11 Vlerësimi i bazuar në kompetencat kurrikulare

Vlerësimi i bazuar në kompetenca në institucionin e edukimit në fëmijërinë e hershme përfshin vlerësimin e aftësive të fëmijëve në fusha të ndryshme zhvillimore – të tilla si shkathtësitë kognitive, socio-emocionale, fizike dhe gjuhësore – përmes një kombinimi të vëzhgimeve dhe formave të ndryshme të dokumentimit. Më poshtë janë dhënë disa shembuj se si fëmijët në moshën e hershme mund të vlerësohen bazuar në kompetenca duke përdorur forma të shumta të provave nga kurrikula.

Shembull i vlerësimit dhe dokumentimit të bazuar në kompetencat kurrikulare

1. Kompetenca kognitive (Zgjidhja e problemeve dhe të menduarit kritik)

Vëzhgimi: Një edukator vëzhgon një fëmijë gjatë një aktiviteti të ndërtimit me blloqe. Fëmija po përpiqet të kuptojë se si t'i balancojë blloqet e madhësive të ndryshme për të ndërtuar një strukturë të lartë. Edukatori vëzhgon strategjitë që fëmija përdor për të zgjidhur problemin, duke përfshirë metodën e provës dhe gabimit, dhe mënyrën se si reagon ndaj dështimit.

Dokumentimi: Bëhen fotografi të kullës prej blloqesh të fëmijës, së bashku me shënimet vëzhguese të edukatorit dhe shpjegimet verbale nga fëmija rreth procesit të tij gjatë aktivitetit. Edukatori gjithashtu përfshin një reflektim nga fëmija se si u ndie kur kulla u rrëzua dhe si e përmirësoi strategjinë e vet.

2. Kompetenca Sociale-Emocionale (Bashkëpunimi dhe shkëmbimi)

Vëzhgimi: Gjatë një aktiviteti në grup, edukatori/ja vëzhgon se si një fëmijë bashkëvepron me bashkëmoshatarët. Fëmija demonstroi ndarjen e lodrave, marrjen e roleve me radhë dhe zgjidhjen e konflikteve gjatë një skenari imagjnativ me role në pjesën e kuzhinës.

Dokumentimi: Edukatori mbledh shënime mbi këtë sjellje të vëzhguar gjatë disa seancave të lojës në grup, të shoqëruara nga një inqizim video që tregon aftësinë e fëmijës për të negociuar me bashkëmoshatarët. Shkruhet një histori edukative për ta pasqyruar rritjen e fëmijës në shkathtësitë social-emocionale me kalimin e kohës.

3. Kompetenca Gjuhësore dhe e Komunikimit (Gjuha ekspresive dhe receptive)

Vëzhgimi: Edukatori/ja dëgjon një fëmijë tek tregon një tregim gjatë kohës së rrëfimeve, duke vënë re pasurinë e fjalorit dhe aftësinë e fëmijës për të strukturuar një rrëfim.

Dokumentimi: Rrëfimi i treguar nga fëmija inqizohet dhe pastaj transkriptohet dhe përfshihet në portfolion e tij. Përveç kësaj, mostra të vizatimeve të fëmijës me mbishkrime që i diktojnë dokumentohet për të treguar progresin në gjuhën e shprehjes gjatë disa muajve.

4. Kompetenca Fizike (Shkathtësitë motorike të muskujve të vegjël)

Vëzhgimi: Edukatorja e vëzhgon një fëmijë gjatë një aktiviteti të punës me gërshërë. Fëmijës i kërkohet të presë me gërshërë forma nga letra. Edukatori\ja vëzhgon kapjen, koordinimin dhe aftësinë e fëmijës për t'i ndjekur vijat me saktësi.

Dokumentimi: Format e prera të përfunduara nga fëmija mbledhen si mostra pune dhe progresi ndiqet me kalimin e kohës duke krahasuar mostrat e punës së mëparshme me ato të mëvonshme. Edukatori\ja mund të bëjë gjithashtu fotografi të fëmijës të angazhuar në aktivitete të tjera motorike të muskujve të vegjël, të tilla si varja e rruazave në pe ose vizatimi, për të mbështetur më tej vlerësimin.

5. Kompetenca Kreative (Shprehja artistike dhe imagjinata)

Vëzhgimi: Gjatë kohës së lirë të vizatimit, edukatori\ja vëzhgon procesin artistik të fëmijës. Fëmija eksploron ngjyrat dhe format dhe ndan histori imagjinative që lidhen me veprat e tij artistike.

Dokumentimi: Edukatori\ja mbledhë disa nga vizatimet e fëmijës, së bashku me përshkrimet e veprave artistike të fëmijës. Një video e shkurtër që kap shpjegimin e fëmijës për zgjedhjet e tij/saj kreative përfshihet në dokumentim.

6. Kompetenca Matematikore (Numërimi dhe njohja e modeleve)

Vëzhgimi: Edukatori\ja vëzhgon një fëmijë gjatë një aktiviteti të renditjes dhe numërimit, ku fëmija i rendit objektet sipas madhësisë dhe ngjyrës dhe numëron numrin e sendeve në secilin grup.

Dokumentimi: Mostrat e punës nga aktiviteti ruhen dhe shënimet e edukatorit\esnxjerrin në pah aftësinë e fëmijës për të kategorizuar dhe numëruar. Bëhen foto të rregullimit të objekteve nga fëmija. Bëhet gjithashtu një intervistë pasuese me fëmijën, ku diskutohet se si i grupoi objektet.

Këta shembuj ilustrojnë se si përdorimi i një kombinimi të vëzhgimeve, shembujve të punës, fotove, videove dhe reflektimeve të edukatoreve ofron një vlerësim gjithëpërfshirës të kompetencave të fëmijëve në fusha të ndryshme. Duke mbledhur prova nga burime të shumta me kalimin e kohës, edukatorët mund të zhvillojnë një kuptim më të saktë dhe holistik të programit zhvillimor të secilit fëmijë.

